Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 1 (153) / 2019. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Reportazh

Dy Dibrat, të ndara në kufi, por të lidhura në rrënjë

Nga **DIONIS XHAFA**



Profil

Ramazani Kaza, i pari me linjën e re të përpunimit të frutave të thata

Nga **OSMAN XHILI**



Homazh

Lamtumirë, gjeneral Hysen Repa!

Nga **XHAFER MARTINI**

"...Sido me qenë në atë botë, mik i nderuem, nuk ka si me qenë ma keq se në nji vend ku Gjeneralët shtërngohen me u ba mekanikë, ndërsa mekanikët bahen ministra..."

– I. SECI



LLIXHAT - PPP

privatizim, protesta, politikë

- **Protesta e përfaqësuesve të shërbimit hotelerik dhe bizneseve familjare që jetojnë rreth e rrotull kompleksit të llixhave në Peshkopi nxorën në pah një proces të dyshimtë korruptiv në lidhje me marrjen në përdorim të ujërave termale.**
- **Bashkia Dibër, megjithëse ka në pronësi kompleksin e llixhave, nuk ka ushtruar kompetencat ligjore për marrjen në përdorim të ujit.**
- **Në dokumentet e disponueshme deri më tani nga redaksia apo të bëra publike nuk është e qartë nëse kompania po kërkon marrjen e kompleksit të llixhave apo marrjen e ujit në hyrje/dalje të kompleksit dhe po planifikon ndërtimin e një kompleksi të ri. Hetimi administrativ nxjerr gabim koordinatat në lejen e marrë**
- **Përfaqësuesit e 35 bizneseve të shërbimin hotelier dhe rreth 200 shtëpive pritëse shfaqin pasiguri për investimet e kryera. Procesi i marrjes në përdorim të ujërave rrit dyshime për privatizim korruptiv të qendrës balneare në Peshkopi.**
- **Vendimi i datës 11 dhjetor 2018, marrë nga Këshillin e Basenit Ujor Drin-Bunë pritet të anulohet më 5 shkurt 2019.**



Almira Xhembulla: *"Vendimi për dhënien në përdorim të ujërave termale do të anulohet"*

Xhemal Gjunkshi: *Skandali me privatizimin e Llixhave, një mega aferë korruptive*

Speciale në FAQET 2-5

TRAJTESË

Hebrenjtë në Shqipëri gjatë Holokaustit

Nga **prof. SHABAN SINANI**

Në vitin 1932, në kohën kur antisemitizmi në Europë ishte kthyer në doktrinë, Shqipëria u bë vendi i parë dhe i vetëm në kontintent që u njohu hebrenjve të drejtën e organizimit në bashkësi dhe legjitimoi *shabbat*-in. Është rasti i vetëm i *diskriminimit pozitiv* të hebrenjve gjatë dekadave kur bota lëngonte nga judeofobia. E drejta e komunitetit inkurajoi ambasadorin amerikan në Tiranë Herman Bernstein, një figurë qendrore e lëvizjes sioniste botërore (bashkë me A. Einsten- in dhe Ben Gurion-in), që të niste menjëherë negociatat me ambasadorin shqiptar në SHBA Faik Konica për të arritur një ***marrëveshje ndërshtetërore shqiptaro-amerikane për pranimin në Shqipëri të 500 familjeve hebreje.***

(Lexoni në faqet 6-7)

TRAJTESË

T'i shërbesh atdheut si Selim Pira!

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Vetëm Selim Pira shkruaj në zarfin e kujtesës dhe fletët brenda do të hapen si në një enciklopedi... Nuk kisha pi ndonjëherë kafe me Selim Pirën...As i kisha dhënë dorën në ndonjë konak Dibre... Me të vëllain Sulën po, edhe me fëmijët e tij... Banonim në një pallat me themele të lidhura. Ai në hyrjen e parë e unë në të tretën. Në të njëjtin kat...Selimi më njihte. Jo në portret, por në germë të penës... Sa herë më lexonte në "Rruga e Arbrit" apo në "Dita", më merrte në telefon... Nuk dëgjonte mirë, por fliste qartë e me pasion. Më bënte të skuqesha nga fjalët në shkallën më të lartë që përdorte ndaj meje... Më fuste në borxh, borxhin njerëzor për ta takuar, pirë një kafe e qëndruar në krah të njërit tjetrit përjetësuar në fotografi...

(Lexoni në faqen 19)

NË BRENDËSI:

■ **Ç'kemi** asaj Dibre ■ **Ra Amerika** dhe u zbulua Dibra... ■ **Vendi vakant** për kryetarin e komunës në Dibër të Madhe kthehet në luftë politike mes BDI dhe ASH ■ **46 të rinj** nga Dibra, 3 ditë, 8 grupe, 8 propozime dhe 2 fitues! ■ **Vlerësim** për mirëkuptimin, harmoninë dhe qytetarinë e komunitetit dibran ■ **Syri** i një mjellme në Korab ■ **Mjeku** i pagabueshem ■ **Naim Berisha**, krijues i sprovuar i këngëve të arrira ■ **Emini** i Ashikëve të Brezhdanit ■ **"Rizgjime** meteorësh" - një botim i ri me krijime të reja, të arrira artistikisht ■ **Musa Shehu**, mësues dhe gazetar i "Ora"-1930 ■ **Karakteri** atdhetar i luftërave të Skënderbeut, themelues i shtetit të parë kombëtar shqiptar ■ **Avdulla Aga** (Baftjari) - në prag të shekullit ■ Lamtumirë **Xhelal Luca**, miku ynë!

Rruga e Arbërit rrugaearberit

Bej "**Like**" dhe "**Share**". Pajtohu dhe qëndro me gazetën #rrugaearberit më pranë #Dibrës!

Për më shumë informacion:
Tel: 00455 68 65 08 441. +355 **68 65 08 441** +355 **69 20 68 603**
Email: rrugaearberit@gmail.com | www.rrugaearberit.com

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 1 (153). Janar 2019
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit shkurt 2019.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.
Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.
JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.
Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Abdurahim ASHIKU
Shaban SINANI
Osman XHILI
Xhafer MARTINI
Almira XHEMBULLA
Xhemal GJUNKSHI
Dionis XHAFA
Pëllumb GORICA
Mevlud BUCI
Selman MËZIU
Ali HOXHA
Zabit LLESHI
Perikli SHULI
Ilir SECI

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

- **Protesta e përfaqësuesve të shërbimit hotelerik dhe bizneseve familjare që jetojnë rreth e rrotull kompleksit të llixhave në Peshkopi nxorën në pah një proces të dyshimtë korruptiv në lidhje me marrjen në përdorim të ujërave termale.**
- **Bashkia Dibër, megjithëse ka në pronësi kompleksin e llixhave, nuk ka ushtruar kompetencat ligjore për marrjen në përdorim të ujit.**
- **Vendimi i datës 11 dhjetor 2018, marrë nga Këshillin e Basenit Ujor Drin-Bunë pritet të anulohet.**


Njëra nga godinat e qendër balneare, Peshkopi.

LLIXHAT - PPP
privatizim, protesta, politikë

Nga **BUJAR KAROSHI**


Pamje nga protesta para bashkisë së Dibrës

Dhjetëra biznese dhe familjarë që punojnë dhe jetojnë rreth kompleksit të Llixhave në Peshkopi nisën një protestë më 25 janar kundër vendimit të Basenit Ujor Drin-Bunë, i cili kishte vendosur më 11 dhjetor 2018 dhënien në përdorim të burimit të ujit të llixhave në Peshkopi. Ky vendim, në dukje i marrë në mënyrë të fshehtë, sipas protestuesve, vë në rrezik të ardhmen e këtyre bizneseve dhe mund të ketë pasoja për qindra të qytetarë, të cilët mjekohen në këto llixha. Banorët nënshkruan një peticion, që ia drejtuan qeverisë dhe kryetarit të bashkisë.

Në mesin e protestuesve, përpara Bashkisë së Dibrës, ishte edhe deputeti i Dibrës, Xhemal Gjunkshi.

“Është e papranueshme që prefekti i Shkodrës apo njerëz të blerë nga ky bord, të vendosin për fatin e një lagjeje të tërë në Dibër, e cila është ndërtuar nga fillimi në funksion të atij uji kurativ. Banorët dyshojnë se praktika për dhënien me koncesion të ujit është korruptive, njësoj si me koncesionet e tjera. Ato akuzojnë bashkinë dhe prefekturën Dibër se kanë ndihmuar me procedura fiktive firmën, duke anashkaluar konsultimet publike me banorët” tha deputeti Gjunkshi.

Gjatë një bisede telefonike, deputeti i Dibrës tha se nuk kishte në dispozicion gjithë procedurën për marrjen në shfrytëzim të ujërave termale, por theksoi se për këtë i është drejtuar zyrtarisht prefektit të Shkodrës për të na vënë në dispozicion të gjithë praktikën që i ka detyruar në marrjen e këtij vendimi korruptiv”.

Një ditë më pas, deputetja e Dibrës, përfaqësuese e shumicës në Parlament, znj. Almira Xhembulla, së bashku me kryetarin e bashkisë së Dibrës Muharem Rama, organizuan një takim me banorët dhe pronarët e hoteleve rreth e rrotull kompleksit.

Xhembulla tha në takim se nuk ka një vendim për dhënien me koncesion, por vetëm një “leje për marrjen në përdorim”.

Në një status në Facebook me 26 janar, Xhembulla thekson mes të tjerash se përfaqësuesit e Dibrës në këtë mbledhje kanë votuar kundër, si dhe kjo leje nuk mund të shfrytëzohet pa një vendim të bashkisë Dibër. Sipas saj, bashkia është e angazhuar maksimalisht për të gjetur të gjitha format për ta bllokuar këtë vendim”.

Ajo e rreshtoi veten mes qytetarëve dhe theksoi se do të kërkojë që kjo leje të pezullohej sa më parë.

“Si deputete e Dibrës, si qytetare, si advokuese e së drejtës së komuniteteve në menaxhimin e burimeve natyrore, që në momentin kur mora informacion për një vendimmarrje që lidhej me ujin e llixhave, në koordinim me kryetarin e Bashkisë e përcolla shqetësimin dhe kërkova informacion tek të gjithë instancat përkatëse. Menjëherë nga Zyra e Kryeministrit u dha urdhër për ngritjen e një grupi pune për të vlerësuar procesin dhe vlefshmërinë e kësaj vendimmarrje”, - tha Xhembulla.

Debati shkoi deri në Kuvendin e Shqipërisë, ku deputetja tjetër e Dibrës Reme Lala, zgjedhur me siglën e PDIU-së, e cila pak kohë më parë iu bashkua maxhorancës, i kërkoi kryeministrit ndërhyrjen e tij për anulimin e kësaj leje. Ajo aludoi për shpërdorim dhe keqpërdorim të ligjit në lidhje me këtë vendim.

Almira Xhembulla mbajti një fjalim në foltoren e kuvendit (lexo të plotë në faqen 4), e cila bëri një panoramë të dhënies së kësaj leje dhe procedurat e ndjekura zyrtare për anulimin e saj.

Ajo rendit gjashtë problematika që rrjedhin prej këtij vendimi si dhe dha lajmin se i është kërkuar zyrtarisht prefektit të Shkodrës të thërrasë në mbledhje të jashtëzakonshme Këshillin e Basenit Ujor Drin-Bunë, ku do të trajtohet projekt-vendimi i anulimit të vendimit nr. 4, datë 11.12.2018”.

Përmes një bisede telefonike, deputeti Xhemal Gjunkshi uroi që kjo të ndodhë sa më parë.

“Si ka mundësi që kryetari i Bashkisë nuk ka informacion, kur ka çuar drejtorin me dieta që e përfaqëson, dhe në anën tjetër shkon përpara banorëve me përfaqësuesin e kompanisë që ka marrë me koncesion ujin?!”, - ngre pyetjen dhe dyshime Gjunkshi. Sipas tij, këshilli i Basenit e ka njoftuar disa herë Bashkinë për të marrë ujin në përdorim dhe kjo e fundit nuk ka shkuar ... Pse Bashkia nuk ka shkuar për ta marrë në përdorim ujin e Llixhave, duke qenë se ajo e kishte në përdorim në fakt...?!”

Deputeti Gjunkshi thekson se “Bashkia e ka lënë qëllimisht këtë shteg, për të depërtuar dhe për të ndihmuar dhënien me koncesion”. Sipas tij, Këshilli i Basenit ujor në Shkodër

Në dokumentet e disponueshme deri më tani nga redaksia apo të bëra publike nuk është e qartë nëse kompania po kërkon marrjen e kompleksit të llixhave apo marrjen e ujit në hyrje/dalje të kompleksit dhe po planifikon ndërtimin e një kompleksi të ri. Hetimi administrativ nxjerr gabim koordinatat në lejen e marrë

"LUGINA E SHËRIMIT"

Me qëllim nxitjen e turizmit dhe zhvillimit të rajonit, njëri nga projektet e viteve të fundit është ajo që quhet "Lugina e shërimit". Ky emërtim është vendosur në kuadrin e krijimit të shtigjeve turistike të reja nga projekti "D2T - Dibra Turizëm dhe Traditë". Projekti ka qëllim që të nxisë zhvillimin ekonomik në këtë zonë, duke koordinuar ujërat termale me natyrën. Projektet dhe idetë në këtë drejtim kanë ardhur nga shoqëria civile dhe përfshijnë zonën nga Kameni deri në Zagrad e Bellovë, e cila mund të marrë përparësi ekonomike në funksion të llixhave të Peshkopisë. Për momentin kjo funksionon vetëm si guidë turistike, por në të ardhmen mundësitë e investimeve mbeten të mëdha.



Një nga burimet e llixhave. Foto: E.Hasani

Përfaqësuesit e 35 bizneseve të shërbimin hotelier dhe rreth 200 shtëpive pritëse shfaqin pasiguri për investimet e kryera. Procesi i marrjes në përdorim të ujërave rrit dyshime për privatizim korruptiv të qendrës balneare në Peshkopi.

"Investimet e deritanishme janë bërë duke pasur parasysh se kompleksi është shtetëror. Dhënia me koncesion do të vinte në rrezik investimet dhe do të rriste pasigurinë e vizitorëve, shumica e të cilëve janë me të ardhura të ulëta".

ka votuar dhe ka dhënë një vendim pa patur informacion për sasinë e ujit dhe se aty ka një institucion në varësi të Bashkisë, që ka godina, që ka vaska, ka administratë dhe që prurjet e ujit në total nuk janë më shumë se 8.7 litra në sekondë. Si mund të jepen 6.1 litra? Pyetja e tij është se "Kush e ka keqinformuar qëllimisht Inspektoratin teknik të Këshillit, për të dalë në atë vendim?"

Sipas deputetit Gjunkshi, fakti që mbledhja e Këshillit është zhvilluar me vetëm 13 anëtarë, kur ky këshill ka në fakt 23 anëtarë dhe dy përfaqësues të Bashkisë dhe DSHP Dibër, pavarësisht se deklarojnë se kanë votuar kundër, do kishin dalë nga kjo mbledhje, a do zhvillohej mbledhja dhe a do i jepnin kohë për t'u kundërshtuar ai vendim?".

Gjunkshi tha se "si përfaqësues i popullit të Dibrës në Kuvend dhe Partia Demokratike jemi në krahun e banorëve deri në zbardhjen e plotë të kësaj afere korruptivo-mafioze dhe anulimin e vendimit".

SHËRBIMI I HOTELERISË SHFAQ PASIGURI PËR TË ARDHMEN

Shkëlqim Çipuri është pronari i Hotel "Ballkan", i cili pozicionohet në hyrje të llixhave. Hoteli ka 40 dhoma, me një kapacitet prej 100 shtretërish.

I kontaktuar përmes telefonit, ai tha se janë të shqetësuar për dhënien me koncension të llixhave. Aq më tepër që këtë proces e kanë marrë vesh rastësisht, përmes personave që kanë kontakt me kompaninë që është e interesuar. Gjithashtu, ai tha se ka zëra se kompania ka edhe një kërkesë drejtuar Ministrisë së linjës dhe Bashkisë së Dibrës, për marrjen me qira të godinës. Këtë fakt, deputetja e Dibrës Almira Xhembulla e mohoi. Ajo tha se nuk ka një vendim për dhënien me konsencion ose me qira të llixhave.

Një punonjës i kompleksit të llixhave i tha gazetës në kushtet e anonimatit se, pavarësisht se po bëhet shumë zhurmë për marrjen në përdorim të ujërave nga kompania "Nesimi-Construction-78", aktualisht janë dy subjekte që ofrojnë shërbime hotelerike, të cilat kanë marrë ujë nga burimi dhe kanë ngritur pishina pranë hotelit të tyre. Dhe kjo nuk dihet se mbi çfarë vendimi është marrë.

Çipuri tha se kanë një marrëveshje të "pashkruar" me Qendrën Balneare. Ata bëjnë prenotimet dhe pagesat për klientët e tyre dhe në çmimet e ofruara përfshihen edhe shërbimet që kjo qendër ofron.

Çmimet në këto hotele apo shtëpi pritëse luhaten nga 1500-2000 lekë nata për person, ku përfshihet fjetja, ushqimi dhe pagesa e llixhave. Këto çmime janë shumë të lira në krahasim me banjat në Dibër të Madhe, ku një natë, çmimi standard është 24 Euro.

Ky ndryshim i madh në çmim çon që shumica e klientelës së llixhave të Peshkopisë të jenë qytetarë me të ardhura të pakta ekonomike nga rrethe të ndryshme të vendit.

"Investimet tona të deritanishme, - thotë Shkëlqim Çipuri, - janë bërë duke pasur parasysh se kompleksi është shtetëror. Dhënia me koncesion do të vinte në rrezik investimet tona dhe do të rriste pasigurinë e vizitorëve, të cilët shumica janë me të ardhura të ulëta".

Një banor i lagjes i tha korrespondentit tonë se që këtë vit kanë pasur rënie të vizitorëve, pasi kemi pasur rritje të çmimi të biletës nga 100 lekë në 200 apo 300 lekë, sipas preferencave të administratorit të llixhave. Ky ndryshim është shoqëruar edhe me ndryshimin e administratorit, së paku dy herë vitin e fundit.

Shkëlqim Çipuri thotë se janë të gatshëm të bisedojnë me bashkinë për nënshkrimin e kontratave paraprake për shfrytëzimin e ujërave termale, vendosjen e çmimeve dhe një plan koordinimi, të cilat do të duhet të jenë të detyrueshme, edhe nëse më vonë do të ndodhë dhënia me koncension e qendrës balneare.



Banorë dhe përfaqësues të bizneseve gjatë një takimi me deputeten znj. Almira Xhembulla

PAK INFORMACION MBI LLIXHAT E PESHKOPISË

Kompleksi balnear kurativ i ujërave termale të Peshkopisë shtrihet rreth dy kilometra në lindje të qytetit të Peshkopisë, në të djathtë të rrjedhjes të përroit të Bellovës, poshtë vargmalit të Deshatit. Ky kompleks ka 44 kabina individuale dhe disa kabinete terapeutike, të cilat përfshijnë trajtime të baltës sulfurore, fizioterapisë dhe aerosal terapisë. Gjithashtu, ka dy dhoma reaminacioni për trajtimin e rasteve urgjente.

Llixhat burojnë nga formacionet e gipseve të malit të Korabit. Janë dy burime sulfurore me temperaturë 35 - 43,5 gradë C dhe me një prurje prej 6-14 litra/sek, sipas periudhës.

Ato kanë përmbajtje kaliumi dhe sulfatesh. Efektet e tyre lidhen me sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes, aparatit lëvizës, sëmundjet e aparatit gjenital mashkullor dhe femëror si dhe shërimin e sterilitetit, reumatizmin, spondiliatrozën, nervin shiatik, sëmundjet e lëkurës, aknet dhe ekzemat, sëmundjet e aparatit tretës, gastritin dhe kolitin, sëmundjet e sistemit nervor periferik

Llixhat janë mjaft të rekomandueshme për dhimbjen e qafës, sidomos gjatë muajit tetor, që është dhe periudha më e përshtatshme për të shkuar.

Llixhat mund të shfrytëzohen gjatë gjithë vitit, por periudha me fluksin më të madh është në prill-maj dhe tetor.

PAQARTËSI E PASAKTËSI RRETH DOKUMENTACIONIT

Sipas burimeve në web, thuhet se prurjet e burimit të llixhave janë 14 litra në sekondë, ndërkohë që në vendimin e Këshillit të Basenit Ujor "Drin-Bune" thuhet se prurja mesatare vjetorë është 8.5 litra në sekondë, nga të cilat kompania e interesuar ka marrë leje vetëm për 6.1 litra.

Për të marrë lejen, "Nesimi-Construction-78" ka paraqitur 9 dokumente të ndryshme, të cilat për momentin nuk janë bërë publike dhe nuk i disponojnë as dy deputetët e Dibrës, Gjunkshi dhe Xhembulla, të cilët janë përfshirë në debatet publike mbi këtë çështje. Mes dokumenteve duhet të jenë kërkesa për lejen e përdorimit, projektin për skemën teknologjike, studimet hidrologjike, oponenca e studimit, projekti hidroteknik i marrjes dhe shfrytëzimit të burimit termal, raportet e ndikimit në mjedis etj.

Në dokumentet e disponueshme deri më tani nga redaksia apo të bëra publike nuk është e qartë nëse kompania po kërkon marrjen e kompleksit të llixhave apo marrjen e ujit në hyrje/dalje të kompleksit dhe po planifikon ndërtimin e një kompleksi të ri.

Koordinatat e veprës së marrjes së shënuara në vendimin e datës 11 dhjetor 2018 janë X-53 78 21.8 dhe Y = 46 16 779.2 dhe një ekspert i tha gazetës se ato janë krejtësisht gabim. Këto koordinata të nxjerrin jashtë Shqipërisë.

* * *

Për llixhat e Peshkopisë nuk është hera e parë që flitet për privatizim. Por kjo është hera e parë që rreth tyre bëhet një debat aq i madh. Që duket se nuk do të jetë i fundit. Problemi tani është i qartë edhe për banorët: si ajo do të bëhet dhe si do të ndahen përqindjet e fitimeve mbi të. Ndërsa pyetjes se kush qëndron pas privatizimit, përgjigjen në Dibër e dinë të gjithë: dikush që qëndron pas pushtetit...

"Vendimi për dhënien në përdorim të ujërave termale do të anulohet"

Nga **ALMIRA XHEMBULLA**
Deputete e Dibrës, PS



Dua të ndaj sot me ju një shqetësim madhor të zonës që përfaqësoj, shqetësim i cili, falë vullnetit të Kryeministrit Rama dhe përpjekjeve të përbashkëta, duket se ka hyrë në rrugën e zgjidhjes.

E kam fjalën për një vendim të marrë nga Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë, i cili më datë 11 Dhjetor 2018 vendosi për miratimin e lejes për përdorim të ujërave termale në qytetin e Peshkopisë, subjektit "Nesimi-Construction-78". Duke qenë se respektoj të drejtën e biznesit, nuk dua të ndalem te subjekti dhe te përfshirja apo angazhimi i tij në politik. Dibranët e kanë këtë informacion.

Të prekur nga ky vendim, disa qytetarë dhe biznesmenë të zonës më kontaktuan menjëherë, duke përcjellë shqetësimin e tyre si pranë meje, po ashtu edhe pranë Kryetarit të Bashkisë Dibër, z.Muharrem Rama.

Personalisht, pasi komunikova edhe me kryetarin e bashkisë, i cili me siguroi që vota e përfaqësuesve të Dibrës në bord ka qenë kundër vendimit, e përcolla menjëherë shqetësimin dhe kërkova informacion mbi këtë vendimmarrje pranë zyrës së Kryeministrit, përpara se çështja të bëhej publike. Dhe, menjëherë, mora një përgjigje prej tyre, ku më siguruan që çështja do të trajtohej me përparësi maksimale dhe me njoftuan që është ngritur një grup pune për shqyrtimin në detaje të kësaj vendimmarrje. Kjo është e vërteta.

Ndërkohë, banorët dhe biznesi vendas më kërkuan një takim urgjent, pasi shqetësimi dhe ndjeshmëria e çështjes ishte shumë e lartë. Por, pikërisht për të qenë shumë e përgatitur dhe e qartë, bashkë me përfaqësues të grupit të punës, ekspertë të agjencisë të menaxhimit të burimeve ujore dhe me kryetarin e bashkisë, organizuam një dëgjesë publike, ku ju bëmë me dije vullnetin e qeverisë për ta anuluar këtë vendimmarrje. Siguruisht, në bazë të procedurave ligjore dhe argumenteve të qenësishme.

I falënderoj banorët dhe biznesmenët e zonës, të cilët edhe pse mes një presioni të madh për shkak se kjo vendimmarrje i cenon drejtpërdrejtë, kanë mbajtur me ne kontakte të vazhdueshme dhe korrekte.

Këmbëngulja jonë për ta kundërshtuar këtë vendim dhe për të mbështetur kërkesat e drejta të qytetarëve dhe biznesmenëve dibran mbështetet në disa arsye të rëndësishme:

Së pari, më lejoni të theksoj se personalisht që në krye të herës isha kategorish kundër kësaj vendimmarrje dhe ndaj të njëjtin shqetësim me të gjithë qytetarët dibranë, të cilët prej disa ditësh kanë ditur që të kërkojnë të drejtën e tyre përmes reagimeve qytetare, duke nisur me përcjelljen e problematikës pranë meje dhe autoriteteve lokale, vullnetin për të marrë pjesë në takime dhe dëgjesën publike të organizuar për këtë rast, më kërkesa të drejtuara qeverisë përmes portalit shqipëriaqëduam.al, si dhe me protesta paqësore që nuk kanë cenuar asgjë nga prona dhe interesi i përbashkët publik.

Së dyti, më lejoni të theksoj se qendra e ujërave termale në qytetin e Peshkopisë është një nga pasuritë më të mëdha të mëdha të këtij qyteti, cenimi i së cilës do të kishte pasoja të mëdha sociale dhe ekonomike për të gjithë qytetarët. Figurativish, është "si me i marrë detin Vlorës".

Së treti, vendimi i marrë nga Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë cenon në mënyrë direkte aktivitetin e rreth 30 hoteleve të ndërtuar në rrethinat qendrës balneare dhe që mirëpresin me mijëra vizitorë/turistë çdo vit në sezone të caktuara. Përveç këtyre bizneseve, janë mbi 500 familje të cilat përmes shërbimeve të ndryshme përfitojnë nga prania e këtyre vizitorëve.

Së katërti, nuk duhet harruar fakti se një problem i përbashkët për të gjitha bizneset e kësaj zone është se ato janë investime të bëra në kushte të vështira financiare e me shumë sakrifica prej tyre. Dhënia për përdorim e ujërave tek një biznes privat mund të çojë në falimentimin e të gjithë këtyre bizneseve, por pse jo, brenda një periudhe të shkurtër mund t'i hapë rrugë edhe një situate monopoli të administrimit të njërës nga zonat më të rëndësishme të qytetit.

Çështja e pestë që nuk duhet neglizhuar në këtë rast është se vendimi i Këshillit Kombëtar të Ujit cënon edhe punën e së paku 400 personave që janë punësuar në këto biznese, në një moment kur kërkesa për vende pune në Dibër vijon të jetë akoma e lartë.

Shqetësimi im i gjashtë ka të bëjë më atë se dhënia për përdorim e ujërave termale do të ndikojë në rritjen e çmimeve që do të aplikohen ndaj vizitorëve në këtë qytetet, shumica e të cilëve janë besnikë dhe e vizitojnë qytetin pothuajse çdo vit, falë kjo edhe vlerave kurative që ka kjo qendër. Llixhat tona nuk janë luks, por domosdoshmëri për ata që i vizitojnë. Dua të sjell në vëmendje se për momentin çmimet e aplikuara nga hotelet e zonës janë ndër më të ulëtat në vend dhe rajon.

"Personalisht, që në krye të herës, isha kategorish kundër kësaj vendimmarrje dhe ndaj të njëjtin shqetësim me të gjithë qytetarët dibranë, të cilët prej disa ditësh kanë ditur që të kërkojnë të drejtën e tyre përmes reagimeve qytetare, duke nisur me përcjelljen e problematikës pranë meje dhe autoriteteve lokale, vullnetin për të marrë pjesë në takime dhe dëgjesën publike të organizuar për këtë rast, më kërkesa të drejtuara qeverisë përmes portalit shqipëriaqëduam.al, si dhe me protesta paqësore që nuk kanë cenuar asgjë nga prona dhe interesi i përbashkët publik".

Por, më e rëndësishme është se kjo vendimmarrje nuk është konsultuar me asnjë nga grupet e interesit.

Për të qenë e vërtetë deri në fund, menaxhimi dhe administrimi i kësaj pasurie nuk është bërë asnjëherë ashtu siç duhet dhe situata ka nevoje për një analizë të thellë. Por, plani për rehabilitim e zonës për ta shndërruar atë në "luginën e shërimit" duke integruar të gjithë elementet e turizmit, qofte kurativ, por edhe agro-malor, ekziston dhe bashkia Dibër është në përpjekje për të gjetur donatorë për këtë projekt madhor.

Gjëja më e rëndësishme që dua të ndaj sot është që, përkundrejt skepticizmit dhe mosbesimit të shumicës, dua të bej me dije që pardje është lëshuar një shkresë zyrtare drejtuar Prefektit të Shkodrës, nga ku i kërkohet të thërrasë në mbledhje të jashtëzakonshme Këshillin e Basenit Ujor Drin-Bune, ku do të trajtohet projekt-vendimi i anulimit të vendimit nr. 4, datë 11.12.2018. U bëj thirrje ta realizojnë këtë mbledhje sa më shpejt.

Një tjetër kauzë e fituar nga qytetarët me qytetarët. Faleminderit Kryeministrit, faleminderit Kryetarit të Bashkisë dhe Prefektit të Dibrës për punën e mirë në ekip.



Skandali me privatizimin e Llixhave, një mega aferë korruptive

Nga **XHEMAL GJUNKSHI**
Deputet i Dibrës, PD.

Prej disa ditësh lajmi për një vendim korruptiv për dhënien me koncesion të ujit të llixhave ka trazuar jo vetëm banorët e lagjes së Llixhave por të gjithë dibranët.

Vendimi është marrë me 11.12.2018, dhe ka dalë në dritë vetëm pak ditë më parë. Në atë mbledhje të Këshillit të Basenit ujor Drin - Bunë, përfaqësuesit e Bashkisë dhe prefekturës justifikohen se kanë votuar kundër dhe se gjoja nuk kanë patur kohën e duhur për të njoftuar Këshillin Bashkiak, por nuk sqarojnë pse e kanë mbajtur të fshehur vendimin.

Atëherë pse Bashkia Dibër shtiret sikur s'ka patur informacion?

Në fakt drejtori i Bujqësisë në Bashki, përfaqësues në Këshillin e Basenit Drin - Bunë nuk paska patur kohë një muaj për të informuar Bashkinë.

Si ka mundësi Kryetari i Bashkisë nuk ka informacion kur ka çuar Drejtorin me dieta që e përfaqëson, dhe në anën tjetër shkon përpara banorëve me përfaqësuesin e kompanisë që ka marrë me koncesion ujin?!

Këshilli i Basenit e ka njoftuar disa herë Bashkinë për të marrë ujin në përdorim dhe kjo e fundit nuk ka shkuar ...

Pse Bashkia nuk ka shkuar për ta marrë në përdorim ujin e Llixhave, duke qene se ajo e kishte në përdorim në fakt...?!

A ka njeri që nuk e kupton këtë lojë?! Bashkia e ka lënë qëllimisht këtë shteg, për të depërtuar dhe për të ndihmuar dhënien me koncesion. Pra, Bashkia e paska ditur, se llixhat mund ti marrë dikush tjetër kur nuk i merr vetë.

Këshilli i Basenit ujor në Shkodër ka votuar dhe ka dhënë një vendim pa patur informacion për sasinë e ujit, dhe se aty ka një institucion në varësi të Bashkisë, që ka godina, që ka vaska, ka administratë dhe që prurjet e ujit në total nuk janë më shumë se 8.7 litra në sekondë. Si mund të jepen 6.1 litra?

Atëherë kush e ka keq informuar qëllimisht inspektoratin teknik të Këshillit, për të dalë në atë vendim?

Po përfaqësuesi i DSHP që na paska votuar kundër, pse nuk ka informuar se ky vendim për llixhat

Në atë mbledhje të Këshillit të Basenit ujor Drin - Bunë, përfaqësuesit e Bashkisë dhe prefekturës justifikohen se kanë votuar kundër dhe se gjoja nuk kanë patur kohën e duhur për të njoftuar Këshillin Bashkiak, por nuk sqarojnë pse e kanë mbajtur të fshehur vendimin.

është marrë në Shkodër?!

Pse mbledhja e Këshillit është zhvilluar me vetëm 13 anëtarë kur ky këshill ka në fakt 23 anëtarë?

Po nëse këto dy përfaqësues të Bashkisë dhe DSHP Dibër do kishin dalë nga kjo mbledhje a do zhvillohej mbledhja dhe a do i jepnin kohë për t'u kundërshtuar ai vendim?

Këto janë disa nga pikëpyetjet që shoqërojnë këtë vendim korruptiv, këtë aferë për marrjen dhe gllabërimin e llixhave të Dibrës.

Pra, të gjitha institucionet që vetë Dibranët i kanë votuar, apo edhe u kanë blerë votën në vend që të mbajnë anën e banorëve, i marrin ato për budallenj duke i nëpërkëmbur e duke mbështetur projekte e klane mafioze që kanë për qëllim marrjen e ujit të llixhave.

Unë, si përfaqësues i popullit të Dibrës në Kuvend, dhe Partia Demokratike jemi në krahun e banorëve deri në zbardhjen e plotë të kësaj afere korruptivo-mafioze dhe anullimin e vendimit.

Askush nuk mund ta marrë ujin e llixhave në dëm të 35 hoteleve, të më shumë se 200 shtëpive pritëse, të më shumë se 2 mijë banorëve të lagjes, por edhe gjithë Dibrës, pasi secili preket nga ky koncesion korruptiv.

SHËNIM I REDAKSISË

Në procesin e privatizimit të llixhave ka shumë aktorë, të cilët janë përfshirë direkt ose indirekt. Redaksia mbetet e hapur për të botuar çdo qëndrim të tyrin në këtë proces. Redaksia mbetet e interesuar për të informuar publikun në lidhje me këtë proces, por nuk mban anë. Ana jonë në këtë proces është interesi publik.

Dibër e Madhe: Shkarkohe Eugjen Cami si ushtrues detyre i kryetarit të komunës dhe në vend të tij zgjidhet Hekuran Duka nga radhët e BDI.

PROJEKTVENDIMI

KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË SHFUQIZON VENDIMI:

Revokohet leja për dhënien në përdorim të ujërave termale

4 SHKURT 2019-Ndërkohë që kjo gazetë po shkonte për shtyp, Prefekti i Shkodrës në Shkodër Çesk Millja u ka nisur një ftesë anëtarëve të Këshillit të Basenit Ujor Drin-Bunë për një mbledhje të jashtëzakonshme më datë 5 shkurt, ora 10:00, me rend dite revokimin e lejes së dhënë më datë 11 dhjetor 2018.

Në relacionin shoqërues, shkruhet se "subjekti që kërkon të ushtrojë veprimtarinë e shfrytëzimit të ujërave termale duke përdorur mjediset e kompleksit Balnear, i cili me anë të VKM-së nr. 378, datë 12.8.1999, i ka kaluar në pronësi Bashkisë Dibër, një fakt ky i panjohur për anëtarët e KB Drin-Bunë në momentin e vendimmarrjes, madje as përfaqësuesit e vetë bashkisë Dibër, anëtare të Këshillit, nuk kanë deklaruar këtë akt nënligjor, element parësor".

Sipas relacionit në fjalë, pas hetimit administrativ nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, rezulton se "kuota Z e veprës së marrjes nuk është e saktë, pasi edhe nga harta rezulton të jetë rreth 720 m, dhe jo 602 m. Projekti dhe vizatimet janë me kuota të sakta, por nuk përputhen me lejen e zbardhur.

Projektvendimi i anulimit përshkruan koordinatat e pikës së marrjes sipas sistemit GausKryger X = 4616955, Y = 4454695, ndërsa në vendimin e datës 11 dhjetor 2018 këto koordinata janë X = 537821.8, Y = 4616779.2.

Megjithatë, hetimi administrativ ka gjetur se ka mospërputhje midis të dhënave të formularit të aplikimit, studimeve, relacioneve dhe vizatimeve.

Gjithashtu, hetimi ka nxjerrë se rezultati i analizave të ujit është i datës 17 janar 2019, pra në momentin e vendimmarrjes nuk ka qenë pjesë e praktikës si dhe nuk është realizuar konsultimi me publikun.

Më poshtë projektvendimi flet për bazën ligjore të anulimit të këtij vendimi.

Megjithatë, pavarësisht vendimit të datës 5 shkurt 2019, duket se ky proces kërkohet të kalohet si rutinë e zakonshme punë e zyrtarëve lokalë e qendrorë. Ndërsa gjithë procedura tashmë duket se është përgatitur me ngut. Një hetim administrativ duhet të bërë edhe për zyrtarët, të cilët me ose pa vetëdijë, lejuan që kjo të ndodhte.

Vendi vakant për kryetarin e komunës në Dibër të Madhe kthehet në luftë politike mes BDI dhe ASH

Pas ndarjes nga jeta të z, Ruzhdi Lata, i cili mbante funksionet e kryetarit të komunë së Dibrës së Madhe, duket se institucioni është futur në një krizë gjatë muajit janar.

Eugjen Cami u zgjodh më 10 dhjetor 2018 ushtrues i detyrës së kryetarit të komunës, por gjatë punës ë tij ai ka sjellë pakënaqësi në radhët e anëtarëve të këshillit bashkiak nga radhët e BDI.

Eugjen Cami ishte përfaqësue i partisë Aleancë për Shqiptarët, e cila është në një opozitë dhe në një luftë të ashpër politike me BDI.

Më 17 janar 2019, gjatë një mbledhje rutinë të këshillit komunal, u mor një vendim i papritur për zëvendësimin e z. Cami të Aleancës për Shqiptarët (ASH) me z. Hekuran Duka nga radhët e partisë Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI).

Ky vendim u konsiderua i jashtëligjshëm nga ASH. Sipas tyre, parashikon që seancat e Këshillit si dhe pikat e rendit të ditës detyrimisht të shpallen 7 ditë para mbajtjes së seancës, ndërsa këshilltarët materialet i pranuan 3 ditë para mbajtjes së seancës dhe atë me pikë të rendit të ditës: "Plani lokal për veprim për komunën e Dibrës në fushën e Punësimit, Banimit, Arsimit dhe Shëndetësisë në periudhën 2019-2020 për romët e komunës së Dibrës". Aleanca, përmes një deklarata renditi edhe arsyet e tjera ligjore për ndërprerjen e mandatit, të gjitha - sipas tyre, në shkelje të ligjit dhe Kushtetutës së Maqedonisë.

BDI i kishte paraprirë zëvendësimit të ushtruesit të detyrës me dy deklarata, përkatësisht më date 11 janar dhe 15 janar, ku akuzonte ASH se "po e turpëronte Dibrën".

"Precedenti i turpshëm me mënyrën se si qeveriset Komuna e Dibrës këta dy muaj , është precedent i pandodhur ndonjëherë më parë në Dibër. Gjë që tregon fytyrën e vërtetë të një grupacioni politik të paaftë dhe dashakeqe", thuhej në një nga deklaratat e BDI. Ata akuzonin z. Cami për kthimin e zyrës së kryetarit të komunës në një zyrë partie si dhe rrjedhjen e "dokumentacione zyrtare nëpër duar, të pa autorizuar dhe me tendenca që secili anëtar veç e veç të merr meritat për ndonjë punë në Komunë".

Gjatë një deklarate tjetër më 17 janar, BDI deklaronte se "që me zgjedhjen e kryetarit të përkohshëm, ne e konsideruam se u zgjodh kryetari i pakicës, pa mbështetjen në masë të qytetarëve të Dibrës. Por pranuam këtë zgjedhje dhe me kujdes të shtuar monitoruam veprimet çoroditëse të Partisë Aleanca për Shqiptarët. Gjuha e urrejtjes në reagimet publike të partisë që udhëheq sot komunën, është krejtësisht të papranueshme, për një parti në pushtet lokal".

Deklarata e BDI theksonte se "është krejtësisht autokratike që një parti që qeveris të krijojë këtë ndasi dhe të përdori këtë gjuhë të urrejtjes në qytet... Gjuha me mendësi autoritare, gati fashiste që përdor Partia Aleanca për shqiptarët në reagimet e tyre publike, është një alarm i madh për demokracinë lokale, liritë dhe të drejtat e njeriut, lirinë e shprehjes së mendimit. Linçimi dhe agresiviteti jashtë institucional i kësaj partie na kujton dhe na rikthen në kohë që konsideronim se ishin e shkuara e errët e këtij qyteti".



Në foto: Zyrat e Komunës në Dibër të Madhe. Poshtë: Hekuran Duka (majtas) dhe Eugjen Cami

BDI akuzonte se "zyra e kryetarit të komunës është zaptuar nga partia që qeveris, dhe dokumente që duhet të lexohen veçse nga stafi i Komunës, qarkullojnë në duart anëtarëve të partisë".

"Kjo gjendje është krejtësisht e patolerueshme dhe për këto arsye serioze, që janë këmbanë e fortë e autokracisë që po lind sjellim mocion mosbesimi ndaj kryetarit të përkohshëm z.Eugjen Cami, zgjedhur nga ky Këshill, për arsye se delegon kompetenca jashtë institucionit, në partinë e tij dhe nuk reagon për të ndalur gjuhën e urrejtjes dhe polarizimin ekstrem mes qytetarësh".

Pas kësaj date deklarata politike të dy partive politike në Dibër të Madhe kanë vazhduar në median lokale dhe rrjetet sociale.

Eugjen Cami, në disa deklarata pas kësaj date i ka quajtur vendimet e datës 17 janar të këshillit komunal të jashtëligjshme.

Megjithatë, gjatë një fjalimi më 31 janar para këshillit komunal, ai ka pranuar të lëshojë detyrën.

"Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij "tempulli",dhe përgjegjësinë që kemi ndaj qytetarëve të cilët na zgjodhën që ne të jemi këtu për të mbrojtur dhe përfaqësuar me dinjitet interesat dhe shqetësimet e tyre, nga ju të nderuar Këshilltarë, pa dallim bindjeve dhe përkatësive politike, kërkova dhe shpresova në një bashkëpunim të sinqertë me ju. Fatkeqësisht, nga e gjithë kjo që u tha dhe u pa sot në këtë seancë, por edhe më përpara, unë jam i zhgënjyer. E gjithë kjo më jep të mendoj dhe të besoj se disa këshilltarë, për të mbuluar aferat e keqpërdorimit të detyrës dhe buxhetit, në bashkëpunim me individë partiakë, me instruksionet nga lartë dhe me ndihmën e inspektoratit shtetëror, ndërmorën vendim për shkarkimin tim si Ushtrues Detyre Kryetar Komune. Ky veprim i juaji, mua si Eugjen Cami nuk më demoralizon, përkundrazi më bën më krenar. Jam i edukuar të punoj drejt dhe me ndërgjegje të pastër në përputhshmëri me ligjet, për të mirën e qytetit tim dhe dibranëve në veçanti, gjë që e kam dëshmuar në karrierën time gjatë këtyre 29 viteve të pluralizmit dhe demokracisë.

Ai e ka pranuar vendimin e Këshillit Komunal dhe i ka kërkuar administratës që të bëjë gati gjithë materialin e kësaj seance dhe të shpallë në fletën zyrtare të kuvendit shkarkimin e tij.

Ai i uroi detyrën ushtruesit të detyrës z. Hekuran Duka, dhe e ftoi që të nesërmen, më 1 shkurt, të shkonte në zyrë dhe të merrte çelësat dhe "ta pijmë një kafe për të treguar qytetari".

Më datën 8 shkurt pritet që në Maqedoni të shpallet zgjedhjet e reja presidenciale dhe po në këtë datë do të ketë edhe zgjedhje për kryetarin e Komunës së Dibrës së Madhe.

Deri atëherë, duket se dy partitë do të qëndrojnë ballë për ballë me deklarata të ashpra dhe akuza ndaj njëra-tjetrës.

B.KAROSHI

Akuza e BDI:
Zyra e kryetarit të komunës është zaptuar nga partia që qeveris, dhe dokumente që duhet të lexohen veçse nga stafi i Komunës, qarkullojnë në duart anëtarëve të partisë.

Eugjen Cami:
"Disa këshilltarë, për të mbuluar aferat e keqpërdorimit të detyrës dhe buxhetit, në bashkëpunim me individë partiakë, me instruksionet nga lartë dhe me ndihmën e inspektoratit shtetëror, ndërmorën vendim për shkarkimin tim si Ushtrues Detyre Kryetar Komune. Ky veprim i juaji, mua si Eugjen Cami nuk më demoralizon, përkundrazi më bën më krenar. Jam i edukuar të punoj drejt dhe me ndërgjegje të pastër në përputhshmëri me ligjet, për të mirën e qytetit tim dhe dibranëve në veçanti, gjë që e kam dëshmuar në karrierën time gjatë këtyre 29 viteve të pluralizmit dhe demokracisë".

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT!

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit.
Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit ose ndiq linkun: https://tinyurl.com/lcc3e2f

Rruga e Arbërit nr. 153
trajtesë

Në vitin 1932, në kohën kur antisemitizmi në Europë ishte kthyer në doktrinë, Shqipëria u bë vendi i parë dhe i vetëm në kontintent që u njohu hebrenjve të drejtën e organizimit në bashkësi dhe legjitimoi shabbat-in.

Hebrenjtë në Shqipëri gjatë Holokaustit

Nga prof. **Shaban SINANI**

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Kujtesës, Organizata e Kombeve të Bashkuara, Kongresi Hebraik i SHBA dhe Misioni i Shqipërisë në New York; nën kujdesin e *Department of Global Communications United Nations,* më 31 janar 2019 u organizua në mjediset e OKB-së veprimtaria shkencore me titull *A matter of humanity: "The Rescue of the Jews during the Holocaust"*, kushtuar rastit të Shqipërisë.

Trajtesa që po botojmë është përgatitur nga autori për këtë ngjarje shkencore.



Credit: United States Holocaust Memorial Museum, courtesy of Johanna Neumann

The Department of Global Communications
and the Permanent Mission of Albania
invite you to
the United Nations Civil Society Briefing

A Matter of Humanity: The Rescue of Jews in Albania during the Holocaust

Thursday, 31 January 2019
Conference Room 1
11:00 a.m. - 12:30 p.m.

Register by Wednesday, 23 January
https://bit.ly/2FVcOWH

Speakers:
- H.E. Ms. Besiana Kadare, Permanent Representative of Albania to the United Nations
- Ambassador Ronald Lauder, President of the World Jewish Congress
- Prof. Shaban Sinani, historian and author of the book *Albanians and Jews: The Protection and Salvation*
- Dr. Anna Kohen, whose family was rescued in Albania during the Holocaust
- Mr. David Estrin, Founder of "Together We Remember"

The Holocaust and the United Nations Outreach Programme

PERMANENT MISSION OF THE REPUBLIC OF ALBANIA TO THE UNITED NATIONS

WJC WORLD JEWISH CONGRESS

United Nations
Civil Society Unit

Në vitin 1932, në kohën kur antisemitizmi në Europë ishte kthyer në doktrinë, Shqipëria u bë ***vendi i parë dhe i vetëm në kontintent*** që u njohu hebrenjve të drejtën e organizimit në bashkësi dhe legjitimoi *shabbat*-in. Është rasti i vetëm i *diskriminimit pozitiv* të hebrenjve gjatë dekadave kur bota lëngonte nga judeofobia.

E drejta e komunitetit inkurajoi ambasadorin amerikan në Tiranë Herman Bernstein, një figurë qendrore e lëvizjes sioniste botërore (bashkë me A. Einsten-in dhe Ben Gurion-in), që të niste menjëherë negociatat me ambasadorin shqiptar në SHBA Faik Konica për të arritur një ***marrëveshje ndërshtetërore shqiptaro-amerikane për pranimin në Shqipëri të 500 familjeve hebreje***. H. Bernstein e vizitoi kuadrat për kuadrat, me hartë në dorë, gjithë territorin e pabanuar të Shqipërisë bregdetare, që nga Buna deri në Vjosë, me qëllim që instalimi i familjeve hebreje të realizohej pa cenuar asnjë interes individi, asnjë pronë private, pa shkaktuar asnjë provokim.

Misionarë të Kongresit Botëror të Hebrenjve, të Komisariatit të Lartë të Refugjatëve dhe të Lëvizjes Sioniste negociuan intensivisht me qeverinë mbretërore gjatë viteve 1933-1935, duke vijuar të njëjtin projekt të ambasadorit Bernstein. Në vitin 1935 Tiranën e vizitoi misionari i mandatuar Leo Elton, i cili pati bisedime me dy ministra, të ekonomisë dhe të oborrit mbretëror, dhe me ta arriti marrëveshjen që Shqipëria të pranonte masivisht hebrenjtë e rrezikuar dhe ata të vendoseshin në territore të lira, në formën e ngulimeve, të ngjashme me *kibutz*-et e sotme. Raporti i misionarit Leo Elton iu dorëzua Rektorit të parë të *Hebrew University* prof. Judah Leib dhjetë vjet më vonë, ku ruhet edhe sot i sekretuar. Ato pak fakte që kanë dalë nga ky raport prej rreth 50 fletësh bëjnë të njohura të njëjtat të dhëna që përmbajnë burimet e arkivave shqiptare. Në këto dokumente Shqipëria cilësohet në mënyrë terminologjike ***atdhe i dytë*** dhe ***atdhe rezervë i hebrenjve***. Ndërsa shtypi europian i asaj kohe shkroi me panik se ***Shqipëria po izraelitizohej***, po kthehej në një ***Palestinë të dytë*** (si shteti i atëhershëm *Mandatory Palestine*, që qeverisej nën protektoratin britanik).

Ardhja e hebrenjve në Shqipëri u lehtësua edhe nga marrëveshja midis qeverisë austriake dhe asaj të Tiranës për heqjen reciproke të vizave (1931).
Në vitin 1932 në Shqipëri kishte 200 hebrenj rezidentë. Deri në prag të luftës numri i hebrenjve të ardhur ishte gati 1000.
Dy aktet më restriktuese për hyrjen e hebrenjve në Shqipëri janë të muajve shkurt dhe mars 1939.

Pikërisht kjo është koha kur për herë të parë Italia fqinje, e cila, me një vendim të posaçëm të Konferencës së Ambasadorëve (1921), kishte fituar ***paketën e privilegjeve mbi Shqipërinë***, filloi të alarmohej. Një informator i posaçëm iu shtua në personelit të Ambasadës së Italisë në Tiranë, për të raportuar vetëm për hyrjen e hebrenjve. Në një prej teksteve të shifruar të informatorit (1936) thuhet: ***Pa dashur të shkaktoj alarm tek ju (në Farnesina), duhet t'ju them se simpatia shqiptare për ne shumë shpejt do të mbarojë dhe vendin tonë do ta zënë hebrenjtë***. I njëjti informator, në një radiogram tjetër të mëpasmë, shkruan: *Sot, si çdo ditë, shkova në kafe "Kursal" në kërkim të të rejave për hebrenjtë. Por, sa isha ulur në tryezë, brenda hyri një hebreje polake aq e bukur, sa u shastisa fare dhe s'kam fare çfarë të raportoj*.

Ardhja e hebrenjve në Shqipëri u lehtësua edhe nga marrëveshja midis qeverisë austriake dhe asaj të Tiranës për heqjen reciproke të vizave (1931).

Në vitin 1932 në Shqipëri kishte 200 hebrenj rezidentë. Deri në prag të luftës numri i hebrenjve të ardhur ishte gati 1000. Pati presione nga Roma për të përshtatur ligjet anti-semite që ishin miratuar në Itali dhe Gjermani, por jo me ton urdhërues. Dy aktet më restriktuese për hyrjen e hebrenjve në Shqipëri janë të muajve shkurt dhe mars 1939. Janë dy vendime të qeverisë për ta kushtëzuar hyrjen e hebrenjve me ***deklarimin*** se kanë 250 franga dhe në vendimin e dytë - 500 franga pasuri me vete.

Politika italiane edhe gjatë luftës iu përshtat realitetit shqiptar. Në vitin 1942, në shërbimin e xhenios në Durrës, që e komandonte pikërisht një prej presidentëve të ardhshëm të Italisë republikane, Carlo Aseglio Ciampi, në atë kohë i mobilizuar ushtarakisht në luftë, kishte së paku 20 hebrenj të punësuar. Slogani i mëkëmbësisë fashiste për hebrenjtë në Shqipëri ishte: ***Sorvegliare, non toccare, non punire***.

Gjatë viteve 1939-1943 në Shqipëri kanë hyrë afro 2000 hebrenj. Grupet më të mëdha janë tre: 94 familje dhe 87 individë nga Kosova (1942); 182 hebrenj nga Mali i Zi (1942) dhe 350 nga Dalmacia (1942). Për paradoks, ***hebrenjtë e Dalmacisë edhe sot konsiderohen të zhdukur***. Por ruhen listat e pranimit të tyre në Durrës dhe pastaj të shpërndarjes nëpër vendbanime të sigurta. Në listat e hartuara gjatë periudhës fashiste janë shenjuar 3265 emra hebrenjsh. Asnjë prej tyre nuk është deportuar, kallëzuar apo dorëzuar. Më pas nuk ka pasur më listime. Në Shqipëri s'ka pasur as kampe pune, as kampe përqendrimi, as kampe shfarosjeje. ***Ka pasur vetëm kampe tranzitimi***. Hebrenjtë e ardhur regjistroheshin, sistemoheshin në ndërtesa shtetërore të përshtatura si rezidenca të përkohshme (klinika, posta, nënprefektura etj.) dhe pastaj ***zhvendoseshin në hinterland***, larg rrezikut. Gjatë këtyre viteve, hebrenjtë që qendronin përkohësisht në kampe, ***kishin dhe një të drejtë diete*** (*giornaliera*).

Në shtator të vitit 1943, kur ish-ambasadori i Reich-ut në Beograd Herman Neubacher, që mbulonte edhe Shqipërinë, në bisedimet me katër përfaqësuesit e bashkësive fetare për të pranuar formulën ***pavarësi relative kundrejt neutralitetit relative***, lejoi çdo diskutim, me përjashtim të tre kushte të panegociueshme: **i)** dorëzimin e listave të hebrenjve; **ii)** dorëzimin e arit monetar që ruhej në Romë dhe **iii)** dorëzimin e ***dy ungjijve të shenjtë*** (dy kodikët e Beratit). ***Katër negociatorët refuzuan kategorikisht fillimin e bisedimeve nëse do të mbetej kusht dorëzimi i listave të hebrenjve*** (dhe listat e të gjithë të huajve që gjendeshin ndërkaq brenda në Shqipëri), sepse u konsideruan të domestikuar e të hospitalizuar tashmë. ***Katër negociatorët po atë ditë pranuan dorëzimin e floririt*** dhe ***heshtën për dy kodikët*** (por fshehurazi njoftuan mitropolinë e Beratit për rrezikun). Listat u kërkuan edhe dy herë të tjera: në prill 1944 dhe në qershor 1944 (Pinkas Hakehillot). Më pas qendrimi i Reich-ut ka qenë: ***Me shqiptarët nuk merremi vesh dot në këtë pikë, prandaj kjo çështje të mos hapet më***.

Në tetor të vitit 1943, në takimin midis përfaqësuesve të lartë të Gestapo-s Mueller dhe atij të ministrisë së punëve të jashtme Thaden zhvilluar në Berlin, u vendos që për të gjitha vendet që sapo kishin hyrë nën kontrollin e Reich-ut, pas kapitullimit të Romës, të zbatohej formula *final solution*. ***Rasti i Shqipërisë u trajtua më vete***. Në procesverbal thuhet: *Autoritetet e Shqipërisë kanë një ndjeshmëri shumë të lartë ndaj kësaj çështjeje. Ata konsiderojnë se pavarësia relative që u kemi njohur është demagogjike nëse preken hebrenjtë dhe të huajt* që gjenden në shtetin e tyre, ***që ata e kuptojnë "nën mbrojtjen e tyre"***. Duke qenë se ata e quajnë këtë një ***çështje të brendshme***, hë për hë të mos ndërmerret asnjë veprim. Dhe, nëse do të parashihet një ndryshim qendrimi, asnjëherë nuk do të veprohet pa njoftuar dhe pa marrë pëlqimin e autoriteteve shqiptare.

Në periudhën naziste në Shqipëri për hebrenjtë kishte ***names, no numbers***: qysh më herët të gjithë hebrenjtë ishin të listuar dhe këto lista i kishin në duar qeverisësit. Referuar së drejtës cezariane, duhet pohuar se populli kishte mundësi t'u jepte hebrenjve bukë e punë, qeleshe dhe kostum popullor, një emër shqiptar dhe një lidhje të shpikur farefisnie, por ***listat nuk ishin në duart e popullit***.

Në periudhën naziste në Shqipëri për hebrenjtë kishte names, no numbers: qysh më herët të gjithë hebrenjtë ishin të listuar dhe këto lista i kishin në duar qeverisësit. Referuar së drejtës cezariane, duhet pohuar se populli kishte mundësi t'u jepte hebrenjve bukë e punë, qeleshe dhe kostum popullor, një emër shqiptar dhe një lidhje të shpikur farefisnie, por listat nuk ishin në duart e popullit.

Gjatë luftës, palët e papajtueshme për asnjë kompromis, partizanë e nacionalistë, megjithatë, u morën vesh që hebrenjtë të mos i përfshinin në ngatërresat e tyre. Këto marrëveshje janë finalizuar edhe me tekste me shkrim.



SHQIPTARËT DHE HEBRENJTË
Mbrojtja dhe shpëtimi
Botimet "Naimi"

ISBN 978-9928-106-66-8
Faqe 400
Çmimi: 1500 lekë

Prej disa dekadash ka një debat të ndezuar midis shqiptarëve, nëse lufta antifashiste ka qenë vërtet një luftë çlirimtare apo një luftë civile. Kjo ka lidhje me ashpërsinë e konfliktit midis antifashistëve dhe kolaboracionistëve. Por, pavarësisht prej kësaj ashpërsie, gjatë luftës, ***palët e papajtueshme për asnjë kompromis, partizanë e nacionalistë, megjithatë, u morën vesh që hebrenjtë të mos i përfshinin në ngatërresat e tyre. Këto marrëveshje janë finalizuar edhe me tekste me shkrim.***

1. Shqipëria është vendi i vetëm në Ballkan ku përbërësja fetare nuk ka rol në identitet. Atje ku kishte katër komunitete fetare, një komunitet i pestë nuk ishte kurrfarë problemi.
2. Në etnotipin shqiptar ka një sjellje që vërtetohet historikisht e sistematikisht. Në vetëdijen e njeriut shqiptar është tabù të rrezikosh të mundurin, të çarmatosurin dhe përgjithësisht tjetrin në rrezik, qoftë dhe kundërshtari.

Një prej pikëpyetjeve më problematike për rolin e shqiptarëve gjatë Holokaustit lidhet me fatin e hebrenjve në Kosovë. Pyetja dyshimtare, e shtruar edhe nga studiues seriozë (B. Fischer), është ***nëse ka pasur dy qendrime të ndryshme shqiptare ndaj hebrenjve***. Ky dyshim ka lindur ngaqë në ishmbretërinë serbo-kroato-sllovene, bashkë me pesë divizione të tjera vullnetare SS, ka ekzistuar dhe një divizion SS me vullnetarë shqiptarë. ***Në vendimin e themelimit, ky divizion e kishte të ndaluar të kryente veprime jashtë hartës së dizenjuar të Kosovës***. Por, në verë të vitit 1944, ky divizion ka shoqëruar për në kampin e Saimište-s 810 persona të arrestuar. Sipas disa historianëve, kjo është konsideruar ***pjesëmarrje shqiptare në Shoah***. Por listat e të deportuarve ruhen në arkivat e Shqipërisë, ruhen në arkivat e Gjermanisë dhe që nga viti 1945 edhe në arkivat e CIA-s, ku janë autentifikuar. Në këto lista ka ***bolshevikë, banditë, kriminelë, partizanë dhe hebrenj***. Prej tyre vetëm 34 janë hebrenj, gjysmë-hebrenj ose të martuar me hebrenj. Sigurisht, edhe kaq sa rezultojnë, nëse janë zhdukur për faj të shqiptarëve, është përgjegjësi historike e morale. Siç thuhet në Talmud, ***kush shpëton një jetë ka shpëtuar një botë***, që ka të njëjtin kuptim me thënien ***kush çon në rrezik një jetë çon në rrezik një botë***. Por deri më sot askush nuk ka provuar se 34 hebrenjtë që gjenden në këto lista përfunduan në Bergen-Belsen. Përmendja e 810 hebrenjve të deportuar nga shqiptarët, qoftë dhe 510 apo edhe e 260 hebrenjve, ***siç raportohet prej studiuesish që gjykojnë nën kompleksin e fajit, është djallëzore***.

Në pranverë të vitit 1942, mbështetur në *statutin special të Mitrovicës*, që i lejonte ushtrisë naziste hyrjen pa autorizim në ato hapësira që quheshin *territori liberi* (*tokat e lirueme*) të Kosovës, një ekspeditë e trupave speciale të Reich-ut mori detyrë të arrestonte të gjithë burrat hebrenj që jetonin në Prishtinë. Drejtori i spitalit të këtij qyteti mjeku Spiro Lito bëri marrëveshje me të sëmurët shqiptarë të shtruar për shkaqe lëngimesh të rënda që ata të ktheheshin në shtëpitë e tyre dhe të lironin shtretërit, ku u strehuan si ***të sëmurë*** burrat hebrenj të Kosovës. Për të penguar hyrjen në spital për kontroll, drejtori vendosi shpallje kudo nëpër qytet se popullata duhej të ruhej prej epidemive të rrezikshme infektive. Asnjë nga shqiptarët që u kthyen në shtëpitë e tyre për të bërë të mundur fshehjen e hebrenjve nuk dekonspiroi!

A u shpëtuan hebrenjtë nga myslimanët shqiptarë? U shpëtuan më shumë nga myslimanët shqiptarë, sepse ata vetë ishin dhe janë popullsi shumicë. Por nuk ka pasur asnjë dallim në qendrim ndaj hebrenjve midis myslimanëve, ortodoksëve dhe katolikëve. Monsinjor Vinçens Prennushi ishte ***një prej klerikëve që ungjillizoi grupe hebrenjsh pa katekizëm dhe pa kurrfarë praktike kishtare***, vetëm për t'u dhënë identitet të krishterësh. Thuhet se ***kodi i nderit kanunor, besa dhe mikpritja tradicionale malësore shqiptare***, ishin faktorët që i shpëtuan hebrenjtë në Shqipëri. Pa dyshim që ***ishin ndër shumë faktorë të tjerë, por jo përjashtimorë***. Romantizmi i vonët, që krijon ekskluzivitete vlerash tradicionale, qoftë mbështetur në përkatësinë fetare, qoftë në atë krahinore, vihet në pikëpyetje prej një fakti shumë të thjeshtë: rajonet ku u strehuan hebrenjtë gjenden thuajse të gjitha jashtë ***republikës së kanunit***. Mbrojtja dhe shpëtimi i hebrenjve është një virtyt i pandashëm. Proverbial është rasti i arrestimit të katër hebrenjve nga Shkodra. Ekziston një letërkëmbim midis qeverisë bashkëpunuese shqiptare dhe komandës naziste, në të cilën kërkohet lirimi i tyre, ***meqë qeveria e ka paguar tashmë kushtin e komandës prej 1500 napolonash flori për secilin***.

Do të ishte e gabuar të pretendohej se asnjë hebre nuk e humbi jetën në Shqipëri gjatë Holokaustit. 15 prej tyre morën pjesë në luftë si antifashistë dhe janë shpallur dëshmorë.

Shpëtimi i hebrenjve në Shqipëri ka lidhje me shumë faktorë, jo vetëm me nderin, besën dhe traditën shqiptare.

1. ***Shqipëria është vendi i vetëm në Ballkan ku përbërësja fetare nuk ka rol në identitet***. ***Atje ku kishte katër komunitete fetare, një komunitet i pestë nuk ishte kurrfarë problemi***.

2. Në etnotipin shqiptar ka një sjellje që vërtetohet historikisht e sistematikisht. ***Në vetëdijen e njeriut shqiptar është tabù të rrezikosh të mundurin, të çarmatosurin dhe përgjithësisht tjetrin në rrezik, qoftë dhe kundërshtari***. Njeriu shqiptar nuk e prek dhe as e dorëzon të rrezikuarin, qoftë dhe të mundurin. Gjatë Luftës së Parë Botërore ushtria malazeze u tërhoq duke lënë pas murtajën, dhe megjithatë shqiptarët i dhanë mbrojtje dhe shpëtim sa mundën. Pas 8 shtatorit, mbi 20 mijë ushtarë italianë që i priste zhdukja përfundimtare prej aleatëve të dikurshëm, me akuzën për dezertim e kapitullim, u morën në mbrojtje prej popullit shqiptar. ***Sa i takon mbrojtjes së hebrenjve, shqiptarët, që nuk shquhen aq shumë për sens marrëveshjeje, kanë arritur shkallën më të lartë historike të konvergjencës në qendrim dhe vendime.***

3. Qysh në vitin 1926 Lidhja e Kombeve i ka njohur Shqipërisë një *rol tranzitimi* të hebrenjve në situata të antisemitizmit agresiv.

4. ***Save face!*** Për qeveritë bashkëpunuese, mbrojtja e hebrenjve ishte edhe çështje nderi, sepse ishte në pikëpyetje ***shpëtimi i fytyrës***. Ndryshe, ato do të paditeshin edhe më shumë për mashtrim, sepse ***pavarësia relative do të demaskohej si e paqenë***.

Bëj pajtimin tënd me PayPal
përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Ne nuk jemi gazetë e pavarur, ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

Ndiq online: **www.rrugaearberit.com**

Dibranët në të dyja anët e kufirit, siç më thoshte një burrë që e njoha dhe bisedova me të rrugës, kanë parime, në të shumtën, janë njerëz dinjitozë...





Dy **Dibrat**, të ndara në kufi, por **të lidhura** në rrënjë

Nga Dionis Xhafa

Në përfundim të vitit të vjetër tanimë 2018 dhe nisjes së një viti të ri 2019, realizova një udhëtim të mrekullueshëm në Dibër. Ky ishte një udhëtim fantastik, që kishte me vete emocionin, dashurinë dhe zemrën e bardhë e atdhedashurinë për vendlindjen. Në fakt, u nisa herët nga Tirana, për shkak se doja të isha sa më shpejt në Dibër dhe gjithashtu ta vizitoja sa më mirë, duke mos më rrëshqitur prej syve as edhe detaji i vendeve në Dibër që do të vizitoja. U nisa prej shtëpisë sime dhe ngadalë mbërrita në stacionin e furgonave. Pyeta se ku shkon furgoni për në Peshkopi, e aty rezultoi se njëri niste të udhëtonte që në orën 05.40 minuta. Për 10 minuta piva një kafe të shpejtë. Më shikoi kafja, edhe për shkak se ishte ftohtë, dimër dhe kishte erë, e se ftohtësia e motit, përzier me ngrohtësinë e pijes, më ngrohën barkun, por edhe zemrën e shpirtin. Pasi e piva kafen, shpejt hipa në furgon dhe mes asaj dallge ere që frynte, vijoi udha.

UDHA PËR NË DIBËR DHE RRUGA E ARBRIT

Edhe pasagjerët në furgon në fakt dhe kushdo fliste për Rrugën e Arbrit. Të gjithë dibranët duan që të bëhet ajo rrugë, që është historike për dibranët, por edhe për shqiptarët në tërësi. Ajo rrugë, e cila pritet të bëhet për 2 vjet dhe të gjithë shpresojnë se do të bëhet, po pritet me shumë entuziazëm. Duke qenë se po bëhet tanimë Rruga e Arbrit, udha e vjetër lë shumë për të dëshiruar. Kalojmë autostradën deri në Milot, kthejmë dhe sapo hyn në rrethin e Matit, nisin menjëherë vështirësitë. Rruga është e vjetër dhe e shkatërruar, me një infrastrukturë të dëmtuar, thuajse është si në kohën e komunizmit, pa vendosur kush dorë. Makina e ka vështirë të ecë dhe rruga shkon shumë orë. Një mërzitje që nuk e meritojmë. Shpresojmë që shpejt do të rregullohet Rruga e Arbrit dhe se atë rrugë të keqe dhe më e shkatërruara në Shqipëri mos ta shohim më.

Ndërsa gjatë udhëtimit, sigurisht u ndala tepër të bluaj me mendje për Rrugën e Arbrit. Kjo sepse pranë Bulqizës shikoje edhe pjesë që po ndërtoheshin prej rrugës historike dhe me shumë rëndësi për dibranët veçanërisht. Ajo rrugë është shpresë për të gjithë dhe se Tirana e Dibra do të ishin vërtetë afër, ashtu sikundër kanë qenë afër në mikpritjen reciproke. Një projekt që nëse gjen mbështetje dhe të ketë iniciativë gjithashtu, do të jetë një realizim i madh.

NDALESA NË PESHKOPI

Pasi udhëtoj goxha kilometra, mbërrij në kryqëzimin e Maqellarës dhe se prej andej morëm rrugën për në Peshkopi. Rrugës, tanimë që e kanë zgjeruar dhe që kanë bërë ndryshime me rëndësi, mund të shikojë fshatra të tërë, si Grezhdani, Dovolani, Erebara, Herbeli etj. Ndërsa rruga bëhet gjithnjë dhe më e bukur prej pemëve që janë fare pranë rrugës kryesore. Ndërkaq, pasi ke udhëtuar ca, arrin në qytet. Nga larg sheh tek valëvitet një flamur kuq e zi, shqiptar dhe një qendër tregtare të madhe. Pallatet dallohen që nga larg, ndërsa merr dyshezën e famshme. Ngadalë mbërrin në qytet dhe vazhdon e sheh atë imtësisht.

Sigurisht që gjëja më e bukur që ka Peshkopia ka qenë dhe mbetet bulevardi. Në të, të radhitura figura me rëndësi për kombin shqiptar, deri te Skënderbeu, kurse dallohet ndër të tjera edhe emri i Naim Plakut, pasi pikërisht emrin e tij mban qendra e kulturës në qytet. Naim Plaku është ndër penat e rralla të Dibrës, një talent i jashtëzakonshëm, një gjeni i lindur për letra, poezi dhe entuziazëm patriotik, e mbi të gjitha një njeri i nderuar. Kurse bulevardi është vërtetë qendra e gravitetit në Peshkopi, teksa njerëzit bisedojnë dhe dalin lirshëm të shëtisin nëpër të. Edhe pse bën ftohtë, sa duket muhabeti iu pëlqen njerëzve dhe ata dalin e bisedojnë e kështu shëtitjet marrin një kuptim tepër të bukur. Gjithashtu, rinia dhe ata që vijnë nga emigrimi ishin dendur në qytet e se Peshkopia kishte marrë vërtetë ngjyra të mira. Jeta zhvillohej në qytet, kurse edhe kafenetë ishin thuajse të mbushura plot. Atmosfera e Vitit të Ri ndihej në ajër.

UDHËTIM NË DIBËR TË MADHE

Pasi pashë Peshkopinë, gjerë e gjatë dhe vura re disa pjesë edhe mundimi në qytet, sidomos te pjesa e tregut, teksa edhe probleme ka, u nisa për në Dibër të Madhe. Në një ditë mendova të shikoj dy qytetet më të rëndësishme të Dibrës, Peshkopinë dhe qytetin që ka emrin e qarkut dhe që ndodhet përtej kufirit dhe ashtu veprova. Taksisti që pajtova më shoqëroi rrugës dhe më tregoi shumë. Rruga për në Dibër të Madhe ishte më e rregulluar. Ndërsa qyteti m'u duk mrekulli. Vërtetë bukur.

Shtëpitë janë të rregulluara mirë, kurse edhe rrugët kalojnë anash tyre. U ndala në një vend ku ka të rinj dhe se ata janë vërtetë energjik, ndërsa kanë marrë edhe nga kultura perëndimore dhe ndoshta prej faktit se njihen lidhjet e Dibrës së Madhe, familjeve në këtë zonë me Amerikën. Të rinjtë dhe njerëzit ishin të sjellshëm dhe silleshin mirë me ata që vinin nga Dibra e Vogël, sidomos. Nuk mungonin edhe flamujt kombëtar shqiptarë të varur nëpër shtylla. Shoferi më tha se dibranët në Dibër të Madhe janë më patriotë se ne të Dibrës së Vogël, ndërsa përtej kësaj, m'u duken njerëz të mirë e se atmosfera ishte pozitive. Më tutje, pashë teksa diku ndërtohej një shtëpi dhe se ishin thuajse 20 punëtorë, e kjo ishte një punëtori për t'u pasur zili. Dibra e Madhe është vërtetë bukur dhe aq sa qëndrova mora përshtypje shumë të mira. Një qytet i vogël, pa telashe, rrallë dëgjon tmerre dhe krime e me njerëz pozitivë në tërësinë e vet. Ndërsa është qytet gjithashtu strategjik, pasi në Ballkan aty ndodh të arrijnë shtetas të huaj, emigrant apo udhëtarë të ndryshëm, kurse është edhe disi i veçuar prej qyteteve të tjera ose larg e ka qytetin më të afër të mundshëm. Pasi po kthehesha për në Pikën Kufitare në Bllatë, ku kalova me kartë identiteti dhe po ashtu dola me kartë identiteti, kisha marrë përshtypjet më të mira të mundshme për qytetin historik, për atë vend që mbeti jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, por përbën një zemër të madhe të shqiptarisë. Një qytet, që mbeti jashtë hartës së Shqipërisë në dallgët e shumta të historisë, por se kulturalisht mbeti dhe është shqiptare.

DY DIBRAT, LIDHUR NË RRËNJË

Ekziston një shprehje: "Bota le të na dijë të ndarë, ne jemi të lidhur në rrënjë". Shpesh herë kjo shprehje është përdorur për Shqipërinë dhe Kosovën, sidomos në kohën që Kosova ka qenë nën robërinë e Serbisë. Por se i tillë rast vlen edhe për Dibrën. Ndërsa bota për fatet e saj i ka vendosur ndarë, dy Dibrat janë të lidhura në rrënjë. Dibranët në të dyja anët e kufirit siç më thoshte një burrë që e njoha dhe bisedova me të rrugës, kanë parime, në të shumtën, janë njerëz dinjitozë dhe nuk janë së koti. Ndërsa kulturalisht ngjajnë dhe janë thuajse njësoj, por se thjesht i ndan një kufi, një vijë që nuk duhet, një vizë që është shënuar në padrejtësinë e madhe ndaj kurrizit të shqiptarëve dhe të popullit shqiptar.

IKJE NGA DIBRA DHE DY FJALË PËR BULQIZËN

Pasi ika praktikisht nga dy Dibrat, një natë qëndrova në Bulqizë. Qyteti që sot për sot mban rezistencën e madhe të njeriut me natyrën, të njeriut me mbijetesën, të njerëzores me punëtorinë e madhe dhe ku puna është gjak, djersë dhe kripë. Një qytet me halle shumë dhe probleme që nuk mbarojnë kurrë, por me zemrën e bardhë, një vend me zemra nënash që qajnë dhe kanë shpirtin plot me mall për fëmijët nën tokë dhe ata përtej tokës së shqiptarëve.

Bëj një abonim online ose në print...
Kushton vetëm 600 lekë në vit...
email: rrugaearberit@gmail.com

portret

Çdo vit ai mbjell nga 18 deri në 25 hektarë grurë, duke marrë tokën me qera, duke u bërë një shërbim të çmuar dhe fermerëve të tjerë.

Ramazani Kaza, i pari që përuroi linjën e re të përpunimit të frutave të thata

Nga **Osman XHILI**



Shumbati, një nga fshatrat e komunës së Sllovës në Dibër, dikur ishte pjesë e ndërmarrjes bujqësore dhe shquhej për frutikulturë, sidomos për kumbullën. Aq shumë i kishte dalë nami kumbullës tropojane të prodhuar në Shumbat, saqë dhe tregu gjerman e përthithte të gjithën, pa asnjë ngurrim. Drejtorët e dikurshëm të N. B.së, Jovan Popi, Hajdar Gjapi, dhe Idajet Lahi, krenoheshin me këto vlera të kumbullës, por dhe cilësinë e frutave të tjerë, në përgjithsi. Toka e kuqe, as aluvionale, as torfike, e pasur me potas, kishte mjaft ndikim në sasinë e sheqerit te fruti dhe cilësitë e tjera organoleptike.

Në vitin 1993, kur N.B.ja u shkatërrua dhe gjithsecili mori tokën që kishte pasur, Ramazan Kaza, me kushërinjtë e tij bëri të njëjtën gjë. Kjo sasi toke nuk ishte pak, por 25 hektarë. Në këtë sipërfaqe gjendeshin 1700 rrënjë kumbulla tropojane dhe mbi 200 arra. Në fillim menduan ta menaxhojnë, ashtu së bashku, duke krijuar ndoshta të parin kooperim në Shqipëri, pas ardhjes së demokracisë. Më vonë,një pjesë toke e ndanë, por kooperuan shërbimet dhe shitjet, duke vazhduar në këtë formë dhe sot e kësaj dite.

Vetëm Ramazani ka sot 500 rrënjë kumbulla,apo 16 dynymë, ku përveç asaj tropojane, ka shtuar kultivarët Shuker, Stanley dhe Dente 707. Pas viteve 2000 mbolli dhe 200 rrënjë qershi, në një sipërfaqe prej 12 dynymësh, të llojit Sumit, mjaft rezistente dhe e pëlqyer nga tregu. Në total, sipërfaqja e mbjellë me drufrutorë është rreth tre hektarë. Vetëm këtë vit ai prodhoi 200 kuintalë kumbull dhe 180 kuintalë me qershi.

LINJA E PËRPUNIMIT TË KUMBULLËS

Për vite me radhë Ramazani, bashkë me kushërinjtë e kërkuan tregun e kumbullës në Dibër, në Kukës dhe në Tiranë. Vështirësitë e hasura e bënë të mendojë për një alternativë të re. Vendosi të ngrejë një linjë përpunimi të frutave të thata, që do ishte e para e këtij lloji, jo vetëm në Dibër, por dhe në Shqipëri. Kështu, në vitin 2008, Ramazani përuroi linjën e re me emrin "Kaza frut Dibër". Nuk ishte vetëm ideja e tij për linjën e ngritur, por dhe si rezultat i studimit dhe bashkëpunimit me S.N.V.në dhe drejtorinë e bujqësisë Dibër. Frutat vinin nga fusha, seleksionoheshin, futeshin në tava dhe më pas kalonin në furrën e tharjes. Aty qëndronin për gati 30 orë, ftohen pak, kalojnë në linjën e larjes, terren, u hiqet një pjesë e lagështisë, seleksionohen e së fundmi ambalazhohen në paketime 200 gram, 500 gram dhe gjashtë kilogram. Kjo linjë përpunimi nuk i ka shërbyer vetëm Ramazanit, por dhe fermerëve të tjerë, pasi në të janë përpunuar këtë vit 500 kuintalë kumbull e freskët. Raporti i kumbullës së freskët me atë të përpunuar është katër me një dhe prodhimi është shumë cilësor. Tregu është pak i vakët, si për shumë prodhime të tjera dhe kjo vështirësohet nga futja e produkteve ilegale nga Mali i Zi dhe Maqedonia. Vitin e kaluar fermeri e ka certifikuar produktin dhe në arenën ndërkombëtare nga Global Gab, duke qenë i vetmi për kumbullën në Dibër dhe nga të paktët në Shqipëri. Ramazani tregon se ka pasur mjaft vështirësi në punën e tij, ulje dhe ngritje, duke u shprehur se kam mësuar duke pësuar.

Sot ai ka marrëdhënie mbi bazë kontratash me dy kompani të fuqishme franceze, Francë, Lima Grain dhe Florimont Despress, duke marrë prej tyre gjeneracione të larta për riprodhim fare. Nga gjithë ajo mori kultivarësh, dy prej tyre bëjnë diferencën, llojet Apache dhe Soissons.

DREJTUES DHE EKSPERIMENTUES I GUXIMSHËM.

Në vitet 2007 – 2011, Ramazan Kaza zgjidhet si kryetar i komunës së Sllovës, ku përfshihej dhe fshati i tij, Shumbati. Kur merr përsipër përgjegjësi, duhet të kesh vizion, ndërgjegje dhe përkushtim për të drejtuar, thotë ish kryetari. Atij nuk i mungonin këto, pasi kishte udhëhequr fermën e tij përmes shumë sakrificave. Atëherë bënim shumë shërbime për popullatën, tregon Ramazani, gjëra që sot janë në minimum. Në punën e tij në drejtimin e komunës, ai shihte si parësore përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe ujore. Në atë kohë u ndërtua kanali Sllovë - Palaman – Trojak, që u shërbente mjaft këtyre fshatrave dhe sot nuk është funksional për detaje fare të vogla. Po kështu u ndërtua kanali vaditës për fshatin e Sllatinës, që kishte qenë një ëndërr e vjetër e banorëve të këtij fshati. Falë realizimit të këtyre projekteve, u shtua ndjeshëm sipërfaqja nën ujë dhe për pasojë prodhimi dhe të ardhurat tek fermerët e zonës. Në të dy kanalet e përmendura komuna kishte qenë jo vetëm e interesuar në zbatimin e projektit, por dhe bashkfinancuese e tij me një vlerë jo të vogël.

Një kujdes i veçantë i qe kushtuar arsimit, si shtyllë e rëndësishme në edukimin e njeriut me dije shkencore dhe edukatë. Gjatë kësaj kohe u ndërtuan tre shkolla të ciklit të ulët dhe u rikonstruktuan dy shkolla të tjera. U nxitën dhe u stimuluan mbjelljet e reja në frutikulturë, për të shtuar të ardhurat e fermerit. Ramazani u përpoq t'ju shërbejë sa



Për vite me radhë Ramazani, bashkë me kushërinjtë e kërkuan tregun e kumbullës në Dibër, në Kukës dhe në Tiranë. Vështirësitë e hasura e bënë të mendojë për një alternativë të re. Vendosi të ngrejë një linjë përpunimi të frutave të thata, që do ishte e para e këtij lloji, jo vetëm në Dibër, por dhe në Shqipëri. Kështu, në vitin 2008, Ramazani përuroi linjën e re me emrin "Kaza frut Dibër". Nuk ishte vetëm ideja e tij për linjën e ngritur, por dhe si rezultat i studimit dhe bashkëpunimit me S.N.V.në dhe drejtorinë e bujqësisë Dibër.

më mirë njerëzve që e patën zgjedhur, duke u dhënë atyre prej vetes dhe duke marrë prej tyre mësime që do ti shërbenin gjithë jetën.

Ramazani u ngjan atyre gurëve të diamantit që në çdo anë që t'i kthesh, të japin një refleks dhe shkëlqim të ri. Ka 20 vite që ai është kryetar i ADAD malore, një shoqatë që ka në fokus zhvillimin bujqësor të zonave malore, me ndihmën dhe bashkpunimin e qeverisë franceze. Në këtë moment hapet një kapitull i ri për të, duke u specializuar në prodhimin e farës elitë të grurit të gjeneracioneve më të mira me origjinë franceze. Çdo vit ai mbjell nga 18 deri në 25 hektarë grurë, duke marrë tokën me qera, duke u bërë një shërbim të çmuar dhe fermerëve të tjerë. Gjatë gjithë kësaj periudhe kohore janë futur prej tij, për herë të parë 33 lloje gruri, të fortë dhe të butë në Dibër, Shkodër, Korçë dhe Lushnje. Këto kultivarë janë të çertifikuar nga Enti shtetëror për farëra dhe fidana.

Sot ai ka marrëdhënie mbi bazë kontratash me dy kompani të fuqishme franceze, të specializuara në këtë drejtim, Francë, Lima Grain dhe Florimont Despress, duke marrë prej tyre gjeneracione të larta për riprodhim fare. Nga gjithë ajo mori kultivarësh, dy prej tyre bëjnë diferencën, llojet Apache dhe Soissons. Potenciali i lartë prodhues, rezistenca ndaj faktorëve negativë dhe cilësia e lartë e bukës së prodhuar prej tyre, i bëjnë ato ndër më të kërkuarit në treg. Por, ashtu si për kulturat e tjera drufrutore dhe për grurin e bimët e tjera të arave, duhet të jetë e pranishme ndihma e shtetit, të ketë subvencione, në mënyrë që të prodhojmë e të hamë sa më bio dhe të mos konsumojmë mbeturinat e Europës dhe botës.

Duke qenë kryetar i ADAD malore, Ramazani gëzonte dhe statusin e anëtarit të shoqatës së bujqësisë për zhvillimin e Mesdheut, ARBOMED, duke marrë pjesë në disa takime ndërkombëtare. Në nëntor të vitit 2017, ka përfaqësuar Shqipërinë për herë të parë në Kongresin ndërkombëtar të bujqësisë, të mbajtur në Francë.

Urojmë dhe shpresojmë që Dibra të ketë sa më shumë fermerë të tillë, që dinë të punojnë për veten e tyre, për familjet e tyre, duke i bërë nder dhe respekt gjithë shoqërisë dhe komunitetit që i rrethon.

Shqipëria përballet me sfida në fushën e sigurimit të vendeve të sigurta dhe produktive të punës për të rinjtë, gratë dhe personat e varfër.



46 të rinj nga Dibra, 3 ditë, 8 grupe, 8 propozime dhe 2 fitues!

Një kamp përgatitor mblodhi bashkë 46 të rinj dibranë me qëllim dizajnimin e zgjidhjeve inovative për problemet që paraqet zhvillimi në Dibër. Kampi adresoi tri sfidat kryesore: mungesa e kreativitetit dhe imagjinatës në zhvillimin e produkteve të rinj, mungesa e kulturës së duhur dhe mospasja e modeleve që frymëzojnë të rinjtë.

Kampi përgatitor "Made in Dibra" u fokusua te frymëzimi i pjesëmarrësve për të gjetur mënyra se si Dibra mund të kthehet në një qendër kulturore dhe turistike në Ballkan. Kampi përdori teknologjinë moderne dhe një fokus mbi mendimin njerëzor për të nxitur debatin dhe për të ndihmuar të rinjtë me gjetjen e zgjidhjeve kreative për problemet e tyre.

46 të rinjtë u ndanë në 8 grupe. Detyra e tyre e parë ishte të eksploronin nevojat dhe hapësirat në komunitetet e tyre, jo vetëm te banorët, por edhe te vizitorët, pasi prezenca e këtyre të fundit është në rritje. Ata kërkuan për frymëzim në burimet natyrore të zonës, me qëllim krijimin e një dëshire për të shfrytëzuar këto burime dhe për t'i kthyer ato në mundësi zhvillimi për ta dhe komunitetin.

Pjesëmarrësit eksploruan mënyra se si teknologjia dhe mendimi i dizajnit ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve reale dhe patën mundësinë për të folur me persona të shquar në fushat e software, sportit dhe medias.

Erinda, një nga pjesëmarrëset e kampit, tha: "Ky kamp përgatitor më ka dhënë mundësinë për të gjetur zgjidhje jashtë normës për problemet e qytetit tim dhe për të përmirësuar jetën e çdo banori. Këtu kuptova që qyteti im ka një potencial shumë të madh për turizëm, gjë që mund të japë nisma që njerëzit të qëndrojnë në Dibër. Është e trishtueshme të shohësh që tani të gjithë duan të largohen nga Shqipëria".

Në ditën e fundit, grupet punuan me modelet e bizneseve të tyre, si një mënyrë për të formuluar mendimet e tyre mbi hapat në vijim, bashkëpunimet, burimet etj. Pjesëmarrësve ju dhanë struktura për të ndihmuar me komunikimin sa më të efektshëm të ideve të tyre.

Në fund të kampit përgatitor, grupet paraqitën idetë e tyre një paneli gjyqtarësh. Idetë më të mira u zgjodhën në bazë të disa kritereve të parashtruar, si: qartësia në formulimin e problemit, impakti mbi jetën e rinisë, qartësia e hapave në vijim etj.

Dy projekte fituan: I pari quhej "Hand Made in Dibra", një projekt me qëllim krijimin e një tregu për produktet e artizanatit dibran me anë të ekspozitave dhe punishteve. Ideja e dytë, "Uskania", ka si qëllim rritjen e vetëdijes së rinisë dibrane mbi riciklimin. Pika kryesore e këtij projekti është një konkurs i organizuar me anë të Instagramit midis 44 shkollave të rajonit mbi produktin më të mirë të riciklimit.

Ky kamp përgatitor më ka dhënë mundësinë për të gjetur zgjidhje jashtë normës për problemet e qytetit tim dhe për të përmirësuar jetën e çdo banori. Këtu kuptova që qyteti im ka një potencial shumë të madh për turizëm, gjë që mund të japë nisma që njerëzit të qëndrojnë në Dibër. Është e trishtueshme të shohësh që tani të gjithë duan të largohen nga Shqipëria...

Grupet janë në Dibër, duke punuar për të kthyer idetë e tyre në realitet. UNDP-ja do të vazhdojë të monitorojë dhe mbështesë grupet në javët që vijojnë.

PËRSE E BËMË KËTË?

Shqipëria përballet me sfida në sigurimin e vendeve të punës për të rinjtë, gratë dhe personat që kanë vështirësi financiare. Edhe pse papunësia është ulur, vetëm 37.9% e të rinjve kanë punë. Të rinjtë e papunë dhe jo në shkollë përbëjnë 30% të grupmoshës 15-29 vjeç, dyfishi i mesatares së BE, vetëm 14.8%.

Veriu i Shqipërisë është zona më e varfër e vendit. Prodhimi i brendshëm bruto për qytet është pothuajse sa gjysma e mesatares shtetërore dhe papunësia e të rinjve arrin shifrën 45%. Gjithashtu, 2/3 të punësuar kanë punë në fushën e agrikulturës, shpeshherë sezonale.

Për të ndihmuar me situatën, UNDP-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, po zbatojnë projektin "Mbështetje punësimi për të rinjtë dhe gratë në Shqipërinë e Veriut." Ky projekt i financuar nga qeveria Britanike ka si qëllim krijimin e mundësive për banorët e Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës duke ofruar mundësi vetë-punësimi dhe sipërmarrje, si dhe ndihmë ligjore falas për personat më në nevojë.

Përshtati në shqip: **Klovis Karoshi**

Shkrimi origjinal gjendet në linkun: https://medium.com/@albania.undp/madeindibra-bootcamp-46-youth-from-dibra-3-days-8-groups-8prototypes-and-2-winners-6576cd7be4b4

Vlerësim për mirëkuptimin, harmoninë dhe qytetarinë e komunitetit dibran

Më 10 janar 2019, një përfaqësi e Shoqatës "Bashkësia Dibrane", u ftua nga Insitucioni i Presidentit të Republikës në një takim audiencë me Kryetarin e Shtetit, Shk. tij, Z. Ilir Meta. Në këtë takim mernin pjesë një përfaqësi nga Kryesia dhe Këshilli i të Urtëve i SHBD-së si dhe këshilltari i Presidentit të Republikës z. Ylli Asllani.

Presidenti Ilir Meta, vlerësoj rolin dhe kontributin disa vjeçar të Shoqatës "Bashkësia Dibrane", e themeluar më 1908 nga lëvizjet kombëtare dhe vlerat e komunitetit dibranë në tërsi. Ai u njoh me SHBD e cila përfaqëson komunitetin dibran në Tiranë, të cilët si pasojë e genocidit dhe e kryengritjeve të vitit 1913 lanë vendin e tyre, Dibrën e Madhe, për tu vendosur në Tiranë e më gjerë.





Një rezyme të veprimtarisë së shoqatës ju bë edhe nga kryetari i SHBD-së z. Bujar Kapexhiu, ndërsa në emër të komunitetit dibranë në Tiranë dhe shoqatës "Bashkësia Dibrane", ju dhuruan Presidentit Ilir Metës dhe Akti i Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare me firmëtarët e saj ruajtur nga arkiva familjare e Faik Shatkut dhe botimet më të fundit me autor e studiues dibranë.

Presidenti i Republikës, Ilir Meta vlerësoj punën dhe angazhimin e komunitetit dibranë për ruajten dhe gjallërimin e traditës dhe të bashkëjetesës me komunitetet e tjera, në frymën e mirëkuptimit, harmonisë dhe qytetarisë. Gjithashtu ai shprehu dëshirën për tu takuar së shpejti në aktivitetet e shoqatës "Bashkësia Dibrane".

Vetëm pak ditë më parë, Presidenti i Republikës së Shqipërisë Shk. Tij, z. Ilir META, vlerësoi me dekoratën "Nder i Kombit", kompozitorin, muzikologun dhe instrumentistin e shquar, pjesë e komunitetit dibranë në Tiranë, Mjeshtrin e Madh z. Agim Krajka.

Dekorata ju dedikua z. Krajka, për të gjithë veprimtarinë e tij disa vjeçare në aktivitetin e organizuar nga Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor me titullin: "Të gjithë e duan Agim Krajkën"

Ky dekorim i jepet Mjeshtrit Krajka nga Presidenti i Republikës, me motivacionin:

"Për kontributin e shquar në fushën e kompozimit, ekzekutimit dhe përpunimit të muzikës së lehtë dhe popullore Shqiptare, si dhe për transmetimin e vlerave më të spikatura shpirtërore të kulturës sonë te brezat e rinj."

(http://bashkesiadibrane.blogspot.com)

opinion



Ra Amerika dhe u zbulua Dibra…

Po, po u zbulua. Emri i saj kalon zgavrave të gojës, pëlcet bullçinjtë fry si tullumbace, merr arratinë mediave të shkruara e fluturuese, përplaset në foltore kuvendare, ulet pasdarkeve odave pranë sobave prej llamarine skuqur nga zjarri i druve të dushkut këtij dimri të egër...

Aq shumë flitet e bërtitet për të sa gjëma më vjen edhe këtu, njëmijë kilometra larg.

E zbuloi Amerika, Voice of Amerika.

Në Dibër qenka bërë nami...

Janë vjedhë votat...

Me çanta, me torba, me thasë...

Dhe, si për të përligjur këtë nam, gazetat, portalet, televizionet satelitorë kombëtarë... për ilustrim kanë gjetur një "ish" që do kohë më parë ia lëshuan në tokë namuzin me "brekët e grisura" dhe një "është" që paska vjedhur votat, jo me gjerësinë e bisturisë, por me kamionët e qeverisë...

E tha Amerika, e tha Voice of Amerika...

Dhe kur e thotë Ajo e ka thënë Ai, Zoti, Një dhe i vetëm...

Mirë bëri, ani se zëri i saj, i përkthyer në shqip për të thënë "Zëri i prokurorisë"!

Prokurorisë shqiptare, se nuk ka prokurori në botë "shoshë egjre" si e sa ajo.

Se si i thonë asaj fjalës që fluturon e nuk bie kurrë në tokë..."më mirë nami se sa syri".

E po Dibrës i plasën të dy, edhe syri edhe nami...

Se syrin ia kishin lidhë e, as shihte as e shihnin...

Dhe më vjen çudi pse tani: Pse vetëm tani qenka vjedhë vota në Dibër?

Vetëm tani dhe kurrë më parë...

Gjithnjë është vjedhë.

Me certifikata të shaptilografuara...

Me dhunë...

Me thasë mielli e kamionë me grurë...

Me...

Më kujtohet një rast i moçëm:

Bëheshin dikur zgjedhjet për Kuvendin Popullor.

Zgjedhje 99.9 për qind...

Ndodhi që në Dovolan të dalë një votë kundër...

U bë nami...

Mbledhje pas mbledhjesh...

Kërkohej tradhtari, rezili, katili...

E hëngrën të deleguarit...

Shqipëria votoi 99.9 për qind për Frontin Demokratik...

Më kujtohen rastet e jetuara si qytetar e si gazetar...

Në votimet e 22 marsit 1992 ndodhi një uri e jashtëzakonshme për certifikata. Formatet e mbaruan në të gjitha zyrat e gjendjes civile. Që të prodhoheshin në shtypshkronja dhe të vinin nga Tirana s'kishte kohë.

Asokohe nxirrja bukën e ditës me një fotokopjues e një shaptilograf.

E gjetëm zgjidhjen...

Një format në kompjuter dhe shaptilografi u shndërrua në shtypshkronjë...

Sa certifikata bëra?

Pa numërim. Me siguri dy herë më shumë se sa kishte votues e gjithë Dibra...

Në votimet e 26 majit 1996 u bë nami...

Kryetari i Partisë Socialiste të Bulqizës u hodh i "vdekur" në një përrua në Ostren. E dhunuan "shtabi elektoral" i AzemHajdarit që kandidonte për deputet në zonën Gollobordë-Librazhd. Kryetarin "e vdekur" e gjeti një grua. I dha ujë dhe e nisi për në shtëpinë e tij në Shupenzë. Morën vesh që ishte gjallë. Në mesnatë e arrestuan dhe e përplasën në çimenton e ftohtë të burgut të Bulqizës...

Ashtu, të gjakosur e të sakatosur...

Një mik këtu në mërgim më tregon se kishte qenë komisioner në një fshat të Librazhdit. Pa mbaruar votimi, me kutitë plot e përplot, u nisën për në qendër. Rrugës i njoftuan të mos shkonin fare. Fitorja ishte siguruar njëqind për qind. Mushkën së bashku me kutitë e votimit u dha urdhri ta hedhin në humnerë...

Si gazetar kam fiksuar në fotografi kamionët me grurë rifuxhio në njërën nga rrugët e Peshkopisë...

Kam fotografuar një qendër votimi, pa çati, me grupin e gatshëm të PD-së që kishte bllokuar derën e qendrëssë votimit...

Fotografova edhe një gjyqtar tek po më ndiqte duke më qëlluar me gurë...

Për të më ndjekur më pas me ultimatumin "O mbyll gojën ose do të rrëmbejmë fëmijët". Dhe provuan ta bëjnë...

Unë ika. Fjala e lirë kishte vdek. Demokracia ishte shndërruar në dhunokraci...

Unë u detyrova të marr rrugën për në "Janinë"...

Këtu jam tash 23 vjet...

Votën në kuti e kam lëshuar, për herë të fundit, më 26 maj 1996...

Kryqi në listat e votuesve thotë se kam votuar sa herë ka pas zgjedhje...

Dibrës ia nxinë fytyrën me do "brekë të grisura", që tash po i shoh të tunden në "shtatë ballë", tej Atlantikut...

Dibrës po ia grumbullojnë mbi shpinë tërë mëkatet e këtyre viteve vjedhje zgjedhjesh, krimesh, korrupsioni...

Nuk e mohoj nga sa i kam jetuar me dhimbje në palcë e nga sa dëgjoj. Edhe Dibra ka pjesën e vet në mbrapshtinë që ec pa u ndalë Shqipëria...

Pjesën e mizës dhe jo të luanit...

Por jo kaq sa thërritet e bërtitet duke u çarë bulçish deri përtej Atlantikut.

Dibra ka qenë shembull i punës, i njerëzve heronj të paepur në ndërtimin e Shqipërisë. Nuk ka oxhak të fabrikave e uzinave të vendit ku mos ketë rrjedhë djersa e dibranit. Nuk ka tunel të veprave hidroenergjetike që nuk është çarë nga vrulli i dibranëve.

Një historian i huaj thoshte se në qoftë se digjet Stambolli Dibra e ngre në këmbë mbi themele të reja. Por, shton ai, në qoftë se digjet Dibra Stambolli nuk i hedh sytë.

Dibra ka halle të mëdha, halle që duhen lexuar edhe tej Atlantikut.

Vota është mall belik i hedhur në rrugë për ta vjedhë...

Nuk është "vjedhje dibrane" as "shqiptare", është botërore, madje edhe Amerikane...

Abdurahim ASHIKU
Gazetar, Athinë

3 shkurt 2019

Ç'kemi asaj Dibre

Nga **BUJAR KAROSHI**

Janar 2019 - Shkruajnë shpesh miqtë dhe lexuesit se na mungon rubrika *"Ç'kemi asaj Dibre"*. Edhe mua më ka munguar, por nuk është shumë për t'u shqetësuar. Se nuk është as bukë, as ujë...

Gjatë kohës që kam munguar, nuk ka pasur asgjë të re. Si zakonisht, shëtitje në bulevard dhe thashetheme për fushatën e ardhshme...

Kanë dalë kandidatë për kryetarë, të propozuar dhe vetëpropozuar, por kryetarët e vërtetë pritet të dalin një muaj para zgjedhjeve: gjysmë analfabetë, gjysmë biznesmenë, gjysmë partiakë, shërbëtorë e puthadorë të shefit, si deri më tani... Sepse Partia e do kandidatin ... sa më injorant.

Bora e zbardhi këtë janar. Në kohën tonë, kur binte, thoshim "me bereqet". Tani e përdorim bardhësinë e borës për t'u sharë e për t'u mburrur: shaj qeverinë se nuk hedh kripë e mburr buldozerët se si hapin rrugët... Ndërsa mburrjen më të madhe e kanë pasur të rinjtë, u mbushën plot *lajke* në *Facebook* që hapën rrugën për të komshiu... për të luajtur domino...

Bora e pati edhe një të mirë, na solli ujqërit te dera. U bëmë aq e nuk kishim parë ujk me sy... Se për pak desh kujtuam se ujqër janë ata që dalin te Fevziu...

Ç'është e vërteta edhe u bllokuan ca rrugë, por me statistika kemi qenë mirë: rrugët e bllokuara nuk e kaluan 30 për qindshin...

Meqë jemi te statistikat, ne dibranëve na turpnoi këtë muaj INSTAT-i. "Dibra ka burra... të virgjër". Në një anketim ca muaj më parë na nxori të varfër, kësaj radhe të virgjër... Herës tjetër e ka lënë të na nxjerrë... kopila...

Peshkopia vazhdon të jetë pa ujë. Pa ujë në verë, pa ujë në dimër. Verës ia pi toka, dimrit ia ngrin bora. Ama e ka një të mirë: do bëjmë një projekt të ri për ujin në Peshkopi e do t'i fitojmë 2 a 5 milionë euro e dollarë.

Por ç'e duam ujin në çezma, kur kemi ujin e llixhave... Burojnë ca litra akoma, sa për të na kujtuar se kanë mbetur edhe ca vende ku mund të vjedhim akoma... me ligj.

Uji na mungon, por debati hiç. Debat për të ftohtin, debat për të ngrohtin, debat për *Zërin e Amerikës*. Ky i fundit zbuloi se janë vjedhur zgjedhjet në Dibër tre vite më parë... Flakë merr debati mes pozitës dhe opozitës, për një gjë që në Dibër e dinë të gjithë, të rinj e pleq: Që nga '96 zgjedhjet veç janë vjedhur. Zgjedhje kanë bërë veç kryetarët e partive...

Andej nga Dibra e Madhe kemi pas probleme. Janë zënë gjithë muajin për... karriken e kryetarit. Njëri akuzon për korrupsion, tjetri për shpërdorim... Ama, detyrën ia lëmë njëri-tjetrit në kafe, si burrat...

Lajme për Rrugën? Nuk kemi këtë muaj. Zëdhënësin e kemi pas të zënë me një grevë studentësh...

S'mund të jesh indiferent nga dekori hijerëndë i malit Korab, me larmi panoramash; me re, herë të serta e herë të bardha, të cilat diku bëhen tufë mes lojës së tyre dhe nën sytë e gjelbërimit të përhershëm të pishave qindravjeçare...

Syri i një mjellme në Korab



Nga **Pëllumb GORICA**

Ka rrugë të cilat nuk maten me kilometra e orë udhëtimi, por me mori emocionesh. Ndaj, kur rrugëton, ashtu si uji që rrjedh e gurgullon në shtratin e vet duke lenë pas brigjet, ato nuk të tradhëtojnë kurrë. Sidomos kur e panjohura mes bukurive magjike të bën mik shpirtëror duke i shfletuar. Ndaj sa here nisem në rrugë të largëta me padurimin për të arritur sa më parë në destinacion, i shpreh emocionet frymëzuese për t'i bërë pjesë në krijimtari, biseda miqsh e të njohur.

S'mund të jesh indiferent nga dekori hijerëndë i malit Korab, me larmi panoramash; me re, herë të serta e herë të bardha, të cilat diku bëhen tufë e mes lojës së tyre dhe nën sytë e gjelbërimit të përhershëm të pishave qindravjeçare, ku patjetër ke se ç'të qëmtosh të qëndisurën e hireve të kësaj natyre alpine. Një rrugë e ngushtë këmbësore dhe gjithë gjarpërime që ngjitej siç thotë ajo fjala e urtë "shtegu i rrahur të çon diku", të bënte të mos ndaloje për asnjë çast, ndonëse duke dihatur, sepse edhe ajri i pastër të nxiste vetvetiu ecjen. Dëgjohet frymëmarrja e shpeshtuar, kërcitja e këpucëve, e shkopinjve dhe era e ftohtë, që të thante fytyrën. Përtej lodhjes, duke u rrekur mes vështirësisë të saj, ku diku vraga e rrugës të humbet pllaskave gjurëmbardhë, porse shpina e një kafshe laramane, herë pas here i lejon vetes ndalesa mes drurëve të dendur të pishave që, përveç bukurisë mahnitëse e mbushin shpirtin me aromën dehëse të malit. Vende – vende ca gjurmë kafshësh të egra tregonin se këtu kishin kaluar pak para nesh. Me vete bluajmë mendime pa i shqitur sytë pamjeve të patjetërsueshme të natyrës.

Emocionohemi aq shumë sa rraskapitja e ngjitjes zbehet e nderur nga një frushullimë e lehtë e pishave që pëshpërijnë me murmurimë freskie, të cilat janë më shumë se poezi. Fëshfëritja e krahëve të një turme trumcakësh endur ngeshëm tutje, të cilat me gjasje i ngacmon kërcitja e hapave, më të rrallë ndonjë këngëzim i tyre nga larg. Këto çaste, që nuk i përjeton përditë, të bëjnë t'i thuash vetes: Sa mirë bëra që erdha këtu, larg zhurmave e telasheve, larg barbarisë që po i bëjnë natyrës njerëz të papërgjegjshëm. Të shpëton edhe ndonjë psherëtimë, sepse ndodh që përherë natyra e çiltërson shpirtin edhe në kulmin e rrëmujave politike e ngjarjeve të rënda.



S'mund të jesh indiferent nga dekori hijerëndë i malit Korab, me larmi panoramash; me re, herë të serta e herë të bardha, të cilat diku bëhen tufë e mes lojës së tyre dhe nën sytë e gjelbërimit të përhershëm të pishave qindravjeçare, ku patjetër ke se ç'të qëmtosh të qëndisurën e hireve të kësaj natyre alpine. Një rrugë e ngushtë këmbësore dhe gjithë gjarpërime që ngjitej siç thotë ajo fjala e urtë "shtegu i rrahur të çon diku", të bënte të mos ndaloje për asnjë çast, ndonëse duke dihatur, sepse edhe ajri i pastër të nxiste vetvetiu ecjen...

Pas një ore rrugëtim mes këtyre pamjeve, një liqen i vogël 0.8 ha, Liqeni i Zi që ndriste me bardhësinë e akullt, si një bukuri e parrëfyer na pushtoi atë çast me emocione. Ecnim lehtë-lehtë, të mos zgjonim bukurinë e mjellmët të këtij syri magjik, që natyra e ka krijuar në lartësinë e formacioneve përrallore të Radomirës. Cipa e ujit të liqenit kishte ngrirë dhe si pasqyrë e madhe reflektonte rrezet e diellit. Duke mos e prishur atë ndjenjë të këndshme solemniteti, që e kishte pushtuar atë u ulëm në breg, Ai shtrihej si në pëllëmbë të dorës, i rrethuar nga pisha të larta, që i jepnin peizazhit një bukuri të rrallë. Ne po vështronim e na dukej sikur ishim në një botë të paparë. Rreth tij vërtiteshin ca zogj ndërsa provonin të thyenin akullin me sqep. Pastaj fluturuan sikur t'i trembte ardhja jonë.

Zbresim nga lartësitë e majave të borëzuara të Korabit, që tanimë i kemi lënë prapa, të mundimshme, me një paralele zymtësie prej reve të përhimta sa ditën e bënë muzg. Rrjedha e një përroi, me burime e rrëkeza të akullta, që zhurmonte e shkumbëzonte me rrapëllimë, si jehona e një simfonie nëpër gurë e guralecë të murrmë, na shoqëroi një copë udhë dhe bëri më epike pamjen me të këndshmen e vlerave në malin më shtatlartë të Shqipërisë.

http://www.gazetadita.al/syri-i-nje-mjellme-ne-korab/

Botime DUKE FILLUAR NGA 1 KOPJE E VETME

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme | libra | broshura | revista | fletëpalosje | katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603 / 068 65 08 441

BOTIME M&B

www.facebook.com/ M&B - Botime dhe Studio Grafike
Për porosi: botimemb@gmail.com/Cel: 069 20 68 603
www.mbbotime.com / I gjeni te libraria M&B *(te Selvia)*, Adrion *(te Pallati i Kulturës)*, Libraria Fleta XXI *(Peshkopi)*

Shkëputur nga libri "Buka e magjes së popullit", tregime alegorike nga Xhafer Martini.
Së shpejti në treg > > > > >

Mjeku i pagabueshëm

Kishte qenë një burrë që e quanin Nelë Kazani, por i thonin Nelë Akshami - fatngrysur. Kishte nëntë fëmijë, se në dhjetë vjet martese e shoqja, një dërdënge, kishte pjellë çdo vit. Nela kishte pak tokë, mezi bënte bukën për pesë muaj. Iu lut Zotit:

- O Zot, ma bjer vdekjen një sahat e ma parë se kështu nuk jetohet.

Zoti ia dëgjoi lutjen dhe ja ku para tij u shfaq engjëlli Xhebrail.

- Më thirre? - e pyeti ai duke menduar se do ta hante fjalën, siç kishin bërë mjaft të tjerë, edhe pse e kishin thirrur.

- Të thirra, të thirra, - i tha Nelë Akshami pa ia bërë tërr syri. - Kjo imja është jetë qeni, nuk kam ç`e dua.

Por engjëlli Xhebrail e mësoi si të pasur-ohej...

Në katund u sëmur Lepe Kucurri, më pasaniku i gjithë nahijes, që nuk la mjek pa marrë, por të gjithë i kishin hequr shpresat. Kishte dhimbje të forta barku dhe përdridhej si zorra në prush. Kur e kapte ajo dalldia e madhe, lahej në djersë dhe mezi mbushej me frymë. Vdekja e tij dukej punë ditësh. Katundarët dhe dashamirët e kishin parë dhe vazhdonin ta shikonin. Lepe Kucurri nuk merrej vesh me ta, se rrallëherë binte në mend.

Sipas porosisë së Xhebrailit, shkon një mbasdarke edhe Nelë Akshami për ta parë. Nelës, si fukara që ishte, nuk ia varte njeri.Veç nuk i thonin që të ngrihej dhe të dilte. Xhebraili, i dukshëm vetëm për sytë e Nelës, ishte te këmbët e të sëmurit, çka tregonte që Lepe Kucurri do të shërohej shpejt. Nela vendosi të hakmerrej ndaj atyre që nuk e përfillnin, sidomos ndaj Zebek Bekut, që vinte i dyti për pasuri në fshat.

- Qysh dukesh, o Lepe Kucurri? - iu drejtua të sëmurit.

Pyetja qe për t`u habitur, se, kur tjetri është në atë gjendje, nuk ke përse e hap gojën. Iu kthye me kërleshje Zebek Beku dhe i tha:

- Nuk e shikon që s'jep e s'merr fare, or Nelë Akshami? Apo kishe edhe ti një fjalë për të thënë?

- Ti rregullo gojën, se unë nuk jam Nelë Akshami, por Nelë Kazani, - tha Nela duke e vështruar Zebekun në sy. - Unë për të shikuar dhe për të kuptuar të sëmurin, jam më i ditur se ti. Lepe Kucurri mbas tri ditësh do të ngrihet në këmbë dhe mbas një jave do të mbajë qetë nëse e ka marrë malli për atë punë.

Burrat panë njëri-tjetrin të tramkosur. Ky Nela paska gazhit fare, menduan. Fjalët e Nelës i dëgjoi edhe i sëmuri, për të cilin të gjithë kujtonin se i kishte shkëputur marrëdhëniet me këtë botë. Ai u kacle pak dhe mundi të shikojë Nelën në sy.

- A vërtet, or Nelë? - hapi gojën dhe foli për herë të parë mbas nëntë ditësh në jermi.

- Si buka që hahet, - tha Nela i vendosur.

Nela iu kthye Uk Kucurrit, të birit të Lepes dhe i tha:

- Merrni ca gjethe ftoi, zieni në ujë, ëmbëltojeni ujin me pak sheqer dhe ia jepni të sëmurit. Kështu?

- Po, po, - tha Uk Kucurri me një zë që tregonte bindje të plotë.

Nelë Kazani brofi në këmbë dhe iku në shtëpi të vet. Lepe Kucurri mbas tri ditësh u ngrit në këmbë dhe mbas një jave u shërua fare.

Kjo e tronditi dhe e çuditi fshatin. Nami i Nelë Kazanit u përhap kudo. Tani nuk ia mbante kujt t`ia ndryshonte mbiemrin. Kur dikush sëmurej, Nelë Kazanit i çonin kalin dhe e merrnin si të ishte aga. Asnjë mjek dhe asnjë njeri nuk ishte nderuar dhe nuk ishte mbushur me dhurata si ai.

Nela vazhdonte t`u jepte ilaçe atyre të sëmurëve që u qëndronte Xhebraili te këmbët. Dhe ilaçet e bënin efektin menjëherë.



BUKA E MAGJES SË POPULLIT
Tregime alegorike
XHAFER MARTINI / Botimet M&B, 2019

ISBN 978-9928-256-59-1
Faqe 160
Çmimi: 700 lekë

Sut Balliu, dyzet e pesë vjeç burrë, u plagos lehtë në ballë kur po rregullonte gardhin e ahurit të bagëtive. Nuk qe në të vërtetë plagë, mezi ku i doli një pikë gjak. Mbas një jave nuk e ndjeu veten mirë, por mendja tek ajo pika e gjakut nuk kishte si t'i shkonte. Djali i Sutit shkoi dhe mori me kalë Nelë Kazanin. Suti ishte shëndoshë e mirë në krye të vendit, tek oxhaku, dhe pinte kafe dhe duhan.

- Or Nelë, të munduam kot, por qofsh i nderuar që erdhe, - i tha Sut Balliu.

- Jo, bre, bashi i mikut, për mua mos të të vijë keq. Shyqyr që qenke mirë, - tha Nelë Kazani dhe shtoi: - Por që të bindem se nuk ke asgjë, ti duhet të shtrihesh në shtrat. Vetëm aty e ndaj unë shapin nga sheqeri. Nuk di si të gjykoj kur njerëzit nuk kanë zënë shtratin.

- Nuk kam asgjë, pse të shtrihem?

Ata të familjes, që të nxirrnin merakun, e kandisën Sut Balliun të hynte në shtrat sikur të ishte i sëmurë rëndë. Sa u shtri Sut Balliu, pranë shtratit i erdhi Xhebraili dhe i qëndroi te koka.

- Mirëmbetsh, o Sut, - i tha Nelë Kazani atij dhe doli nga oda.

Suti dhe familjarët e tij kujtuan që Nelë Kazani nuk kishte çfarë të thoshte se kuptohej që Suti nuk ishte sëmurë.

Djali i Sutit që e kishte marrë me kalë, doli ta vinte prapë në kalë dhe ta çonte deri te shtëpia. Kështu vepronin të gjithë. Do t`i jepte edhe paret, se i takonin. Por Nelë Kazani nuk i mori paret, as në kalë nuk hipi.

- E di si është puna, - tha ai duke vështruar ndër sy djalin e ri. - Suti mbas një jave ka për të vdekur. Bëhuni gati.

Vërtet mbas një jave Suti ndërroi jetë mes tmerrit që i shkaktoi tetanosi.

Në mort burrat mbanin në gojë çfarë kishte thënë Nelë Kazani dhe autoriteti dhe pasuria e tij veç vinin duke u shtuar.

Kaluan shumë vite dhe Nelë Kazani po i ndiente shije të madhe jetës. Një natë u zgjua në gjumë i larë në djersë dhe me dhimbje të forta në kraharor. Kur hapi sytë, pa Xhebrailin te koka. U rrotullua me mundim në krevat dhe tek kishte kokën, vuri këmbët. Por Xhebraili i doli prapë te koka. Nelë Kazani disa herë e bëri këtë veprim, derisa Xhebraili i tha:

- Kthehu dhe rrotullohu sa të duash, te koka më ke.



LETËRSIA DHE PROCESI LETRAR NË SHEK.XX
AGRON TUFA / Botimet M&B, 2018
ISBN 978-9928-256-16-4
Faqe 432 / Çmimi: 1500 lekë



RRËFIME DHE KËNGË POPULLORE
MUNIR SHEHU / Botimet M&B, 2018
ISBN 978-9928-256-58-4
Faqe 272 / Çmimi: 1000 lekë



SHTEK MË SHTEK E SKUTË MË SKUTË
MUNIR SHEHU / Botimet M&B, 2017
ISBN 978-9928-4458-2-7
Faqe 208 / Çmimi: 700 lekë

cyan magenta yelloë black 13

Rruga e Arbërit nr. 153

Nëse ndryshojmë mendimin dhe strategjinë për pyjet,
në fakt kemi ndryshuar vetë jetën tonë dhe të brezave që do të vijnë pas nesh.

projekte

Si të kemi një pyll për çdo shtëpi

Bashkëpunimi me Bashkinë Dibër si bashkëfinancues, nëpërmjet zyrës se kordinimit te projekteve dhe stafit të specialistëve te pyjeve dhe kullotave është një obligim më shumë për të rritur kontaktin nëpërmjet modeleve dhe promovimeve reale me banorët dhe komunitetin. Publikimet në median e shkruar, spotet televizive dhe promocionet ne takimet e realizuara, i kanë shërbyer mjaft mirë këtij qëllimi të rëndësishëm. Ky shkrim është në vazhdën e ciklit te promovimit dhe sensibilizimit te komuniteteve qe jane banorë pranë pyjeve bashkiake dhe janë pjesa më e interesuar e komunitetit te bashkisë për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe mbrojtjen e tyre si burim jetese.

Nuk di pse do të desha, që këtë shkrim ta nis me një histori të Haki Kolës, inxhinieri i talentuar dibran për pyjet.

Historia e hershme bën fjalë për dy vëllezër, që jetonin diku në luginën e Drinit. Tokë kishin pak dhe nuk i përballonin nevojat e familjes. Pasi e pleqëruan mirë idenë për të ardhmen, vendosën. Njëri do të qëndronte për të mbajtur familjen, kurse tjetri do të dilte në kurbet për të fituar. Zakonisht, në atë kohë shkonin në Misir të Egjyptit. U vendos dhe u bë. E përcolli vëllai vëllanë për në kurbet dhe kthehet në shtëpi. Shtëpia i dukej bosh dhe sikur e hante. Del jashtë dhe për tëlarguar mërzinë, pret degët e një plepi të vjetër, që ishte në fund të arës.Pasi largon ata më të trashat, të hollat i ngul në tokë me qyski. Deri në darkë e rrethoi gjithë arën me degët e plepit të ngulura, në formën e një gardhi. Ishte pranverë. Shumë shpejt, degët nxorrën gjethet dhe filluan të rriten. Në pak vite u bënë trungje të mëdha. Filluan të përdoren për lëndë për shtëpitë e reja të fshatit dhe fshatrat për rreth. Për çdo shitje vëllai mbante shënim. Pas prerjes së një plepi, aty ngjitur dilte një filiz tjetër që e zëvendësonte.

Vitet kaluan dhe fëmijët u rritën. Vëllai kurbetçi u kthye, i lodhur dhe i drobitur. Pasi u çmallën, filluan të tregojnë hallet dhe fitimet. Qesja e kurbetçiut nuk ishte shumë e madhe. Kur bënë hesapet, rezultonte se vëllai që kishte ndenjur në shtëpi, kishte bërë para më tepër me shitjen e plepave.

Në kushtet kur nevojat për lëndë drusore janë në rritje, kur gërryerjet dhe erozioni bëjnë kërdinë, krijimi i një pylli të vogël pranë shtëpisë dhe kujdesi për zabelet, është një detyrë për gjithë komunitetin. Le të shohim disa përvoja të mira, që japin vërtetë mesazhe të bukura e të mrekullueshme.



KODRA E PESJAKËS

Kështu quhet një kodër me formë shumë të bukur, goxha e madhe, që i qëndron si mburojë fshatit të vogël të Pesjakës, nga ka marrë dhe emrin. Ramazan Koreni, një banor i vjetër i fshatit e ka shtëpinë ngjitur me kodrën. Ai tregon se në vitet e hershme të komunizmit, kodra u pastrua nga drunjtë që e vishnin atë dhe u përdorën për furrate bukës dhe për nevoja të tjera. Ujrat e shirave nuk gjenin më as pengesën më të vogël dhe turreshin drejt fshatit. Në një nga këto mësymje, ata krijuan një rrëshqitje të madhe dhe për pasojë dy shtëpitë e para të fisit Llaka, poshtë kodrës u përpinë nga balta dhe u fundosën. Ishte viti 1963. Fatmirësisht nuk pati viktima, pasi ishte ditë dhe nuk kishte njerëz në shtëpi. Sot atë truall, ku ndodheshin dy shtëpitë që përmendëm e ka blerë Ramazani. Ai nuk ka fare frikë se mos historia e frikshme e atij viti të largët, mund të përsëritet dhe njëherë akoma. Ai madje ka blerë dhe një pjesë të kodrës dhe është bërënjë mik shumë i ngushtë i pyllit. Ka shumë vite, që aty nuk pret më njeri drunj. Dushqet janë rritur, janë trashur, kanë lëshuar rrënjë dhe e kanë forcuar vendin. Në vende të zbuluara,Ramazani ka mbjellë dhe akacje e plepa. Arra e gështenja, të mbjella prej dorës së tij, e bëjnë akoma më të bukur panoramën. Por jo vetëm kaq. Ramazani është një shartues i talentuar, absolut në përqindjen e zënjes. Mollë, kumbull, qershi, të llojeve të ndryshme, i gjen në çdo hap që hedh, kur ecën në pyllin e tij disa hektarësh. Ka dy tre vite, që ka vënë dhe koshere bletësh, duke shfrytëzuar akacjen, gështenjën dhe lulëritë e tjera. Sërish nuk ndalet ky njeri punëtor, që aq aq shumë e do pyllin dhe gjithëgjallesat që rriten në të. Mendon në të ardhmen të bëjë ca shtëpi druri aty në kodër dhe të presë turistë të huaj e vendës, tu afrojë atyre, frutat e pyllit, mjaltin, mishin e qumështin që i prodhon në familjen e tij. Tu afrojë qetësinë dhe relaksin, aromën e luleve, shpirtin e tij të pastër. Në verë, gjethet e pemëve përkunden nga një puhizë e lehtë, si shenjë falenderimi e pyllit për njeriun që i ktheu bukurinë, hijeshinë, forcën dhe identitetin dikur të nëpërkëmbur.

SHEMBUJ TË TJERË

Njerëzit tashmë e kanë kuptuar se bashkëjetesa me pyllin është domosdoshmëri. Nëse e trajton mirë pyllin dhe ambjentin rreth teje, e ke aleat të sigurtë, në të kundërt, ai kthehet në një armik të egër që të shkatërron, siç e pamë pak më parë. Nuk ka fshat, sidomos ato të zonave më të larta, që të mos ketë vënë e të jetë kujdesur për një sipërfaqe pyjore, e vogël, apo e madhe qoftë ajo.

Selman Agolli është një fermer nga Herbeli, shumë i dashuruar pas pemtarisë dhe shartimit. Po kaq shumë e do dhe pyllin, me drunjtë e gjallesat që ndodhen në të. Ai ka mbjellë mollë të llojeve të ndryshme, por dhe katër dynymë lajthi, në vit të gjashtë. Aty, në anë të shtëpisë së tij ka një shpat të pjerrët, për të cilin kujdeset prej vitesh. Ka në të një larmi drunjsh pyjorë, nga të cilët siguron lëndën drusore për dimër, thjeshtë duke bërë krasitjet dhe duke hequr të shtrembërit. Një tjetër fermer po i këtij fshati është Shkëlqim Nurçja. Ai ka më tepër se një hektar sipërfaqe pyjore, që nga kodra që quhet Palivë dhe deri afër liqenit të Grezhdanit. Me fare pak punë e kujdes mund të krijosh këto peisazhe të bukura, më origjinale se piktori më i talentuar.

Pak më tej tyre ndodhet fshati i Grezhdanit. Dikur vërshimet e ujit kanë bërë dëme të konsiderueshme në fshat dhe në të mbjella. Në kohën e komunizmit u ndërtuan dhe prita me gurë e çimento. Tani faqja e malit, që nga Popinara e deri poshtëështë e veshur me pyje, duke eleminuar rrezikun, që u kërcënohej shpesh banorëve të fshatit dhe duke krijuar një kurorë të bukur, që çdo kush do të donte ta vizitonte.

Administratori i komunës së Melanit, Muharem Balliu tregon se shembuj të tillë ka shumë në zonën e tyre. Në fshatin e Trepçës ka një administrim të shkëlqyer të pyjeve të ulta, kësaj pasurie me vlera të pallogaritshme. Fermerë të tillë si Abas Kaferi, Tosum Doda, Abdulla Shtjefni, Sulejman Topuzi, Bajram Kaferi, Sali Mehmeti dhe shumë të tjerë si këta, tashmë e kanë krijuar pyllin e tyre familjar dhe e menaxhojnë atë më së miri. Po kaq të përkushtuar për pyjet janë dhe banorët e fshatrave të Pejkës, Pjeçës, Trenës, duke ulur shumë shkallë fenomenin e gëryerjes dhe erozionit. Vetëm para dy muajsh Shoqata Agro Eko Dibra dhe bashkia e Peshkopisëzhvilluan një seminar trajnues në njësinë administrative të Melanit, për të sensibilizuar banorët në lidhje me menaxhimin sa më të mirë të pyjeve.

Mjaft kohë kemi humbur deri tani, duke i lënë pyjet në mëshirë të fatit. Nëse ndryshojmë mendimin dhe strategjinë për pyjet, në fakt kemi ndryshuar vetë jetën tonë dhe të brezave që do vijnë pas nesh. Specialisti veteran i pyjeve ne zonën e Maqëllarës, Melanit e më gjerë akoma, është në kontakt të vazhdueshëm me banorët e interesuar për këtë problem. Ai thotë se objektivi afatshkurtër dhe afatmesëm është transferimi i pyjeve nga pushteti vendor te komuniteti, nëpërmjet këshillave bashkiakë dhe akteve nënligjore. Ky veprim do të mundësojë, si përdorim te kontrolluar të pyjeve, ashtu edhe privatizim të tyre, sipas parcelave te trasheguara nga banoret e zonave qe banojne prane pyjeve dhe qe po i menaxhojne ata.

Osman XHILI

AgroEko DIBRA

Zall Bastari, mes ujit dhe pa ujë

Teksa udhëtonim këto ditë të fund vitit, në zonën e Zall Bastarit, përgjatë gjurmës që do të përbëjë, pas pak kohësh edhe Rrugën e Arbërit, kaq të shumëpritur nga banorët e kësaj zonë dhe më gjerë, hasëm edhe në disa fletëvolante, UJITJA DHE KULLIMI - JETIKE PER FERMERET, të shpërndarë nëpër fshatra, por jo vetëm, nga qendra për studime dhe trajnime, "ULIMINATOS", në kuadër të projekteve të financuar nga "LevizAlbania".

Në të vërtetë, po të vështrosh terrenin e kësaj zone, klimën dhe mikroklimën, pozitën gjeografike dhe natyrën bujqësorë të saj, bindesh se ekspertiza të tilla sot dhe të në ardhmen janë të mirëpritura prej të gjithëve.

Dukej se qëllimi i organizatorëve të këtij projekti, kishte qenë i qartë;

• Të identifikoheshin mangësitë dhe problematikat me të cilat ndeshen fermerët në ofrimin e këtij shërbimi nga bashkia në zonat rurale.

• Të identifikohet niveli i marrëdhënieve midis Bashkisë qendrore dhe administratës së Njësisë Administrative, përgjegjëse për ofrimin e këtij shërbimi dhe koordinimi i një qasje sa më efektivë mes palëve.

Dy fjalë për këtë njësi administrative, tashmë me ndarjen e re territoriale, pjesë e Bashkisë së Tiranës, dhe që do shtrihet përgjatë Rrugës së Arbërit.

PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I ZONËS.

Njësia Administrative Zall Bastar, përfshin në juridiksionin e saj këto fshatra që janë:

1.Fshati Zall Bastar; 2.Fshati Mener i Siperm. 3.Fshati Vilez. 4.Fshati Bastar i Mesem. 5.Fshati Bastar Murriz. 6.Fshati Zall Dajt. 7.Fshati Besh. 8.Fshati Dajt. 9.Fshati Shengjin i vogel. 10.Fshati Selite e Malit.

Njerëz me një traditë të hershme në këto vendbanime. Me plot histori dhe tradita sidomos në fushën e bujqësisë dhe zejeve. Rrugëkalimi i sotëm, që do të lidhë Dibrën me kryeqytetin është vetëm një infrastrukturë moderne për kohët kur jetojmë, por në të vërtetë kjo gjurmë rruge ka qenë e vetmja dhe më aktivja ndër shekuj. Rrugë me një strategji sa jetike aq edhe ushtarake. Betejat më të famshme të shqiptarëve të kësaj treve, kanë kaluar po përmes kësaj zonë, nga periferitë e Dibrës dhe deri në Krujë e Tiranë.

Toka dhe terreni i kësaj zonë ka qenë fort i shfrytëzuar edhe për bujqësi e blegtori, falë njeriut punëtor të këtyre anëve.

Sipas studimit të Qendrës për Studim dhe Trajnim, "Iluminatos", mbështetur në vlerësimet agronomike, mund të theksohet se sipërfaqja e tokës së punuar, në pikëpamje të përbërjes së saj, mund të klasifikohen si më poshtë: • Sipërfaqe toke mbi ujë 460 ha. • Sipërfaqe toke nën ujë 575 ha. • Sipërfaqe toke që vaditet 144 ha. • Sipërfaqe toke që nuk vaditet 591 ha. •Sipërfaqe toke me probleme për kullimin nuk ka.

KLIMA

Njësia Administrativ Zall Bastar është pjesë e Bashkisë së Tiranës, e cila bën pjesë në zonën klimatike me klimë mesdhetare ne dimër me reshje bore e shiu dhe vere te nxehte e te thatë.

BURIMET NJERËZORE

Siç rezulton nga të dhënat statistikore të marra nga zyra e gjendjes civile rezulton se Njësia Administrative Zall Bastar ka 5637 banorë e organizuar në10 fshatra e 1640 familje të vendosura në 10 fshatra të kësaj Njësie.

Bazuar në këto të dhëna rezulton se 48% të popullsisë e përbejnë meshkujt ndërsa 52% e përbëjnë femrat. Ndërkohe që pjesa më e madhe e popullsisë mund të konsiderohet e aftë për punë. Kjo pjesë e popullsisë kanë si aktivitet kryesore bujqësinë dhe blegtorinë, aktivitete të tjera jashtë tyre janë tregtia, transporti, arsimi, shëndetësia etj.

Popullsia e Njësia Administrative Zall Bastar mund të konsiderohet relativisht e qëndrueshme. Por sipas studimit të sipërpërmendur, pas viteve 90, rezulton që të këtë një migrim të dendur drejt kryeqytetit, pa përjashtuar rastet e një migrimi ditor, për të tregtuar prodhimet bujqësore apo për të ndjekur shkollat dhe punë të ndryshme, dhe jo si rezidentë të përhershëm. Duket se me përfundimin e këtij aksi rrugor të rëndësishëm, ky fenomen, pritet të pësojë ndryshime, dhe zona të ripopullohet duke njohur edhe fuqizimin e turizmit rural. Bazuar në të dhënat e përafërta rezulton se përqindja më e madhe e numrit të popullsisë punon në ferma të vogla private, gati 80 % e popullsisë.

5. Infrastruktura rurale

Duke qenë se bujqësia përbën fushën kryesore të aktivitetit të banorëve të zonës, është më se e kuptueshme se dhe infrastruktura që lidhet me këtë aspekt ka rëndësi të madhe. Në ditët e sotme vetëm 13 hektarë tokë arë, lidhen me rrugë të asfaltuar dhe kanë akses më të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë më tregun. Mungesa e infrastrukturës rrugore është një nga pikat e dobëta të zhvillimit në tërësi të kësaj treve. Ndaj besojmë se rruga e Arbërit do jetë një event zhvillimor, ekonomik dhe kulturor i saj.

Transfertat specifike për financimin e funksionit UJITJA dhe KULLIMI, nga Buxheti i Shtetit për vitin 2018, për BashkiaTiranë, është 20,429.976 lekë;

Ky buxhet është shumë larg përmbushjes së nevojave reale që kanë fermerët për këtë shërbim jetik, i cili është thuajse në kolaps të plotë.

• Njësia Administrative Zall Bastar është përfituese e këtij buxheti në një masë fare të papërfillshme, aq sa nuk mund të zihet në gojë.

• Në lidhje me decentralizimin e shërbimit të Ujitjes dhe Kullimit njësia Administrative e Zall Bastarit, thuajse nuk e ofron këtë shërbim ndaj fermerëve.

Në këtë kuptim, është pak të pohohet se kemi të bëjmë më së paku, me përplasje kompetencash në mes dy niveleve të pushtetit.

Si rrjedhojë, ekziston mungesa e fondeve për investime për ujitjen.

Me të drejtë lind pyetja se pse ka ngecur ky shërbim?

Thjesht për buxhete të pamjaftueshme?

Po. Mungesa e buxhetit është arsyeja kryesore, por jo e vetmja. Duket se mungesa e akteve ligjore e nënligjore për ecurinë e procesit të transferimit të kompetencave nga Pushteti Qendror te ai vendor; dhe nga Bashkia qendrore në Njësinë Administrative, rurale, është një nga gjetjet e shkaqet e mosfunksionimit të këtij shërbimi, sipas studimit të sipërpërmendur.

Pa funksionimin e këtyre organizmave, të njohura edhe me ligj, efekti i përdorimit të ujërave dhe shpërndarjes së tyre në kohë dhe me efektivitet, lë shumë për të dëshiruar, është më shumë se kaotike dhe pa kriter.

Nisur nga të gjitha situatat takimet dhe trajnimet e grupeve të interesit del si nevoje njohja se sa akses kanë fshatrat e Njësisë Administrative Zall Bastar, në Shërbimin publik të Ujitjes dhe Kullimit? Sa eficent është sistemi vaditës dhe i kullimit.

Në lidhje me problematikat e sistemit të vaditjes në Njësinë Administrative Zall Bastar studiuesit e "Iluminatos" informojnë se: sipërfaqja e tokës nën ujë sipas fshatrave është 575 ha. Me një pasqyrë si më poshtë; 1.Fshati Zall Bastar 82 ha. 2.Fshati Mener i Siperm 78 ha. 3.Fshati Vilez 65 ha. 4.Fshati Bastar i Mesem 65 ha. 5.Fshati Bastar Murriz 45 ha. 6.Fshati Zall Dajt 93 ha. 7.Fshati Besh 30 ha. 8.Fshati Dajt 15 ha. 9.Fshati Shengjin i vogel 42 ha. 10.Fshati Selite e Malit. 55 ha.

Por sa nga kjo sipërfaqe vaditet sot sipas fshatrave?.

1.Fshati Zall Bastar 28 ha. 2.Fshati Mener i Siperm 20 ha. 3.Fshati Vilez 14 ha. 4.Fshati Bastar i Mesem 14 ha 5.Fshati Bastar Murriz 20 ha 6.Fshati Zall Dajt 14 ha. 7.Fshati Besh 4 ha. 8.Fshati Dajt 2 ha. 9.Fshati Shengjin i vogel 3 ha. 10.Fshati Selite e Malit. 13 ha.

Sipas ekspertëve, do kishte zgjidhje për këta banorëve, edhe vendosja e pompave apo bërja e puseve, por këta të fundit janë farë të pakët.

Nuk ka sipërfaqe të ujitshme dhe sipërfaqe e kullueshme që mbulohet nga Shërbimi publik i Ujitjes dhe Kullimit?

Asnjë fshat nuk ka rrjet kanalesh ujitës(janë jashtë funksionit).

Totali i tokës bujqësore është 735 ha nga të cilët nuk kanë asnjë mundësi vaditje me kanale vaditëse apo pompa .

Kanale ujitëse të para janë jashtë funksionalë.

Kullimi, paraqet problematika edhe më të mëdha dhe si rrjedhojë, erozioni është masiv dhe kërcënues për strukturën e tokës.

Kanalet e para dhe të dyta janë të papërdorshëm, për dhjet vjeçarë të tërë.

Vepra ujitëse të inventarizuara nga ish kooperativat bujqësore janë jashtë funksionit në Zall Bastar:

Efektet e zbatimit të ligjit 139/2015, do ishin një kthesë e konsiderueshme në problematikat e hasura në këtë fushë, por ende nuk ka ndonjë nismë konkrete në Njësinë Administrative, për shndërrimin e këtij shërbimi publik në Prioritet në Buxhetin e vitit 2019. Edhe strategjitë mungojnë.

Pritet me interes që të ndërmerren nisma konkrete për lobim pranë këshillave bashkiakë për ta përfshirë në prioritetet e tyre shtimin e buxheteve për këtë shërbim jetik për fermerët edhe të kësaj zone? Duket se misioni i studiuesve për këtë çështje është i përmbushur, dhe i ofron komunitetit rrugë zgjidhje të qëndrueshme.

Ata sugjerojnë nisma konkrete për përfshirjen e administratës vendore që mbulon këto shërbime, për t'u përfshirë në projektet për të përfituar fonde të programeve kombëtare dhe ndërkombëtare që subvencionojnë rehabilitimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit në territorin e qarkut Tiranë.

Të gjithë këta faktorë të koordinuar së bashku, duket se do ti japin një tjetër frymëmarrje zhvillimit të kësaj zonë me resurse tejet të dallueshme në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, përmes funksionit kaq jetik të sistemeve ujitjes dhe kullimit në gjithë krahinën e Zall Bastarit. Zall Bastarit që i kalon lumi dhe ujërat na krah, nuk ka pse te vuaje për to.

Fisnik SINA

Zall bastar, dhjetor 2018

ILLUMINATOS
QENDER PER STUDIM & TRAJNIM

kulturë

Naim Berisha, krijues i sprovuar i këngëve të arrira

Nga MEVLUD BUCI



Naim Berisha, muhurraku, mësuesi dhe veprimtari, drejtues i arsimit, që tashmë jeton në Londër, numëron mbi njëzet libra letrarë-artistikë. Ai është njëkohësisht gazetar, këngëtar, krijuesi i muzikës, duke dëshmuar se është një krijues me interesa të gjera dhe me prirje në shumë fusha të artit.

Para gati dyzet vitesh pata punuar me Naim Berishën në arsim. Ish mësuesi i Qafë Murrës mbetet sërish në kujtesën time i përkushtuar, krijues tekstesh, kompozitor, interpretues i këngës, i dashur dhe korrekt, i lidhur me njerëzit dhe me traditat, dhe më gëzon fakti se, edhe pse ai ka ikur në Londër, i ruan sërish këto vlera dhe i manifeston ato, jo vetëm në kontakte të gjalla, po edhe në veprat e tij të mirëpritura nga lexuesi.

Veprat (romanet, poezitë, fabulat, publicistika) e tij meritojnë studime më të gjera e më të thelluara. Ato tashmë përbëjnë korpusin e një krijimtarie që me mund e djersë e i ka ngritur arkitekturën e ngrehinës së vet artistike, si rrezatimin e historisë dhe i shpirtit të brezave, po edhe i aktualitetit të marrëdhënies së individit shqiptar. Koha gjithnjë e bën të vetën, por asnjëherë nuk duhet harruar se ajo për çdo individ ka një fillim dhe kurbën e saj. Koha, shokët, provat e mësimdhënies në Qafë Murrë e të drejtimit arsimor në shkollën e mesme Burrel e ngado shërbeu, tregojnë sesi ai punoi, si një mësues i vërtetë, plot pasion e përkushtim dhe sesi me figurën e mësuesit rrezatoi besim e kurajo për nxënësit, duke i nxitur ata në udhën e dijes dhe të përparimit, një dimension ky i personalitetit të një njeriu që bashkonte figurën e mësuesit me atë të artistit, duke i dhënë prioritet herë njërës e herë tjetrës. Babai i tij, Osmani, ishte një njeri i urtësisë e i karareve, po kështu e ëma, një grua e mençur, si dhe dajat e tij.

Në rrugëtimin e karrierës së vet pedagogjike ai pati edhe ndihmën e njerëzve të tjerë drejtues të talentuar të arsimit si: Xhemal e Lik Berisha në Muhurr të Dibrës. Në majëmale, në Katër Grykët e mia, në Lukanin tim, rrëzë Runjës 2047 metra e lartë, s`ka ditë të javës që të mos dëgjoj në celular, facebook, këngët e Naim Berishës. Mbi njëzet vite në emigracion dhe mbi njëzet vepra letrare, një punë kolosale dhe e përkushtuar. Dhe të gjitha me prova zotësie.

Këngët e tij janë këngë për vendlindjen, për bukuritë natyrore të saj, për njerëzit, për dashurinë e tyre ndaj truallit, ndaj njëri-tjetrit dhe atdheut. Ato shprehin forcë, mall e brengë, janë epike dhe lirike, të ashpra dhe të buta, plot thellësi ndjenje e nivel artistik. Tani që po i mbush të shtatëdhjetat, i dëgjoj këto këngë si të isha i ri, më japin besim dhe më ngrohin zemrën se ato përcjellin jo vetëm jehonën e jetës, po japin edhe shpirtin dhe zotësinë e artistit. Me Naim Berishën na lidh jo vetëm fakti se jemi bashkëkrahinarë, po edhe rruga e artit, dhe së bashku me bashkëshorten time Shahe, patëm fatin ta prisnim në kullën tonë me bukë e kripë e zemër, ashtu si dikur babai i tij Osmani na pat hijeshuar kullën dikur me ardhjen e tij. Aty në kullën tonë ia thamë këngës dhe çiftelisë se këngët e Naim Berishës janë dritë zemre, dhe, për momentin, kur po dëgjoja këngët e tij u përlota. Ishte forca e këngës dhe e tingullit të pastër dhe të ngrohtë. Midis shumë e shumë këngëve veçojmë ato kushtuar trimave Dine Hoxha dhe Liman Berisha, "Moj dibrane", "Moj e mira muhurrake" e plot të tjera. Krenar, i thjeshtë, sublime e frymëzues, kushtrimtar, i përmalluar, realist e mjeshtër i interpretimit, janë këto disa cilësi të spikatura të portretit krijues, artistik të Naim Berishës. Zëri kumbues e melodia sikur të thërrasin:

Dine Hoxha e lshon zanin
Bini or burra për vatanin
E faroi asqerin e ngratë
Dine Hoxha me Muhurrakë
E faroi asqerin të tanë
Dine Hoxha me dibranë.
Katër Grykë, Muhurr e Luzni
E kanë hedh asqerin në Dri
Lum dy Dibrat që të kanë ty
Dine Hoxha nga nji për shpi.

Këngët e Naim Berishës janë një vlerë e shtuar me intonacione nga folklori dhe traditat e krijimtarisë popullore. Ato ngjallin mall e dashuri, japin kënaqësi shpirtërore e frymëzojnë.

Këto janë moto e shpirtit dibran dhe arbëror, që japin lajtmotivin e një populli martir, qëndrestar e kulturëdashës, një populli që çmon lirinë dhe dashurinë dhe krenarinë për brezat. Vargjet e Naim Berishës lartësojnë vlerat dhe vetëm vlerat:

Liman Berisha, o pritë më pritë,
o këtë serbin e ka korit,
Që në Hotesh e Topojan, Liman Berisha
o djalë azgan
Hej, s`jemi çika e s`jemi gra, por jemi
burra për me u vra.

Edhe lirika e Naim, Berishës janë thesare shpirti që burojnë nga një zemër e madhe.

Moj dibrane, lulja e blinit,
Ty të kam në dritë të synit
Apo: Hajde, hajde, moj muhurrake,
Je si lule, lulezambake
Ma e mira shtatbajrake
Je punëtore e bash e bukur
Degë më degë porsi flutur
Lule e rrallë porsi bletë
Muhurrake m`i luajte mendtë.
(Kënga"Moj e mira muhurrake").

Këngët e Naim Berishës janë një vlerë e shtuar me intonacione nga folklori dhe traditat e krijimtarisë popullore. Ato ngjallin mall e dashuri, japin kënaqësi shpirtërore dhe krijojnë imazhe të bukura e frymëzojnë.

Elegji për njeriun më punëtor që kam njohur...

Emini i Ashikëve të Brezhdanit

Nga **Abdurahim ASHIKU**



Emini iku...
Iku thjeshtë dhe qetë, siç ikin njerëzit me dinjitet...
Për të nuk shkruan gazetat... Shkroi djali i tij, Blerimi në një kënd të faqes për të gjithë, në facebook...
E mbuluan ngushëllimet...
Si tufa me lule...
Si kurora me shkronja dhimbjeje dhe kuraje..
Më dhëmbi shumë...
I shkrova Blerimit... "Ngushëllime për ikjen e babait tuaj, shokut tim të fëmijërisë, njeriut më punëtor që kam njohur në jetë EMIN DIK DHE NIJE ASHIKUT. Të rroni, ta kujtoni dhe ta nderoni."
Do të desha të kem adresat dhe t'u shkruaja, tre djemve të tjerë, se katër lindi dhe rriti Emini me Serveten... Eduardit, Marenglenit dhe Sadikut (paska marrë emrin e Dikës, gjyshit të tij)... Tri vajzave: Beltrinës, Valbonës e Alketës... 20 nipërve e mbesave (një lagje e tërë, tash jo në Dibër por në Durrës)...
Është e madhe dhembja me kaq degë të dala nga një trung, me kaq lotë të mbushur grusht... Por, si i thonë në Dibër, kur prindi i le fëmijët prapa, nuk ikën i djegë, përcillet me lodër e cule... Unë e jetova dhimbjen në një bisedë me Stivenin, djalin e Blerimit. E pyeta në se më njihte kur më drejtohej "xhaxhi".
Më tha se jam 16 vjeç...
Nuk më njihte nga pamja por nga gjaku...
Stivenit i iku Gjyshi... Unë do t'i tregoj pak për stërgjyshin dhe stërgjyshen, Dikë Ashikun dhe Nije Ashikun... Do ti dërgoj dhe një fotografi të shtëpisë në Zdojan, shtëpi që e ndërtoi stërgjyshi, shtëpi ku lindi gjyshi me vëllezër e motra, shtëpi që e fotografova tre vjet të shkuara, shtëpi e braktisur por ende në këmbë mbi themele stërgjyshore, rrënjë nga kanë dalë e kanë marrë dheun pema e madhe e jetës... Atëherë, kur fotografinë e përcolla në facebook, shënoja... *"Të moçmit, të mençurit, gjyshstërgjyshat tanë thoshin...kur të bësh shtëpi të re, shtëpinë e vjetër mos e shemb, mbaje në këmbë, mbushe me drithë, me jonxhë të tharë e kashtë për dimër. Kjo është shtëpia e Dik Ashikut. E mbaj mend kur hodhi themelet dhe vuri çatinë... Fëmijët e tij, Veseli, Emini dhe Sinani lindën dhe rritën "një mëhallë me djem" të cilët kanë bërë shtëpi të reja në Zdojan, në Tiranë, Durrës dhe jashtë vendit. Shtëpia e prindërve dhe e gjyshit Dikë dhe gjyshes Nije Ashiku është në këmbë. Respekti për të parët tregohet duke mos ua rrënuar djersën dhe mundin e derdhur një jetë të tërë."*

Dika, babai i Eminit ishte i pari i tre vëllezërve bijë të Sel Ashikut: Sadullit dhe Lamit... I mbaj mend mirë se jam rritur nën hijen e tyre... Vetëm rruga që përshkonte tërë lagjen i ndante trojet e mia...

Dika ishte njeri i qetë, i punës në bujqësi e i punës në mulli. Portretin e tij e ruaj në kujtesë të thinjur e të zbardhur rrobash nga puhiza e miellit që mbushte tërë hapësirën e mullirit. Me Nijen, një grua edhe ajo e qetë si i shoqi, lindën e rritën Veselin, Eminin dhe Sinanin nga djemtë dhe Narushien e Kadrien nga vajzat... Veseli, lindur tri javë diferencë me mua, iku i ri duke lënë pas gruan dhe dy fëmijë...

Sinani nuk rreshti të kërkojë një vajzë për pjesë të familjes së tij. E gjeti pas shtatë djemve... Sadulli ishte inteligjent. Kishte një dyqan në fillim në shtëpi e më pas në një të ndarë të mullirit. Shiste deri gjërat më të vogla jetësore e shkollore, veçanërisht për gra e vajza. Blinte vezë, misër, groshë e të tjera prodhime bujqësore asokohe kur ende në fuqi ishin triskat e gjërat e jetesës ishin ngushtë e ngushtë...

La pas djem e vajza që mbushën mëhallën me themele shtëpish. Basriu dhe Hyseni më vijnë në kujtesë... Edhe Lumja, e bukura Lume, aq e dashur, aq e mirë, aq e qeshur... Lami, derisa iu rritën djemtë, në shtëpinë e vjetër dykatëshe jetoi. Bedriu dhe Ramazani hodhën themele të reja në ugrade... Zarifka, aq e dashur dhe punëtore e lidhi jetën me trojet e të parëve...

Emini, që sot ma hapi liqenin e lotëve, ishte njeriu më punëtor i lagjes, i fshatit.. Nuk kishte shkollë Emini, shtatëvjeçaren vetëm... Kishte shkollën e punës, shkollën e njeriut që çfarë i sheh syri ia bën dora... Shkollën e jetës që është vlera më e madhe për njeriun e thjeshtë...

Athinë, 26 janar 2019

Rruga e Arbërit nr. 152

botime

Halil Rama nuk resht së befasuari me krijimtari të reja, siç është libri i tij më i ri

"Rizgjime meteorësh" - një botim i ri me krijime të reja, të arrira artistikisht

Dr. Selman MËZIU

Të hedhësh në letër vargje poetike, të shkruash një reportazh, të krijosh një portret të një njeriu me bëma të shumta, qoftë ky shkrimtar, ushtarak, artist etj., t'i futesh punës për të shkruar një reçensë (vlerësuese) të një libri artistik, i çfarëdo gjedhi qoftë, duhet më parë të kesh qenë nxënës studioz, më pas të bëjsh një jetë intensive për të njohur në thellësi e gjerësi realitetin shoqëror, historik, të natyrës; botën e brendshme dhe psikologjinë e heroit tënd, shoqëruar me leximin e librave, dokumenteve e duke rrokur motive gjurmëlënëse në jetën e përditshme.

Një realizim të tillë dinjitoz e ka arritur shkrimtari dhe gazetari Halil Rama, i cili ka hedhur tanimë për t'u lexuar nga bashkëkombasit e tij 13 libra me bashkautor ose i vetëm, si monografi, libra me shkrime të ndryshme me karakter historik, letrar apo të fushës së gazetarisë. Duke fituar një popullaritet të gjerë, një respekt të pakufishëm dhe rrezatuar trimëri, guxim, edukatë, kulturë të gjerë ka përthithur lexues të shumtë, për të lodruar me plotë dëshirë në polenin e krijimtarisë së tij plotë ambëlsi e kërshërëri.

Ky krijues nuk resht së befasuari ato me krijimtari të reja më të arrira artistikisht, siç është libri i tij më i freskët i titulluar: "RIZGJIME METEORËSH", ku edhe këtu në lëndën e derdhur mjeshtërisht me një krenari krijuese në mushtën e kapitujve të mëposhtëm: "Takohemi për një libër"; "Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave"; "Personalitete" dhe "Poezi të shkurtëra të çastit por kuptimplote e emocionuese"...., krijim pas krijimi, rrjesht pas rrjeshti gjendet adhurueshëm personaliteti i tij krijues, talenti i të shkruarit qartë e thjeshtë, njohuritë e tija, të thella e shumëplanëshe, mprehtësia e mendimit, mjeshtria e përshkrimit dhe gjetjes së detajeve, stili vetiak i të shkruarit, i të treguarit të ngjarjeve apo "vizatimit" të portreteve, duke përdorur një gjuhë të pastër, të rrallë, me fjalë të dalura nga gurra e pashtershme e librit të jetës dhe të lexuar, materialeve historike, gjuhës popullore mbarëkombëtare dhe e krahinës së Dibrës.

Me frymëzim dhe i prekur thellë në shpirt autori shkruan me plotë emocione, dhimbje, krenari të ligjshme për Heroin – legjendë në kufirin e tri kohëve, gjeneralin shekullor Rrahman Parllaku. Me një stil të veçantë autori shkruan profilin e Safet Zhulalit si Ministër me karakter të papërthyeshëm e largpamës, i cili ishte dhe mbeti një meteor në politikën shqiptare.

Kureshtësia në lexim do t'iu befasojë me analizën që i bëhet librit të diplomatit të mirënjohur, Shaban Murati, "Kalvari diplomatik i shtetit të Kosovës", i cili në një libër tjetër e "konsideron çështjen e detit si një nga dosjet më enigmatike të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Greqisë".

Më tej të nxit të lexosh me plotë kërshëri librin e Hysen Dervishit "Dibra, zemra e kombit" për të cilin Halili shkruan: "Ka shprehur mjeshtërisht ngjarje e fakte që flasin për luftëra e individë, për figura politike e patriotike që kanë bërë historinë përmes mendjes dhe pushkës,..."

Një vend të veçantë në librin e ri të H.Ramës zë analiza e romanit "Martesa e dytë" të autorit Flamur Buçpapajt, ku ndër të tjera shkruan se: "ka skalitur veçanërisht portretet e Borës dhe Jetonit, por personazhe interesantë janë edhe nënë Ajshja, magjistarja Bukurije, Naimi, shoku i ngushtë i Jetonit, murgeshat si dhe motra e vogël e Borës".

Po ashtu, autori ndalet tek romani "Polakja" të shkrimtarit të mirënjohur Xhevat Mustafa i cili "mbart vlera për koherencën dhe mesazhet aktuale".

Për romanin e parë të shkrimtarit bulqizak Agim Demiri "Njeriu pa maskë", përgjatë analizës së tij të hollësishme ai do të shkruaj: "... ky roman mbush një zbrazëtirë të dukshme në analet e letërsisë shqipe". Ndërsa duke u ndalur me kujdes e me dallgë frymëzimesh mbi librin me novela: "Pemë e shartuar", të dibranit me banim në Kanada, Eliot Moglica, ai shkruan: "libër brilant", "stil i ri letrar", "autori i 16 librave me poezi, romane, biografi, tregime/novela dhe libra për fëmijë".

Në karvanin e vlerësimeve autori i librit shkruan për monografinë: "Burri i Odës Dibrane", kushtuar Hazis Ndreut, rapsodit, mbledhësit të folklorit, historianit etj, të cilin e vlerëson: "... si një libër shumëvlerësh, të stilit dhe llojit të veçantë, të autorit Bujar Kapexhiu, "Mjeshtër i Madh", artist i merituar, regjisor, skenarist dhe aktor i mirënjohur shqiptar".

Shkruesi i apasionuar Halil Rama, tanimë shkruan për një krijues tjetër në fushën e historiografise dhe ja: "Pas tetë botimeve tematike për vlerat historike, kulturore dhe njerëzore, kryesisht për kryeqytetin shqiptar, studiuesi dhe analisti i mirënjohur Valter Gjoni sjell për lexuesin: "42 kryetarët e Tiranës, në një album fotografik dhe historik". Një shërbesë e domosdoshme për njohjen e historikut të organizimit administrativ të kryeqytetit. Duke vazhduar me librin studimor "Qarku i Kukësit në rrjedhën historike", i autorit Xhavit Lashi, i fokusuar tek ndarja administrative dhe qeverisja vendore në këtë qark, që nga lashtësia e deri në ditët e sotme..., duke ndjekur hap pas hapi veprimtarinë krijuese të Lashit, vlerësuesi shkruan: "... njëri nga ish-nxënësit e shkëlqyer të saj, historiani Xhavit Lashi botoi monografinë "Shkolla Pedagogjike e Peshkopisë", duke plotësuar një boshllëk në historinë e arsimit dibran me burime arkivore e një literaturë të pasur".

Me tej autori analizon me kujdes librin në fushën e mjekësisë të Dr. Arjan Hamitit "Anemia në sëmundjet kronike të veshkave" i cili: "... do ndihmojë Mjekët e Familjes dhe specialistët në diagnostikimin e të sëmurëve me anemi....".

Duke patur njohje të drejtpërdrejt me të ndjerin, shkrimtarin Teodor Laço, autori i librit, Rama do të shkruajë për të: "Si romancier, tregimtar, dramaturg, komedian, esseist, komentator, opinionist e politolog, ai padyshim njihet nga lexuesi shqiptar, por dhe ai i huaj.....".

H.Rama do të shkruaj me plotë frymëzim edhe për piktorin Alajdin Tabaku: "... i cili realizoi një seri peisazhesh dhe galeri portretesh me tipa e karaktere lakmuese që rrallë i gjen" si dhe për dibranin e mençur e vizionar Shuaip Methasani. Interesant është edhe profili i intelektualit Halit Berisha, i cili i përballoi me dinjitet sfidat e jetës.

Duke u ulur këmbë kryq me njerëzit e thjesht autori portretizon me mjeshtri, kujdes e depërtim psikologjik: "Vizionin e ushtarakut bashkëkohor dhe dimensione njerëzore Ruzhdi Baxhaku". Dhe në vazhdim ai ndalet tek mësuesi Lutfi Ndreu i cili "..e ndjeu si shpirtëzohet dashuria në vetësinë e tij për nxënësit që materializohen si emisarë të dritës". Më pas krijuesi energjik Rama, me një fushëpamje të gjerë në gjetjen e heronjve të tij, trajton emocionues: "Kosovare Rrustemin nga Zhegra e Gjilanit ....e vetmja deputete shqiptare në Asamblenë e Kantonit të Solothurnit të Zvicrës". Ajo krenohet me vëllain e saj "Mjeshtri i Madh", Erzen Rrustemi, Kampion Bote në peshat e rënda të boksit.

Një vend të veçantë në libër zënë edhe kampionët e botës në kikboks, vëllezërit bulqizakë Ismail, Gjetan e Ferit Keta.

Duke qenë gjithmonë novator autori e trajton portretin e gazetares Mimoza Dajçi nëpërmjet librit të saj të ri "E bukura nën pranga", me reportazhe, skica letrare, esse e përshkrime. Lexuesi i zellshëm dhe i rrëmbyer faqe pas faqeje të këtij libri do të njihet me Elona Loparin, vajzën shqiptare, të suksesshme në New York, e cila ka për moto: "Unë nuk dua vetëm të mbijetoj, por edhe të vazhdoj të përpiqem për të arritur objektivat".

Në portretizimin e të ndjerit, ushtarakut Selman Rama, shkruesi i librit "Rizgjime meteorësh" arrin në përfundimin: "Për katër dekada, karrierë si nxënës, student e oficer marine ai ka shpalosur vizionin e ushtarakut bashkëkohor dhe dimensionin njerëzor, të trashëguar nga Familja dhe të perfeksionuar gjatë punës e jetës ushtarake".

Reportazhi "Bulqiza në 70 vite, minierë dhe qytet", është një histrori e analizë e thellë e veprimtarisë shtatëdhjetë vjeçare me "zhgënjime dhe emër", me "heronj të rinj e të moshuar", "me plagë vuajtjesh e djersë këllira prej pluhuri". Më pas një trajtesë tjetër në gjedhin e reportazhit "Universiteti" ku studioi elita e Dibrës, i rrëfyer më së miri prej njërit nga mësuesit e parë të saj, shkrimtari Lutfi Hanku – një nga korifenjtë e vërtetë të kulturës dhe arsimit kombëtar në Dibër". Në vazhdim vlerat shëruese dhe burimet e të ardhurave të Ujërave termale, ose "Llixhat" e mirënjohura të Peshkopisë, duke u trajtuar me mjeshtëri gazetari, tanima plotësisht të maturuar.

"Historia e rrallë e familjes Gjonej nga Trushi i Shkodrës", trajtohet nëpërmjet episodeve historike të rrëmbimit të Hajgelës, Krajlit të Malit Zi, letrës anonime dërguar Enver Hoxhës dhe përkujdesjes së Dr. Ben Gjonej për gjeneral Parllakun në spitalin e Traumës në Tiranë.

Dhe ja një degëz me frutin poetik: "Flakërima e shpirtit, djeg sa qindra zjarre"; këto janë disa shpërthime të momentit nga gurra poetike e Halil Ramës që mbyllin kurorën krijuese të librit të fundit.

Një vend të veçantë në librin e tij të ri, H.Rama i kushton panairit të librit Tetor 2018, në qytetin e Peshkopisë me libra të 148 autorëve dibranë si dhe Shtëpisë Botuese "M&B", për realizimin e këtij panairi në kuadrin e një jave kulturore në Dibër, e cila shpresojmë të kthehet në një traditë, sidomos kur të marrë udhë Rruga e Arbrit.

Halil Rama, kryeredaktor i dy gazetave "Veterani" e "Bulqiza", prej disa vitesh, ka konkurruar denjësisht në shtypin e kohës por ai ka botuar reçensione në gazetën letraro-kulturore javore "NACIONAL" si edhe në suplementin "Milosao" të "Gazeta Shqiptare". Dhe jo vetëm kaq por në shtypin e kohës ai shkruan vazhdimisht artikuj me probleme të ndryshme të shoqërisë demokratike të kohës.

Gjerdani i krijimeve të librit "Rizgjime meteorësh" kamëron në hullitë e jetës me dashuri e drithërime të vrullshme, nëpërmjet rrëfimeve të shtruara, por të natyrshme dhe gjithë urtësi, mençuri e stil mjeshtërisht të gjetur, ku ngjizet mushti artistik me morinë e fakteve, ngjarjeve, detajeve historike, karakteret e ndryshme etj.

Lexuesit i urojmë udhëtim të mbarë, me plotë aromë poetike, artistike, emocionesh, kënaqësish në shfletimin e magjisë të personazheve, fakteve, ngjarjeve, historive, duke mësuar më shumë, duke u kulturuar e pasuruar me fjalësinë dhe mënyrën e të shprehurit, sjelljeve etj., ndërsa gazetarit e shkrimtarit Halil Rama, suksese të pashterrshme në krijimtarinë e tij të plleshme e plotë bereqet.

Firence 17.12.2018



Një vend të veçantë në librin e tij të ri, H.Rama i kushton panairit të librit Tetor 2018, në qytetin e Peshkopisë me libra të 148 autorëve dibranë si dhe Shtëpisë Botuese "M&B", për realizimin e këtij panairi në kuadrin e një jave kulturore në Dibër, e cila shpresojmë të kthehet në një traditë, sidomos kur të marrë udhë Rruga e Arbrit.

Gjerdani i krijimeve të librit "Rizgjime meteorësh" kamëron në hullitë e jetës me dashuri e drithërime të vrullshme, nëpërmjet rrëfimeve të shtruara, por të natyrshme dhe gjithë urtësi...

cyan magenta yelloë black

dossier

Çudi e madhe! Marrim vesht se buxheti i Bashkisë së Dibrës në vitin 1930, ka kapur shumën dy milion dinarë, që në vitin 1928 ka qenë 80.000 dinarë dhe gjithnjë Dibra vjen duke u prishun; të hollat prishen edhe për qëllim helmimin e shqiptarëve e për detyrim me u largue nga Dibra.

Musa Shehu, mësues dhe gazetar i **"Ora"**-1930

Ekisha has për herë të parë në faksimilet e disa dokumenteve të viteve '20 të shekullit të kaluar, faksimile marrë nga Arkivi i Shtetit. I mora fotografitë dhe i kam ende në arkivin tim. Asokohe isha gazetar i Agjencisë Telegrafike Shqiptare për rrethet Dibër dhe Mat

Musa Shehu emërohej mësues në Lurë. Dokumenti fliste për: "Viti shkolluer 1925-1926."

Vite më vonë në 50 vjetorin e shkollës së parë shqipe në Lurë do ta shoqëroja, do t'i bëja disa fotografi e do të zhvilloja një bisedë për ditën e parë të shkollës shqipe në Lurë. Kishte një kujtesë fotografike tek përshkruante në detaje organizimin e mësimit, emrat e njerëzve që e ndihmuan në të gjitha drejtimet...

Vite më vonë, tek shfletoja në gazetat e vjetra shqiptare në Bibliotekën Kombëtare në kërkim të Dibrës dhe Dibranëve në kohë e hapësirë në faqet e gazetës ORA hasa dy shkrime me firmën Musa Kuçi.

"Kuçi" është mbiemri popullor i familjes së tij, mbiemër i lidhur me Sheh Hysen Kuçin, klerik dibran i Teqes së Vxhenit, pushkatuar nga serbët më 22 shtator 1913 si një ndër organizatorët e Kryengritjes Popullore Dibrane të shtatorit 1913 kundër pushtimit serb.

I kopjova të dy shkrimet, doreshkrim që fatmirësisht nuk humbi në ikjen time larg Dibrës e Atdheut.

Nuk mund t'i mbaj në arkiv. Ato flasin me gjuhën e kohës si një mesazh mbase edhe për ditët tona...

DIBRANËT E MJERË U FARUEN FARE

Faqeve të gazetës "ORA" 1930, penë e Musa Kuçit (Shehu)

Dibra u pre për fyti, siç pritet berri e ndahet nga trupi si n'atë legjendën këngë "Koka në Stamboll e trupi në Janinë". Kësaj radhe nuk bëhet fjalë për një njeri, por në një trevë të tërë që po të heqësh vektorë nga ekstremet e kasolleve me themele shqiptare, takohen në Dibër për ta fiksuar atë si "Qendër Gjeografike Shqiptare". "Koka", qyteti i Dibrës së Madhe apo Shehri i Dibrës siç i thonë dibranët mbeti nën pushtimin sllav.

U bë një betejë e madhe në shtatorin e vitit 1913 ku babai i autorit në fjalë Sheh Hysen Kuçi u vra bashkë me pesë të tjerë si pjesëmarrës në kryengritjen më të madhe popullore dibrane për mbrojtjen e trojeve të lashta.

Musai që ishte 11 vjeç, bashkë me dy vëllezërit dhe katër motrat e kaloi Drinin futur; fëmijë dy e nga dy në koshat e kalit.

Nuk prani kurrë pushka e dibranëve "të vetëm në betejë" për ta bashkuar "kokën" me "trupin". Pushka, mjerisht, nuk pati "barut mbarëshqiptar" dhe u fik...

Abdurahim Ashiku





Dibra u pre për fyti, siç pritet berri e ndahet nga trupi si n'atë legjendën këngë "Koka në Stamboll e trupi në Janinë". Kësaj radhe nuk bëhet fjalë për një njeri, por në një trevë të tërë që po të heqësh vektorë nga ekstremet e kasolleve me themele shqiptare, takohen në Dibër për ta fiksuar atë si "Qendër Gjeografike Shqiptare". "Koka", qyteti i Dibrës së Madhe apo Shehri i Dibrës siç i thonë dibranët mbeti nën pushtimin sllav.





KRIZË E MADHE EKONOMIKE NË DIBËR

Gazeta "ORA", 5.11.930

Sot në popull asht një krizë e madhe ekonomike mbasi probleme të bulkut nuk kanë vleftë, ngaqë bulqit të këtij rajoni mbiellin vetëm drithë dhe grurë, nuk ka nëpunësit ekonomik që të dirizhojë me mbjellë duhan e tjera.

Nga ana tjetër; në këtë rajon po ushtrojnë profesionin 80-90 tregtarë nënshtetas jugosllavë dhe gjithë florinin po e nxjerrin jashtë, ndonëse kjo vepër asht e ndalueme në artikullin 1-2 të ligjit mbi ndalimin e të huajve me ushtrue profesion në Shqipni.

Peshkopi 31.X.930

KUÇI
DIBRA E MADHE VUAN NGA SERBI

Dibra e Madhe që përbahesh prej 15.000 frymë shqiptarë e 1000 frymë bullgarë, sot ka ngelë me 5000 shqiptarë dhe 800 frymë bullgarë, për shkak se bashkia e vendit si dhe zyra e tatim-fitimit i detyron për çdo frymë me pague1000 dinarë dhe sot ndërtesat e shqiptarëve që kushtojnë 20.000 franga ari prishen vetëm për pagimin e Vergjisë. Më një anë tjetër ka urdhënuegjindarmërinë me u marr nderin dhe i rrafun nëpër dugajë.

Vuejtje e madhe asht në popullin e mjerë shqiptar që gjinden nëpër thoj të Serbisë çdo ditë e detyruar të largohen me qëllim që të humbin kombësinë shqiptare sido që traktati i lidhun me shtetin shqiptar asht kontratue për lejimin dhe hapjen e shkollave. Përkundrazi gjithë shqiptarët mësuesa me rrogën e dobët, dhe me urdhër të ndaluem që të mos stërvisin e mësojnë gjakun shqiptar sot i kanë pushue dhe gjithë po dalin në Shqipni me marrë nëpunsija të ndryshme.

Çudi e madhe! Marrim vesht se buxheti i Bashkisë së Dibrës në vitin 1930, ka kapur shumën dy milion dinarë, që në vitin 1928 ka qenë 80.000 dinarë dhe gjithnjë Dibra vjen duke u prishun; të hollat prishen edhe për qëllim helmimin e shqiptarëve e për detyrim me u largue nga Dibra.

Në këto ditë Nënprefektura e Dibrës së Madhe me qëllim politik ka vendos prishjen e 60-70 shtëpi e dugaj dhe për largimin e shqiptarëve nga Dibra. Në këto ditë shohim se shumë Dibranë familjarisht po shpërngulen prej Dibre dhe vijnë e banojnë 5 familje në një ndërtesë në qytetin e afërm Peshkopi.

Dibranët e mjerë u faruen fare.

Peshkopi, më 20.X.1930

Rruga e Arbërit nr. 153

studim

Në radhët e ushtrisë shqiptare, përkrah njëri-tjetrit, kanë qenë luftëtarët e besimit të krishterë, katolikë e ortodoksë, por edhe të besimit mysliman, siç ka qenë vetë Skënderbeu dhe nipi i tij, Hamzai...

Karakteri atdhetar i luftërave të Skënderbeut, themelues i shtetit të parë kombëtar shqiptar

Nga Ali HOXHA*

(vijon nga numri i kaluar)

Por kjo nuk do të thotë dhe nuk vërteton aspak që R. Alia të jetë kthyer as në katolik dhe as në mbrojtës të krishterimit, ndoshta as besimtar.

Në këtë aspekt, mendimi ynë përforcohet edhe nga mendimi i z.Vlash Prendi, i cili në studimin e tij "Gjergj Kastrioti dhe Selia e Shenjtë" ndër të tjera shkruan: "Marrëdhëniet e Gjergj Kastriotit me Vatikanin janë pasqyrë e një prej aspekteve më të rëndësishme të personalitetit të tij prej burri shteti dhe diplomati, të lindur në Dibër më 1405 dhe vdekur në Lezhë më 17 janar 1468. Duke qenë se Selia e shenjtë në Mesjetë ishte pushteti qendror i Europës dhe ushtronte autoritetin e saj si mbi aspektet fetare të banorëve të Europës, ashtu edhe mbi të gjitha aspektet e tjera të jetës së tyre, ishte mençuri nga ana e Skënderbeut që të përpiqej të fitonte vëmendjen e Vatikanit dhe ta përdorte për qëllimet e tij. Qysh në fillim duhet theksuar se marrëdhëniet midis Skënderbeut dhe Selisë së Shenjtë u ndërtuan mbi bazën e interesit të ndërsjellë, si nga ana e Skënderbeut ashtu edhe nga ana e Selisë së shenjtë, interesa këto që erdhën duke u forcuar me kalimin e kohës dhe me rritjen e famës së Skënderbeut si strateg në luftën kundër osmanëve". (Vlash Prendi: Papa Klementi XI ..., Gjergj Kastrioti dhe Selia e Shenjtë", "Republika", datë 4 nëntor 2012, fq.14).

Kështu, nisur nga fakti se në një letër përgëzuese që Papa Kaliksiti III (1455-1458), i kishte dërguar Skënderbeut pas fitores së tij në betejën e vitit 1457 në Ujëbardhë kundër ushtrisë turke prej 80.000 vetash, nën komandën e gjeneralit të sprovuar turk Isak bej Evronez, ndër të tjera, ai përdor një shprehje të tillë figurative vlerësuese për Skënderbeun: "Nuk ka njeri në botë që të mos ngrejë në qiell veprat tuaja me lëvdatat më të larta dhe të mos flasë për fisnikërinë tuaj, si për një atlet të vërtetë në mbrojtje të të krishterëve. (Cituar sipas K. Frashërit, "Skënderbeu, jeta dhe vepra", Tiranë, 2002, f. 484).

Një shprehjeje të tillë figurative, një similitude si ajo e lartpërmendur, e motivueshme dhe e pranueshme për të dalë nga goja e një pape, apo qoftë edhe nga **goja e një prifti** të kohës së Skënderbeut ose edhe të mëpasshëm, është e pakuptueshme dhe e papranueshme që t'i jepet një interpretim si ai i lartpërmenduri, duke shtrembëruar të vërtetën historike, aq më tepër kur autori i tij është një studiues laik i shekullit XXI. Por ajo që është më e pakonceptueshmja për ne, është fakti se karakterin atdhetar të luftës 25-vjeçare të Skënderbeut e ka mohuar edhe personi që aktualisht mban postin e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, z.Gramoz Ruçi, në fjalën e tij para pak ditës në Vatikan, në "Udiencën që mbajti Papa Francesku me rastin e Vitit mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit Skënderbeut me rastin e 550-vjetorit të vdekjes, kur z.G.Ruçi e quajti Skënderbeun "Mbrojtës i Krishtërimit" dhe "Atlet i Krishtit" ("Telegraf", datë 20 Nëntor 2018, fq.3).

Një vlerësim i tillë antishkencor, i pasaktë për Skënderbeun, nuk mund të shpjegohet ndryshe, përveçse me teorinë e globalizmit dhe me Sistemin shoqëror të Ekonomisë së Tregut ku, sipas tyre, për pak pragmatizës të çastit, u lejuaka që të bëhet tregti me gjithçka: deri edhe me shitjen apo faljen e heronjve të kombit të tjerëve, deri edhe në shtrembërimin e historisë.

Lidhur me nxjerrjen e konkluzioneve dhe interpretimin e ngjarjeve historike, mbi bazën e kronikave të ndryshme për Skënderbeun dhe luftën e tij, Prof. Kristo Frashëri, shkruan:

"Njoftimet kancelareske, kronikale, epistolare dhe memorialistike, janë subjektive... ata nuk vijnë nga një dorë e vetme..., por nga fronte të ndryshme të frymëzuara nga interesa të veçanta, sidoqoftë të pavarura njëri nga tjetri, madje në shumë raste, nga fronte kundërshtare midis tyre, disa tepër miqësore dhe disa tepër armiqësore ndaj Shqipërisë, ndaj luftës së shqiptarëve dhe ndaj politikës së Skënderbeut. Kështu, për shembull, letrat e papëve, sidomos ato të *Kalikstit III* drejtuar Skënderbeut, janë të



gjitha me notë panegjirike. Papët e ngrenë lartë heroin shqiptar, e nxitin ta vazhdojë me vendosmëri luftën kundër sulltanit për mbrojtjen e krishterimit dhe nuk ngurojnë ta quajnë "athlet të Krishtit" (Athleta Christi) – atlet në kuptimin e luftëtarit të madh që mbron një çështje fisnike. Në bazë të këtyre letrave jo pak historianë e kanë vlerësuar Skënderbeun si një kapiten që luftoi për mbrojtjen e krishterimit. Përkundrazi, Republika e Venedikut nuk e cilëson asnjëherë përleshjen shqiptaro-turke si luftë fetare..." (Kristo Frashëri "Marin Barleti panegjirik, fjalimet e heronjve të trilluara", te "Gazeta Shqiptare" dt. 17 shkurt 2012, f. 20-21).

Në këtë këndvështrim, nisur nga fakti se lufta çlirimtare dhe mbrojtëse e popullit shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut ka penguar, njëherësh, edhe kalimin e ushtrive osmane përtej Adriatikut, në Itali etj., kurrsesi nuk duhet të spekulohet me keqinterpretime subjektiviste të tilla, që për hir të interesave pragmatiste të çastit, të arrihet deri aty sa t'i ndryshohet edhe karakteri atdhetar i luftërave të popullit shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut duke u dhënë atyre karakter fetar, sikur gjoja ata paskan pas prioritet mbrojtjen e krishterimit.

Lidhur me sa më sipër, theksojmë se deri më sot, pas 550 vitesh nga vdekja e Skënderbeut, nuk është gjetur asnjë dokument historik që të flasë për Skënderbeun dhe ku ai të jetë shprehur me gojën e vet se ai ka qenë "mbrojtës i krishterimit". E shprehur më qartë, nuk gjendet asnjë pohim që Skënderbeu të ketë pranuar se ai ka luftuar për të mbrojtur krishterimin.

Në këtë aspekt, në favor të mendimit tonë na vjen në ndihmë një dokument autentik i kohës së Skënderbeut, i panjohur deri më tani nga historiografia, por i zbuluar para pak kohësh nga historiani Oliver Yens Schmitt. Ai mbi bazën e atij dokumenti, si në veprën e vet kushtuar Skënderbeut, ashtu edhe në intervistën e tij, dhënë publicistit Fatos Lubonja para pak kohësh, ka konkluduar se "lufta e tij (e Skënderbeut-A.H) kundër Sulltanit s'ishte gjë tjetër veçse hakmarrje personale ndaj vrasjes së të atit", e thënë ndryshe ai pohon se Lufta e Skënderbeut nuk ka pas karakter fetar, me të cilin jemi dakort. Ndërsa lidhur me pjesën e dytë të mendimit të tij "...për hakmarrje personale ..." mendojmë krejt ndryshe nga Schmitt-i. Për të qenë i saktë dhe me qëllim që lexuesi të nxjerrë konkluzionet e veta objektive, po citojmë këtu disa fragmente nga intervista e Schmitt-it:

"Para së gjithash, nuk kemi pasur asnjë dokument mbi motivet personale të Skënderbeut, që, sikurse e kam theksuar që në fillim, nuk i japin, megjithatë, një shpjegim motivesh kryengritjes ...

Në fakt dokumenti në fjalë na jep informacion mbi politikën italiane dhe na përshkruan audiencën e ambasadorit të Skënderbeut në Romë. Skënderbeu quhet në këtë kontekst një *"infide"* **(i pafe)** (e thënë ndryshe, Skënderbeu konsiderohet mysliman-A.H.), një e dhënë kjo që u korrigjua nga i njëjti ambasador disa ditë më vonë në një raport të dytë, që e plotësoi të parin ...

Për të gjykuar vlerën e burimit, duhet pasur parasysh edhe situata politike e atij momenti: Kostandinopoli kishte rënë disa muaj më parë dhe Papa Nikolla V po përpiqej dëshpërimisht të organizonte rezistencën kundër përparimit Osman. Në këtë moment, një ambasador nga Shqipëria kërkon ndihmë dhe thekson se zotëria i tij nuk po lufton për fenë e krishterë, por për "odio privato". Thjesht, nuk ka arsye pse diplomatët milanezë të kenë sajuar një histori të tillë. Do të kishte qenë shumë më e lehtë që ata të ksihin raportuar për një princ ballkanas që po kërkonte ndihmë në një luftë fetare kundër Perandorisë Osmane myslimane, argument ky që do t'u vinte shumë për shtat edhe ideve politike të papës dhe klimës politike në Italinë e asaj kohe. Ambasadorët e Skënderbeut duhet ta kenë kuptuar se pozicioni i tij ishte disi i pavolitshëm, sepse papa sigurisht do të ishte më i gatshëm të mbështeste një princ të krishterë që paraqiste veten si kampion të krishtërimit kundër islamit, sesa një fisnik që ishte përfshirë në një konflikt personal me sulltanin dhe ambasadorët e të cilit theksonin se feja nuk luante ndonjë rol në këtë ndeshje. Nuk është për t'u habitur që Skënderbeu ndërroi shumë shpejt strategji dhe u përpoq të sigurojë ndihmë si kampion i një lufte fetare, ide kjo që u zhvillua vite më vonë nga Papa Kaliksi III. Prandaj mendoj se një analizë e dokumentit dhe e kontekstit të tij shpie në përfundimin se ambasadorët milanezë thjesht kanë raportuar çfarë dëgjuan nga ambasadori i Skënderbeut. Ata s'kishin pse ta ndryshonin parashtrimin e tij që ishte mjaft i informuar edhe për sa i përket strategjisë detare të Mehmetit. Dhe s'është se ata kanë përçuar thashetheme, sepse kanë qenë vetë dëshmitarë të audiencës". (Oliver Yens Schmitt: Lufta e Skënderbeut, hakmarrje personale", "Panorama", e hënë 08 tetor 2012, fq.18)

Faktet që mësojmë nga dokumenti i lartëpërmendur, se në raportin diplomatik të ambasadorëve italianë dërguar Selisë së Shenjtë, Skënderbeun e quajnë "infide" (të pafe) d.m.th. musliman, sepse çdo jo të krishterë, njerëzit e besimeve të tjera, Selia e Shenjtë i konsideronte "të pafe" (infide), si edhe fakti se komenti që bën vet Oliver Yens Schmitt, kur pohon se "një ambasador nga Shqipëria kërkon ndihmë dhe thekson se zotëria i tij (d.m.th. Skënderbeu-A.H) nuk po lufton për fenë e krishterë ..." është një argument autentik dhe tepër bindës që vërteton se lufta e Skënderbeut kundër Sulltanit nuk ka pas asnjë karakter fetar por thjesht patriotik. Ndërsa lidhur me interpretimin e Schmitt-it, se Skënderbeu paska luftuar kundër Sulltanit për "odio privato" për hakmarrje ndaj vrasjes së të atit" ("Odio privato" mund të përkthehet si hakmarrje" – sqaron Schmitt, po aty, fq.19), e sqarojmë historianin gjerman Schmitt se në konceptin shqiptar mbrojtja e të drejtave dhe e hakut dhe marrja e gjakut për babanë dhe prindërit e vëllezërit etj, nuk është jashtë patriotizmit, por, bile, pikërisht këtu fillon patriotizmi. Theksojmë se fjala "atdhe" (term ky, sipas prof.E.Çabejt, i krijuar nga F.Konica) në gjuhën shqipe vjen nga fjalët "dheu i atit, i babës", kurse fjala "mëmëdhe" që kanë pas përdorur rilindasit shqiptarë, vjen nga fjala: "dheu i mëmës, i nënës" ("Mëmëdhe quhet toka, ku më ka rënë koka", – ka shkruar A.Z.Çajupi). Në këtë këndvështrim theksojmë se atdheu e atdhedashuria fillojnë, së pari, nga babai e nëna, nga shtëpia e lagjja dhe pastaj më gjërë, atdhe quhet e gjithë sipërfaqja e tokës deri në piramidën e kufirit të shtetit amtar. Prandaj një njëri që nuk lufton për të mbrojtur të drejtat e prindërve të vet, ai kurrsesi nuk mund të mbrojë as atdheun dhe as të tjerët; së pari, njeriu duhet të jetë nacionalist në kuptimin patriot, pastaj internacionalist. Për pasojë, mendimi i Schmitt-it se lufta e Skënderbeut kundër Perandorisë Osmane qenka bërë vetëm për "odio privato" (hakmarrje personale), është tepër subjektiv, alla Schmitt-çe.

Historiani i mirënjohur i ditëve tona, prof. Dr. Kristo Frashëri, në veprën e vet "Skënderbeu, jeta dhe vepra" ka saktësuar se, përderisa Skënderbeu luftoi jo vetëm kundër pushtuesve osmanë, por edhe kundër venedikasve, nuk mund të thuhet që ai luftoi si mbrojtës i krishterimit: "Skënderbeu nuk zhvilloi luftëra pushtuese, nuk shtypi popuj të ndryshëm dhe nuk krijoi perandori botërore. Ai luftoi me tërë pasionin e pafund dhe me tërë gjeninë e jashtëzakonshme për të mbrojtur atdheun e vet dhe në interes të popullit të vet, mbretërinë e lirisë, për të mbrojtur këtë mbretëri jo vetëm nga armiqtë e Lindjes, por edhe nga grabitësit dinakë të Perëndimit". (Kristo Frashëri, "Skënderbeu...", Tiranë 2002, f. 485).

Në përforcim të mendimit tonë se lufta e Skënderbeut kundër Perandorisë Osmane nuk ka pas karakter fetar për të mbrojtur krishterimin perëndimor dhe se ai nuk ka qenë atlet i Krishtit, siç thonë disa të tjerë, ndihmon edhe pohimi i historianit tjetër të mirënjohur, z. Kasem Biçoku, kur shkruan: "Skënderbeu ka luftuar edhe kundër ushtrive të krishtera, si në vitet 1447-1448 kundër ushtrive veneciane, edhe në vite 1460-1461 kundër trupave të princit të Tarantit në Italinë e Jugut.

Në radhët e ushtrisë shqiptare, përkrah njëri-tjetrit, kanë qenë luftëtarët e besimit të krishterë, katolikë e ortodoksë, por edhe të besimit mysliman, siç ka qenë vetë Skënderbeu dhe nipi i tij, Hamzai... Skënderbeu dhe Hamzai kanë pasur deri në fund të jetës emra myslimanë". (Kasem Biçoku, në "Tema", 02 mars 2005, f. 9).Pra, argumentet flasin qartë se Skënderbeu ka qenë vetëm "atlet" i atdheut të vet. Por këtu, natyrshëm lind një pyetje: "Ku e mësoi ai këtë politikë dhe harmoni ndërfetare?"

Përgjigja e kësaj pyetje, për mendimin tonë, është vetëm kjo: "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, vetëm pasi u bë Skënderbej, d.m.th. vetëm pasi u njoh me parimet e fesë islame, me Kuranin e shenjtë të myslimanëve dhe pasi e pranoi atë si fe të vetën, kur u njoh me ajete të tilla kuranore si ato ku theksohet ruajtja e identitetit personal e kombëtar, mbrojtja e lirive dhe e të drejtave të njeriut, jo vetëm si individ, por edhe si komb, si etni, pra të drejtat nacionale të kombeve e kombësive në përgjithësi dhe "nuk ka imponim në fe", "ndalohet konvertimi në fe i tjetrit me dhunë", atëherë atij iu zgjua ndjenja kombëtare dhe iu shtua më shumë ndjenja e mallit dhe e dashurisë për atdheun e vet, në momentin e përshtatshëm, kur iu krijuan kushtet për t'u kthyer në atdhe, në kohën e luftës së Sulltanit me J. Huniadin e Hungarisë, në nëntor të vitit 1443, Skënderbeu braktisi të gjithë titujt, ofiqet e nderet që gëzonte në oborrin e Sulltanit, ku ishte një nga gjeneralët më të lavdishëm të Perandorisë osmane dhe erdhi në Shqipëri. Së pari erdhi në Dibrën e vet, i pritur krahëhapur, prej nga ku bashkë me dibranët çliroi Krujën më 28 nëntor 1443 dhe më pas, më 2 mars 1444, organizoi e drejtoi Kuvendin e Lezhës, nga ku me Beslidhjen e Lezhës krijoi dhe sanksionoi shtetin e parë kombëtar shqiptar, duke i bashkuar të gjithë principatat shqiptare në një shtet kombëtar. Me këtë akt, Skënderbeu, vuri në praktikë ajetet kuranore (urdhërat) të tilla që udhëzojnë për çlirimin e vendit, krijimin e shtetit dhe ruajtjen e identitetit kombëtar shqiptar, si individ dhe si komb. Përndryshe, lind pyetja: "Atëherë, përse nuk e krijuan më parë shtetin shqiptar, ashtu siç bëri Skënderbeu në Kuvendin e Lezhës, asnjëri prej feudalëve shqiptarë të krishterë, bashkëkohës të Skënderbeut, siç ishin Aranitët, Balshajt, Dukagjinët, Muzakajt, Topiajt, Zahariajt, etj., të cilët jo vetëm ishin shumë më të pasur e më të fortë ekonomikisht sesa Skëndebeu e Kastriotët në atë kohë, por ata ishin dhe të lirë këtu, në Shqipëri, secili në pronën e në principatën e vet?!

Përgjigjja e kësaj pyetjeje retorike, dihet. Asnjëri prej princave shqiptarë të lartpërmendur të krishterë, as nuk e kishin konceptin e kombit shqiptar, por ata ishin të përçarë e të indoktrinuar nga ideja e globalizmit të krishterë dhe viktimë e politikës së Romës së vjetër "Përça dhe sundo!" *(vijon në faqen 20)*

meditime

Meditime pas takimit me një student të Internatit Dibra, një partizani, tankisti, oficeri nëndetëseje... njeriu që shpirti i ka mbet në Dibër...

T'i shërbesh atdheut si Selim Pira!

Nga **Abdurahim ASHIKU**

Vetëm Selim Pira shkruaj në zarfin e kujtesës dhe fletët brenda do të hapen si në një enciklopedi...

Nuk kisha pi ndonjëherë kafe me Selim Pirën...

As i kisha dhënë dorën në ndonjë konak Dibre...

Me të vëllain Sulën po,

Edhe me fëmijët e tij...

Banonim në një pallat me themele të lidhura,

Ai në hyrjen e parë e unë në të tretën,

Në të njëjtin kat...

Selimi më njihte,

Jo në portret, por në germë të penës...

Sa herë më lexonte në "Rruga e Arbrit" apo në "Dita", më merrte në telefon...

Nuk dëgjonte mirë, por fliste qartë e me pasion,

Më bënte të skuqesha nga fjalët në shkallën më të lartë që përdorte ndaj meje...

Më fuste në borxh,

borxhin njerëzor për ta takuar,

pirë një kafe e qëndruar në krah të njërit tjetrit përjetësuar në fotografi...

Do të më afronte me të djali i tij, Xhimi, ikanak si edhe unë në Athinë...

E kisha fiksuar numrin e tij të telefonit...

Xhimi më dha numrin e motrës së tij me këshillën që lidhu me të se ajo ta sjell ku të duash...

Në Tiranë shkoj e iki, si i thonë, "për të marrë një gacë për zjarr"...

Sa herë shkoja e kisha në mendje ta takoja,

"Gaca" mi digjte takimet...

Më në fund e gjeta kohën...

I "lidhur" për t'i shkuar në shtëpi por i zgjidhur gjalmash për ta takuar atje ku duhet të ndiqja një seminar treditor...

I ngjiti shkallët e hotelit "Tirana Internacional" mbajtur për krahu nga vajza, për siguri (kështu na mbajnë tash fëmijët),

i drejtë si plepat "fyell pushke" të Lugjejt buzë Drinit...

"Kambët po më lenë,-më tha duke u përqafuar- por mendjen e kam si në rini"...

U ulëm ballë për ballë...

I shikoja në fytyrë buzëqeshjen...

Mundohesha t'i lexoj shpirtin...

I gjerë si deti, ku kishte lundruar në sipërfaqe e në thellësi...

I lartë si Korabi bjeshkëve të të cilit kishte kullotur ëndërrat...

SHPIRTIN E KAM ATJE, NË DIBËR...



"Unë jam Selim Isuf Pira, mu prezantua me një zë gjëmues...



Datëlindja 1926...

Lindur në Lugje të Dibrës...

Kam pas babën patriot e atdhetar...

"Daja i vogël", i thoshte Eles Isufi...

Në pesëdhjetëvjetorin e Pavarësisë, në vitin 1962, është dekoruar...

E quajnë Isuf Pira...

Unë: Një biografi që më erdhi në shpirt si këngë trimërie, atdhedashurie...

Shpirtin e kam atje, trupin e kam këtu në Tiranë...

Në Dibër...

Duke filluar nga fisi, nga fshati...

Unë: Një mall që s'e shuan as Drini në rrjedhë të trojeve të tijLugjejt, as Veleshica tek takohet me Drinin e Zi...

Zall Dardha më ka nderue me titullin "Nderi i Dardhës"...

Erdhi edhe Donika Hyseni, sekretarja e përgjithshme...

Erdhën edhe nga komiteti i veteranëve, IlmiCani...

E kush do ta humbiste një flori kaq vezullues të asaj treve që atdhetarët e mëdhenj dhe këngët i kishte në barazkandar...

Unë kam 38 vjet pension...

Por a kam qenë në pension apo në punë?...

Punë, aktivist me Frontin edhe me Veteranët...

Kam qenë gjithnjë në kambë...

Edhe sot me shpirt jam në kambë...

Pleqëria nuk më ka ardhë nga koka por nga kambët...

Babën ma kanë vra forcat e HalilAlisë...

Më 8 korrik të 1944-s...

NJË KUJTESË QË TË HABIT

Kam bërë Internatin e Dibrës në Kastriot...

Shaban Shehun kam pas mësues...

Çdo të xhuma bënim mësime për fenë...

Mua më doli bursa për në medrese...

Nuk pranova...

Një nip, SelmanCala, baba i Skënderit dhe Beshirit...

Ishte xhandar në kohën e Zogut, bile u martua atë ditë me Zogun dhe shpenzimet e dasmës ia ka pague Zogu...

Nga shkolla mbaj mend Rufat Spahiun, drejtorin,

Burrë zotni, i mirë...

QamilGuranjakun kam pas mësues.

Pas Çlirimit ka qenë zëvendësministër i arsimit, partizan, komisar i brigadës së 17 S...

Ishin djemtë e kaloshëve;SefëKaloshi,

Kam qenë partizan në Çetën e Sllovës...

U formua më 15 shkurt 1943...

Në çetë kam pas Qatip Calën, IsufCalën, Faik Ndreun...

Pas Çetës u radhita në Batalionin e Dibrës që u krijua në Gjoricë më 26 korrik 1943...

Më pas në Brigadën e Tetëmbëdhjetë që u krijua në Sllatinë...

Isha komisar kompanie...

Kam marrë pjesë bashkë me Brigadën e 18-të në çlirimin e Dibrës së Madhe, shkuam në Mat deri në Lis...

LlonKaloshi, MahmutKaloshi, HilmiKaloshi, Kalosh Hysa, Avni Plaku, AhmetLahi, RremziNdreu, LazamNdreu, BaftjarNdreu, Irfan Ndreu, djemtë e Cen Elezit dhe të Kaloshëve...

Ka qenë edhe Bajrami i Beshirit, nipi i Dali Ndreut...

Ka qenë edhe Sul Pira, vëllai im...

Beqir Spahiu ka qenë inspektor i arsimit...

Vazhdova gjimnazin e Shkodrës dy vjet...

Më vranë babën, nuk shkova ma,

E lashë në të tretin...

USHTARAK ME RRËNJË NË BETEJA

Kam qenë partizan në Çetën e Sllovës...

U formua më 15 shkurt 1943...

Në çetë kam pas Qatip Calën, IsufCalën, Faik Ndreun...

Pas Çetës u radhita në Batalionin e Dibrës që u krijua në Gjoricë më 26 korrik 1943...

Më pas në Brigadën e Tetëmbëdhjetë që u krijua në Sllatinë...

Isha komisar kompanie...

Kam marrë pjesë bashkë me Brigadën e 18-të në çlirimin e Dibrës së Madhe, shkuam në Mat deri në Lis...

EsatNdreu ishte komandant...

Kam qenë përgjegjës i Rinisë të qarkut Shkodër,

Agim Popa ishte komisar, unë i rinisë...

Kam qenë komandant për shpërndarjen e ndihmave të UNRA-s...



Me vajzën, Meritën.

Kam qenë në ditën e parë të krijimit të armës së tankeve, komisar...

Kam qenë komisar i specialiteteve në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve 7 vjet.

Kam 15 dekorata të luftës dhe të punës. Dekoratën e parë ma ka dhanë Enver Hoxha.

Ika për studime në Bashkimin Sovjetik,në Sevastopol, shkollën e nëndetëseve...

Kam punuar në nëndetësen e parë, 105-n...

Punova katër vjet...

Sabit Brokën e kam pas ndihmës mjek në nëndetëse...

Ai më njeh gjerë e gjatë, një njeri i mirë, burrë malesh të Labërisë...

Atje më ka lindë vajza, Merita,

Ka le në Orikum në vitin 1961...

Njëzet vjet punova në Ministrinë e Mbrojtjet, zëvendësdrejtor i kuadrit për specialitet...

Vëllai, Sulejmani, ka qenë 18 vjet në Shkollën e bashkuar pedagog...

Gjatë gjithë jetës, deri sa dola në pension kam qenë ushtarak...

Më 15 gusht të vitit 1982 kam dalë në pension...

Kam dy djem e një cucë.

Tre nipër e tri mbesa...

Dhe një stërnip...

*
* *

Një kronikë jete si poezi, poetike, si këngë mbi tela çiftelie, lahute...

E shkruar me gjak e me djersë...

Nga ajo lloj djerse që vetëm Selim Pira e ka përcjellë ballit të rinisë e rrudhave të pleqërisë...

Kurdoherë në këmbë...

Maleve betejave partizane...

Mbi tanke...

Në barqe nëndetësesh...

Me dije e kulturë për ta pas zili...

*
* *



Zërin e Selimit e ruaj në një zarf komp-juterik...

Mbi dy orë bashkë...

Mes të qeshurash e fjalë të ngrohta që mu duk se i dhanë më shumë jetë...

Më dhanë edhe mua...

Mora një gacë...

U shndërrua në prush...

Faleminderit Selim Pira!

Faleminderit Merita!

Athinë 25 janar 2019

Avdulla Aga u rrit në odën dibrane, që personifikon shkollën e edukimit të popullit me dashurinë për luftëtarët, njerëzit e punës, familjes dhe Atdheut.

Avdulla Aga (Baftjari) - në prag të shekullit

Nga **Zabit LLESHI**



Gjatë historisë së ekzistencës populli i Dibrës ka nxjerrë njerëz të shquar, patriotë, shkencëtarë, mjeshtër të punës, organizatorë të talentuar, e tjerë. Një ndër to është Avdulla Aga nga Grazhdani. Për afër tre breza gjurmët e tij i gjejmë në kodrat dhe fushat e Dovolanit e më gjerë në trevën e Dibrës. Eksperienca dhe përvoja e njeriut të apasionuar në bujqësi u bënë moto e ditës për ekonomitë bujqësore në rrethin e Dibrës afër një gjysëm shekulli.

Avdullai lindi më 1921 në një familje me të kaluar patriotike. Babai i tij, Baftjari, i përcolli me dinjitet e fanatizëm traditat e luftës për mbrojtjen dhe konsolidimin e pavarësisë. Nëna Bedrije, e bija e Isuf Shehut nga Dibra e Madhe, rritur në teqen e Këlliç-Baba, e njohur për veprimtari atdhetare në shërbim të çështjes shqiptare e të gjuhës shqipe.

Vetë Avdullai u rrit në odën dibrane, që personifikon shkollën e edukimit të popullit me dashurinë për luftëtarët, njerëzit e punës, familjes dhe Atdheut. Shkollën fillore e mbaroi në Herbel, e vetmja në fshatrat midis Maqellarës dhe Melanit. Vazhdimi i shkollës së mesme në ato kohë ishte i pamundur. Si të gjithë moshatarët filloi punë në bujqësi për të ndihmuar prindërit. Gjatë kësaj periudhe mësoi shumë nga përvoja e bujqëve të Grazhdanit, e cila do t'i vlejë shumë për të ardhmen. Kështu, në punë e sipër filloi të krijohej edhe karakteri i këtij të riu, për t'u bërë një mjeshtër i vërtetë i organizimit shkencor të prodhimit bujqësor.

Pushtimi i Shqipërise nga Italia fashiste, pas saj nga Gjermania, krijoi një brengë të madhe, prandaj si shumë të rinj dibranë u regjistrua në brigadën e 18 sulmuese deri në çlirimin e vendit. Pas viteve 1944 u dallua si veprimtar shoqëror për zhdukjen e pasojave të luftës dhe rindërtimin e vendit. Më 1 tetor 1948 merr pjesë në aksionin për ndërtimin e hekurudhës Tiranë-Durrës, si komandant i brigadës vullnetare të Dibrës. Përfundimi me sukses i aksionit i hapi dritën jeshile në punën e re si nënpunës finance në Peshkopi deri më 1953. Ashtu si në fronte të tjera u shqua për një ndërgjegje e ndjenjë të lartë përgjegjësie, disiplinë e korrektësi, që do ta shoqëronte për më shumë se 70-80 vjet. Gjatë kësaj periudhe mbaroi me sukses disa kurse e shkolla afatshkurtra në Tiranë për kualifikimin tekniko-profesional dhe drejtimin shkencor të administratës së re që do t'i hapte rrugë krijimit të kooperativave bujqësore.

Reformat për kolektivizimin e bujqësisë pa dyshim kërkonin mbështetjen, mendjen, eksperiencën e përvojën e Avdullait. Bashkëfshatarët e Grazhdanit do t'i besonin detyrën e kryetarit të kooperativës bujqësore më 1958. Duke njohur psikologjinë e fshatarit dibran Avdullai ofroi rreth vetes njerëz të besuar e punëtorë, agronomë, mekanizatorë, brigadierë, blegtorë, duke dhënë shembull si individ dhe familje. Përgjithësoi përvojën historike të bujkut dibran në shërbimet e kulturave bujqësore, filloi sistemimin e parcelave, pyllëzimin e kodrave të zhveshura, ndërtimin e pritave malore për mbrojtjen e tokës. Për një kohë të shkurtër u ndërtua një rezervuar, u sistemuan e hapën kanalet vaditëse, ujsjellësi i ri i fshatit si dhe u sigurua baza materiale për ndërtimin e çerdhes, kopshtit dhe qendrës shëndetësore.

Edukata dhe kultura e punës që manifestonte Avdullai, u përpoq ta çonte tek të rinjtë e të rejat dhe ia arriti qëllimit. Ato u bënë një shembull i madh për eksperimentimin e të rejave të shkencës në bujqësi, në shërbim të kulturave bujqësore, krijimin e farërave të zgjedhura, përdorimin e plehrave kimike, duke dhënë frutet e veta në rritjen e rendimenteve në drithërat e bukës.

Brenda 2-3 vjetësh Grazhdani u bë ndër kooperativat më të dalluara të rrethit. Si fshat ka një histori të vjetër e të re. Aty ndodhet kalaja e ndërtuar në shekullin IV (pas Krishtit), banojnë njerëz patriotë e punëtorë, arsimdashës e me kulturë, në harmoni me njëri-tjetrin si një familje e madhe. Kultura e bashkëjetesës e trashëguar ndër breza përbëjnë vlera që u çuan më përpara në sajë të drejtuesve të fshatit, njëri prej tyre edhe Avdulla Baftjari. Në respekt të babait të tij Avdullai kishte kënaqësinë të thirrej edhe me mbiemër Baftjari, prandaj njerëzit që e rrethonin, miqtë e dashamirësit e thërrisnin sipas kësaj dëshire e shprehur dhe në dokumenta. Me krijimin e kooperativës së bashkuar të Dovolanit, kryetari kishte dhënë provat prandaj populli e zgjodhi njëzëri Avdullain si kryetar të saj. Përvoja e Grazhdanit i kishte kaluar kufijtë e fshatit, ajo do të shtrihej në të gjitha fshatrat e Dovolanit, duke u njohur në të gjithë Dibrën e më gjerë. Shembulli i kryetarit pranë njerzve kudo në frontet e ndryshme të punës deri në familje ndiqej edhe nga kuadrot, administrata, punëtorët e ndërrmarjeve të ndryshme e tjerë. Zgjidhja e nevojave dhe problemeve me drejtësi, pa zvarritje e sorrollatje burokratike, ishte motoja e punës së tij. Interesimi për sektorë të tjerë si arsimi dhe shëndetësia ishin në qendër të vëmendjes. Kujdesi për të sëmurët në fshat, furnizimi i popullit, ngrohjen e shkollave, çerdheve, kopshteve, strehimin e mësuesve e deri tek veprimtaritë kulturore e artistike e bënë kooperativën bujqësore të Dovolanit një qendër të përvojës së përparuar në shkallë republike.

Në Dovolan nuk njiheshin shpërdorimet, vjedhjet, krimet e tjerë. Në këto arritje pa dyshim, kryetari kishte meritat e tij. Populli i vlerëson dhe i inkurajon punën dhe djersën e kuadrove dhe drejtuesve të tij. Këto ishin arsyet e zgjedhjes deputet në tri legjilatura, 1966-1978 të Avdulla Baftjarit, njeriut të thjeshtë, gjithnjë me qeleshen karakteristike dibrane, që e shoqëroi deri në Kinë në një vizitë si pjesë e delegacionit qeveritar në vitin 1960.

U martua me Xhevrie Sulejman Deshatin nga Greva, një familje me tradita për trimëri, besë e bujari. Lindën 6 fëmijë: 3 djem e 3 vajza. Bexheti, ndër djemtë më i madhi, mbaroi Universitetin e Tiranës, dega fizikë, ka dhënë një kontribut për zhvillimin e arsimit në Dibër, si mësues në Maqellarë e Peshkopi, aktualisht drejtor në shkollën 9 vjeçare "Isa Boletini" në Kodër-Kamëz. Fëmijët e tjerë të arsimur e integruar në shoqëri, shembull në komunitetet ku punojnë e jetojnë. Xhevrija ndoqi shembullin e familjes së kryetarit në kooperativë, ndërsa si amvisë bashkoi traditën e dy familjeve si bujare e mikpritëse. Së bashku me Avdullain ata pritën e përcollën me zemër nënpunës, udhëtarë e kalimtarë si shumë familje të Grazhdanit. Me një ndjenjë të lartë humanizmi ata rritën një fëmijë, Bedri Shaveli, gjetur në shkallën e Tujanit nga Avdullai në vitin 1950, të braktisur nga prindër të humbur. Bashkë me fëmijët e tyre u kujdesën gjatë gjithë jetës edhe pas sistemimin në punë në minierën e mermerit Muhurr. Familja e Avdullait bashkë me dy vëllezërit Ashimi e Destani, motrat Shazie e Hatixhe, për tre breza numëron mbi 100 antarë, me nipër e mbesa, shumë prej tyre shkëlqejnë në profesionet apo studimet brenda dhe jashtë vendit.

Avdulla Aga është në prag të shekullit. Kur kthehesh mbrapa në kohë brezat në përgjithësi dhe brezi i ri në veçanti mund të nxjerrin mjaft mësime nga përvoja e gjatë e mjeshtrit të vërtetë të punës në bujqësi, plot pasion, dashuri e përkushtim. Ai gjithë jetën ia kushtoi rritjes së mirëqënies e përparimit shoqëror të fshatit.

Besmiri, valltar ne Ansamblin Popullor të Këngëve dhe Valleve, shpallur mbret i valles popullore në konkurrimin e kësaj valleje në Lushnjë; Altini së bashku me bashkëshorten mjek dhe profesor në Amerikë; Gazi, ekselent në studime dhe mbrojtjen e diplomës në Gjermani dhe tani vazhdon doktoraturën për elektronikë, pa folur për inxhinier, mjek, sociologë e financierë të tjerë që kanë mbaruar apo vazhdojnë studimet.

Natyrisht, gjyshi bëhet krenar dhe ndjen kënaqësi kur rrethohet prej tyre, i zgjatet jeta kur dëgjon për përparimet e fëmijëve dhe pasardhësve të tij. Nuk mund të përshkruhet gëzimi i Avdullait kur mësoi se mbesa e tij Almira Zebi (Xhembulla) mori mandatin e deputetit në zgjedhjet e vitit 2017.

Emocione të ngjallin porositë e tij për deputeten e re: ***"Të mbetesh e pastër, të mos mbash njeri me hatër, të jesh e drejtë, larg inateve dhe intrigave, të ruash nderin tand dhe nderin tonë. Suksese"***

Avdullai ndjek me vëmendje dhe shqetësim zhvillimet si qytetar, brengoset kur dëgjon për mosrealizimet, shfaqjet e korrupsionit, vrasjet, largimet nga vendi e boshatisja e fshatit. Është shumë i interesuar të dijë për punimet e Rrugës së Arbrit, ëndërr e hershme e banorëve te Dibrës.

Avdulla Aga është në prag të shekullit. Kur kthehesh mbrapa në kohë brezat në përgjithësi dhe brezi i ri në veçanti mund të nxjerrin mjaft mësime nga përvoja e gjatë e mjeshtrit të vërtetë të punës në bujqësi, plot pasion, dashuri e përkushtim. Ai gjithë jetën ia kushtoi rritjes së mirëqënies e përparimit shoqëror të fshatit. Padyshim, eksperienca të tilla kërkojnë studime, vlerësime e përgjithësime aq të domosdodhme për përparimin e bujqësisë në kushtet e reja të zhvillimit bashkëkohor të saj. I urojmë jetë sa më të gjatë, të begatë e pa brenga.

Karakteri atdhetar i luftërave të Skënderbeut, themelues i shtetit të parë kombëtar shqiptar

← Ata nuk e njihnin fare përmbajtjen e fesë islame e të Kuranit, për të cilën, rilindësi i madh shqiptar, i krishteri, Anton Zako Çajupi, ka përcaktuar: "Ideja myslimane ishte e begatshme, instituive, spirituale." ("Baba Tomorri", Alis A. Z. Çajupi, "Rolet e besimeve fetare në Ballkan" (Cituar nga gazeta "Ballkani", dt. 1 mars 2007, f. 17).

Mbështetur në gjithë sa sipër, kemi argumente të mjaftueshme që të konkludojmë se Skënderbeu është jo vetëm themelues i shtetit të parë kombëtar shqiptar, por njëherësh ai është edhe strategu dhe arkitekti i vënies në jetë të gurit themeltar në zbatimin e harmonisë ndërfetare në Shqipëri, ku shqiptarët muslimanë dhe të krishterë kanë bashkëjetuar në harmoni të plotë me njëri-tjetrin jo vetëm në kohë paqeje, por edhe në kohë lufte ata kanë qenë bashkëluftëtarë në të njëjtin front e në të njëjtën llogore në luftërat mbrojtëse kundër pushtuesve të atdheut tonë, qofshin ato kur vinin nga Lindja Islame, siç ishte ushtria e Perandorisë Osmane, qofshin kur pushtuesit vinin nga Perëndimi i krishterë, si në rastin kur Skënderbeu luftonte kundër ushtrive pushtuese veneciane. Për pasojë kjo traditë e vyer e popullit shqiptar vazhdon të jetojë edhe tani, në ditët tona, nga e cila habitet e gjithë bota.

Përgjigjja më e mirë për të gjithë ata që kërkojnë të interpretojnë dhe t'i ndryshojnë karakterin atdhetar të luftës së Skënderbeut është konkluzioni shkencor i prof. Dr. Kristo Frashëri, i cili, në veprën e tij, përcakton: "Lufta çlirimtare një çerek shekullore me fitoret e saj të mahnitshme, e ndryshme prej kryengritjeve të mëparshme, është një nga veprat historike të Skënderbeut. Vepra e dytë historike, madje më e madhja për nga vlera historike është krijimi i shtetit me karakter kombëtar dhe jo partikularist.Vepra e tretë historike është, padyshim, kthimi i Shqipërisë në një gardh që pengoi kalimin e ushtrive osmane në Gadishullin Italik, duke mbrojtur qytetërimin evropiano-perëndimor". (K. Frashëri, "Skënderbeu, jeta dhe vepra", Tiranë 2002, f. 481, 482, 483).

Përfundimisht, logjika e shëndoshë na çon në konkluzionin tonë se lufta e Skënderbeut ka karakter atdhetar. Ai krijoi shtetin e parë kombëtar me Besëlidhjen e Lezhës më 02 mars 1444 duke i bashkuar gjithë principatat shqiptare në një shtet kombëtar. Gjithë shqiptarët, muslimanë e të krishterë, nën udhëheqjen e Skëndëerbeut luftuan së bashku kundër pushtuesve, pa dallim feje, si ndaj atyre osmanë që ishin me shumicë muslimanë, ashtu edhe kundër pushtuesve venedikas që ishin të krishterë. Pikërisht për këto dhe shumë arsye të tjera, dy senatorët amerikanë, që iu drejtuan kongresit për një rezolutë në Kongres për Skënderbeun, e mbyllin kërkesën e tyre më këtë thirrje: "Të ftojmë qeverinë e SHBA-së që, në bashkëpunim me partnerë evropianë, ta përshpejtojnë integrimin e Shqipërisë dhe të Kosovës së lirë në Bashkimin Evropian, në shenjë mirënjohjeje për kontributin e madh dhe sakrificën e bërë nga Gjergj Kastrioti dhe populli shqiptar për shpëtimin e Evropës Perëndimore nga pushtimi osman". (citimi sipas gazetës "tema", datë 4 nëntor 2005, f. 9).

Sa aktual dhe i dobishëm është Skënderbeu për atdheun tonë, edhe tani, 550 vjet pas vdekjes së tij! Në këtë aspekt flet mjaft qartë intervista e ish-ambasadorit amerikan të SHBA-së në Shqipëri, z. Withers botuar në gazetën "Sot", datë 19 janar 2012, f. 2, kur flet për zhvillimet politike aktuale në Shqipëri:

"... Shqipëria ka një nga shembujt më të mëdhenj të udhëheqjes me gjithë historinë, që është Skënderbeu. Mjafton t'i hedhësh një sy modelit që ai ka lënë, pasi ai ishte një udhëheqës që solli bashkimin në Besëlidhjen e Lezhës në vitin 1444. Ai i bashkoi të gjithë palët rivale për interesa kombëtare. Udhëheqësit e sotëm nuk janë bashkues, janë përçarës... Shqipërisë i duhet një Skënderbe sot, më shumë se kurrë ndonjëherë më parë. Por në Shqipërinë e sotme nuk ka Skënderbe dhe mua më vjen keq për një gjë të tillë".

**Ish-Kryetar i Shoqatës etno-kulturore "Çidhna dhe Kastriotët në mandatin e parë.*

(Ripunim, referuar në sesionin shkencor në Peshkopi më 25 Nëntor 2018, me rastin e Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit Skënderbeut në 550-vjetorin e vdekjes)

Me 6 janar 2019 ndërron jetë poeti Xhelal Luca...

Lamtumirë Xhelal Luca, miku ynë!

Perikli SHULI, *poet*



Me datë 6 janar rreth orës 10 e 20 e paradites 2019, miku ynë poeti që ndizej në akull, sidomos për Kombin, një poet që përdori si shpatë penën dhe fjalën, një moment zemra pushoi tik-taket e saj, Xhelal Luca ndërron jetë...

Xhelal Luca lindi më15 mars 1953 në fshatin Zall-Dardhë të Dibrës, mbaroi arsimin e mesëm në Kurbnesh për elektro-mekanikë, ka kontribuar si montator dhe si asistent inxhinier në vepra të rëndësishme të vendit. Por Xhelali kishte mbaruar dhe Universitetin e Odave Dibrane. Kështu, thoshte me mburrje, për të lartësuar zgjuarsinë dhe trimërinë e Dibrës së tij. Xhelali ka shkruar qysh në moshë të hershme poezi. Ka botuar në revista dhe në gazetat e kohës. Ka shkruar dhe vënë në skenë shumë skeçe, parodi, monologë e tjera me estradat amatore në Elbasan 1976-1983. Mori diplomë për interpretim të fjalës artistike në skenë (1980). Xhelali ka botuar vëllimin e parë poetik "Shpirti bredharak", 2010; vëllimi dytë "Ndizem në akull", 2012; vëllimi i tretë "Pesë degë trungun thërrasin" (me bashkautor); vëllimi i katërt "Mëngjese të munguara", 2014. Ka në dorëshkrim gati për botim "Flladet e atdheut tim" dhe "Prushimi i hijeve.

Por Xhelali kishte edhe një familje të shëndoshë, gruan dhe katër fëmijë: Elsa, Alma, Albi dhe Eno, që për ta ai punoi dhe jetoi me nder deri në fund të jetës së tij. Xhelal Luca, dibrani i zjarrtë, dibrani i zgjuar, thurës i vargjeve tërë ndjenjë, që me aftësinë e tij, mirësinë të bëjë për vete, duartrokitjet i mori të zjarrta në të gjitha takimet, konferencat, simpoziumet, manifestimet. Pena e tij, zëri i tij kumboi fuqishëm në të gjitha trojet shqiptare, në Dibër e Gjirokastër, ne Fier e Shkodër, në Ersekë, në Vlorë, Tiranë, Shkup, Prishtinë, Tetovë, Prizren, Ulqin e Gjakovë, në Pejë e Kukës, Përmet e Prekaz te Jasharët, në Çamëri... ku nuk ishe ti Ambasadori i Paqes pa kufi. Ndaj ne sot të kujtojmë e të nderojmë.

500 mesazhe ngushëllimi kam marrë unë Xhelal për ty. Unë isha njëri nga shokët e tu. Sa shok kishe ti Xhelal? Sa miq kishe ti? Eeh Xhelal vëllai... "Ike pa na përshëndetur", - kështu tha Agim Xheka, pa na thënë lamtumirë. Ti nuk na kishe zhgënjyer ndonjëherë. Njëherë na zhgënjeve, por ..., rëndë... Poeti nuk vdes! Vitet përshëndesin njëri-tjetrin me dorën shtrënguar nga malli, njëri largohet përgjithmonë e tjetri afrohet, detyrën të marrin.

Se besova kurrë se do të ikje jo për arsye se ishte Viti i Ri! Por magjia e shpirtit tënd kishte mposhtur çdo stuhi! Ti ike pa u ndarë me ne. As Shqipen s'e pe të bashkuar. Ligjërove në trojet shqipfolëse, ëndërr për ty e parealizuar. Eej dibrani me shpirt prej stralli guxove dhe shave "Fazlliçët". Pena jote beden kalaje, për ne ishe një rilindas! Çamërinë e deshe shumë, në kraharor e ke. Akoma s'të tret dheu, more burrë, sa pesë pjesët të vinë tek Nëna. Djep baruti është Kosova, por me dasmorë lirie, kështu shkruaje, ti more mik shqiptar me besë lavdie. Për Binjakun dhe fëmijët s'të zuri gjumi asnjëherë, i deshe si sytë e ballit. Për këta, flisje përherë! "Dopjo shëndet" ti na uroje, këtë fjalë s'do ta harroj kurrë Xhelal Luca, miku ynë!

FATET

Nen nje qiell frymojme mike.
Nen qiellin Ballkanik.
Fatet nuk na lan' me u pa'.
Bashkohen shpirterat
Si ne legjendat mitike:
Ndizemi,
Digjemi,
Shkrihemi,
Dashurohemi sa me s'ka' .
Shume male ne mes,
Shume shtete ne mes
Agimeve çdo mengjes
Fytyra na qesh
Shpirti na qa'.
Fatet nuk na lan' me u pa'.

NE LUBLJANE
Ne cepin e nje godine
Stil barok
Te kam zane prite .
Pres...
Kendej do kalosh nje dite .
Me petkat e lypsarit,
Me plis bardhok
Do shtrij doren drejt teje
-PERENDI
Falme dicka nga TI.

MOLLA

Prap e shoh mollën me lakmi.
Të kujtojet kur lidhnim në degë verore?
Kur u perplasëm kok me kokë si fëmijë
Të lidhur për dore?
Kur u shtrin si të plagosur ?
Ti në kurriz
E unë përmbys
Në etje .
Lulet kthenin mbrapsh xhelozin e perëndisë.
Prap e shoh mollën me lakmi
Ajo hijeton për mua freksi,
Ti vapon në kurbet te zi.

ETYD

Erat e mëmëtokës
më morën në krah poezish
Kombin e pashë skaj e në skaj
Jetoj mes dy dashurish
Ty atdhe
Dhe sytë e saj.
Për atdhe
Jap jetën
Syt e sajë JO
I dua për vehten .

PLASARITJE

U thye qielli mes per mes.
Eshtrat e shpirtit më qajnë
Agim i murrëm ky mëngjes
"Dielleza" më mban kokën mënjëanë.
Eci rrugës së mortit
Me ty
Pa ty
Plagosur vdekshmërisht
Nga ato sy.

OFSHAMA IME

Ne psheretimat e dites
Grumbulloj grimca lumturie .
Vetem para teje
Kaloj ne mekje.
O Zot!
Sa fjale dashurije
Do te thoja pa prekje.
Ne psheretimat e dites
Ty te kam ofshame,
Te kam dhimbje,
Te kam xhan,
Nen lekure te kam gjerdan.
Mos te lendoj ty
Termetoj shpirtin tim.
Ti endja ime ,
Ndshta varri im.
Kurre nuk do sillem keq
Kurre dore nuk do heq.

DERI NESER

Sonte do te pi rrezet e henes
Ne nje kupe te argjende .
Neser ne vend te shampanjes
Do pi rreze dielli
Sa te me merren mente.
E ndava mendjen,
Te dale ku te dale,
Sonte do dehem me syt e tu.
Neser do te qesim fjale;
Eeeeeej,
Aroma qe ndjeni
Eshte vetem per ju.
Me qe perendine e ula ne toke,
Do te kuvendoj deri neser
Koke me koke.

U VONOVE

U vonuan lulet e blinit.
Te kujtohet?
Ti varja mbi qerpik...
Ti me ciceroje kengen e trimit
E une ''fluturoja'' ne galaktik.
Kudo ne vergje,
Kudo ne pragje
Puthja nurshem eshte e gjalle.
Nese blinin sivjet s'e kenaqe,
Edhe ai per ty ka mall.

ALTARET E MI

Ne shkembinjte e viteve
Thermohen kohet e mia
Ne kopshtin tim
Pervec te tjerave
Mbolla 2 ullinj te motchem .
Njerin e pagzova At,
Ne kujtim te atit tim.
Do ti festoja shekullin
Ne vitin e sotem.
At ...
E mblolla kujtimin tend
Tashme kam ku te falem .
Tjetrin e pagezova Dashuri.
Dashurova sa per nje shekull
Putha pamas
Rrezet e agimeve
Neper mes degeve te ullirit
Me ndjekin nga pas.
E ngrita faltoren per vete
Dhe per brezat qe vijne mbas.

FESTE NE FERIZAJ

Miremengjes Kosove.
Te pata nje jete ninulle.
Sot rehatova shpirtin
Ne shtratin tend.
Miremengjes Prishtine.
Sot po i laj syte
Me Diellin tend.
Pranveren e gjeta ne sythim
Vend per vend.
Njatjeta Ferizaj.
Sot me ke grishe
Ne Diten e Poezise.
Te kam pru'
Pak Shkoder,
Pak Gramsh,
Pak Sarande,
Pak Tirane.
Si lulet e qershise.
Te solla Vloren,
Nje cope nga ALTARI i Pamvarsise
Ferizaj! TI, Sofra e bujarise,
Palca e luftes,
Djepi i lirise.
Heeeeeeej lumi une
Per kete dhe te Shqiptarise.

FLIRT ME VDEKJEN

Me kalon prane
Gjithe naze
Si sorkadhe,
Si vashe bjeshke,
Si lule pjeshke.
O zot
Ku paske qene
Moj mrekulli ???
Jam VDEKJA
Por do te fali
Po bere me mua dashuri.
Ehehe ja fute kot
I jam fale mikes
Me syn e zi .
Une do te marr shpirtin.
Kot e ke
Ja fala mikes
Kur i putha gjin.
Do te marr mendjen.
Ohuu
Mendja m'u be ere
Atehere
Kur putha miken
Si lulen ne pranvere .
Hik he dreq.
Shko e mbytu ne uje
Nuk ju dashke tjeter kuj.
Per mbreterine time qofsh i mallkuar.
Iku vdekja e turperuar.

MALLI QE ME KEPUTI

Ooo c'mu shkoq
Kemisha e shpirtit
Nga ferrat e mallit
Per ty mikesh .
Kocka tu poq
Prushimeve te kurbetit
Sa shtatzania e malit
Emocioni mes nesh .
Syri mu dogj
Valave te vargut
Loti s'ma la
Buzen te qesh'
Ooo c'me mbeti
Kemisha e shpirtit
Ferrave te mallit
Sa jeta m'u zhvesh.

Rruga e Arbërit nr. 153

homazh

Hysen Repa njihet jo vetëm për një kontribut të rëndësishëm në reformimin e ushtrisë shqiptare, por edhe një rol kyç gjatë Luftës në Kosovë, si pjesëmarrës në stafin logjistik të UNHCR. Me përvojën e fituar në këto vite, hartoi disertacionin "Për përballimin e emergjencave civile", me të cilën mori titullin Doktor Shkencash.

Ti prehesh në paqe Hysen Repa! Sepse i paqtë, si rrallëkush ishe edhe mes nesh!

Sot ishte e shtunë. Herë pas here ngrija kokën lart dhe prisja të dukej Ai. Megjithëse e dija se nuk do të vinte, prapë besoja se mrekullitë ndodhin.

Do ta shihja duke pirë cigaren te dera, dhe derisa ta mbaronte, as fliste e as jepte shenjë se kishte ardhur.

Ndoshta do të kishte çuar një mesazh më herët ose një të shtunë më parë: "Javës tjetër kafen do ta paguaj unë.

Pensionin nuk e kam marrë, por lekët për kafe i kam. Drekë mos më kërkoni".

Ndonjëherë futej brenda. Shihte që kishte klientë në zyrë dhe nuk fliste. Kapte një libër a një gazetë dhe lexonte. Dhe kur e shihte se liroheshim sadopak, thoshte:

"Për mu vazhdoni punën, unë kafen e piva dhe po iki. Kam radhën sot për të gatuar drekën. A po vini?"

Sado punë që të kishim, sado të zënë të ishim, një kafe të shtunën nuk mund ta linim pa pirë me të.

Kur uleshim jashtë pinte duhan dhe i shtohej muhabetit. Dibrançe. Shkurt. Me alegori. Me humor shkodran. Dëgjonte. Nuk kundërshtonte kurrë. Thoshte atë që mendonte shkurt dhe saktë dhe nuk mërzitej. Fliste për gjithçka: për ushtrinë, diplomacinë, politikën, mekanikën, kasapin, librin, artin, muzikën, këngën popullore, jaren shkodrane, operën, Moxartin, Bahun, nëntëdhjetë e shtatën, luftën e Kosovës ... e deri te fëmijëria, me kujtimet mbi Kadriun, Selmanin, Nuzin, Llanin... Për gjithçka me dashuri dhe pasion.

Te aktualiteti e ulte ritmin. Dukej se e kishte lodhur. Përkushtimi i tij ndaj punës dhe detyrimeve që merrte përsipër ishte në kontrast me atë ç'ka ndodhur dhe po ndodh në këtë vend.

Zhgënjime. Prapaskena. Sulme. Intriga. Thashetheme. Gënjeshtra. Premtime.

"Po tani?"

"Tani çish?, - thoshte. Unë nuk ndryshoj ma, ju ndryshoni, e keni jetën përpara". Dhe qeshte.

Ngriheshim. Dilnim te dera dhe ai ndizte një cigare.

"Lërë duhanin, e kanë lënë edhe burra më të mirë se ti!"

"Në këtë moshë, duhanin e Nahilen nuk i là".

Por të shtunat nuk ishin veç për mua. Të shtunat ishin për Atë. Miqtë e përbashkët e mësuan se të shtunën vinte

Gjenerali dhe vallja bëhej e madhe...

Të shtunën e parë të janarit nuk erdhi. E pritëm me Xhaferin dy të shtunat e tjera, por prap nuk erdhi. Nuk na shkonte mendja kurrë se Ai po bëhej gati të ikte.

Por iku këtë javë siç nuk do ta kishte menduar kurrë: mbuluar me Flamurin që aq shumë iu përkushtua dhe e deshi dhe tre batare pushkësh në nderim të tij!

Ti prehesh në paqe Hysen Repa! Sepse i paqtë, si rrallëkush ishe edhe mes nesh!

Ike atje, ku në ka Zot, një vend në Parajsë është ruajtur për Ty!

Lamtumirë!

BUJAR KAROSHI

LAMTUMIRË, GJENERAL!

Nga **XHAFER MARTINI**



Foto nga përcjellja me nderime e gjeneral Hysen Repës

E kishim bërë zakon që unë dhe Hysen Repa çdo të shtunë të takoheshim tek studio M&B e Bujar Karoshit dhe të pinim kafe dhe të bisedonim. E prisja të shtunën me një ndjenjë hareje. Bujari, si kalonte një gjysmë ore, ngrihej dhe fillonte punën, me gjithë dëshirën për të qëndruar. Unë dhe Hyseni vazhdonim. Ajo shprehja popullore se "Me filanin nuk ngopesh", sikur ka lindur për të karakterizuar Hysenin. E kisha pasur nxënës në tetëvjeçaren e Fushë Alies shumë vjet më parë. Ishte nxënës i shumë i mirë. Shkëlqyeshëm i ka bërë të gjitha kategoritë e shkollave dhe u bë inxhinier ushtarak. Shërbeu shumë vjet në Shkodër, në qytetin e kulturës dhe të traditës qytetare. Hyseni ishte njeri që mësonte dhe sigurisht që mësoi shumë prej qytetarisë shkodrane. "Dibranishtja", në çfarëdo forme që të shfaqet, do latuar, përpunuar, ëmbëltuar. Dhe më duket se kultura dibrane me kulturën shkodrane shartohet më mirë se me çdo kulturë tjetër. Prandaj Hyseni kishte kryer edhe një shkollë të dytë, siç është tradita shkodrane. Vitet e demokracisë e gjetën në Tiranë dhe unë në këto vite i kam pasur takimet më të shpeshta me të.

- E kam qejf që parathënien për librin tim të ri për Halil Alinë ta shkruash ti, - i thashë një ditë, katër pesë vjet më parë. - Jeni të dy gjeneralë dhe nga një fshat, nga jam edhe unë. Ia kemi borxh t'ia qajmë hallet atij populli që u shtyp dhe u persekutua për pesëdhjetë vjet.

Pranoi me dëshirë. Nxora stilolapsin dhe bllokun t'i bëja gati ndonjë pikë ku të përmbahej.

- Jo, - tha, - ose e shkruaj vetë nga germa e parë deri tek e fundit, ose nuk e shkruaj fare. Harrova që Hyseni ishte shumë krenar.

- Kjo është edhe më mirë, -i thashë. Dhe vërtet e shkroi ashtu si unë do të kisha dëshiruar të shkruhej ajo parathënie.

Me Hysenin mund të bisedoje për çdo temë. Ai dinte të shikonte të mirat tek çdo njeri, ashtu siç zbulonte të këqijat dhe negativitet.

"Ti e ke njohur M.A., - më tha një ditë ndërsa kujtonim të kaluarën e fshatit tonë. - Ai ishte çoban, nuk bënte për asnjë punë tjetër, veçse të ruante dhentë. Por ama këtë punë e bënte me mirë se kushdo tjetër. Kur dhentë iknin andej nga donin, vraponim mbas tyre dhe e i trembin me kajuken e zezë që u sillej sipër kokave si shqiponjë. E kishim mendjen tek lojërat. Delja trembet sikur t'i bjerë ujku. Kur trembet, ajo humb në peshë dhe në qumësht. Kurse M.A. u rrinte dhenve në këmbë, pranë, gjithmonë anash, si një "mur" mbrojtës, i udhëhiqte andej nga ishte kullosa më e mirë, dhe ata me çobanin pranë, ndiheshin të qeta, të sigurta. Prandaj dhentë e tij, megjithëse hanin në një vend me tonat, kishin ndryshime të mëdha."

E dhashë këtë episod, në dukje pa rëndësi, vetëm për të treguar se sa vërejtës i hollë dhe sa psikolog ishte Hyseni. Psikologjia mësohet në shkollë. Psikologjinë Hyseni e kishte tek shpirti, ishte mënyra e tij e të vërejturit ë dukurive dhe filozofimit rreth tyre. Pastaj kujtonim njerëzit e mirë të fshatit tonë, pleqtë dhe plakat, zbulonim hiret dhe vetitë e tyre të çmuara. Nga këto biseda kuptoje sa mirë e njihte Hyseni kulturën popullore, doket dhe zakonet, kanunin, filozofinë popullore, sa mirë dhe me vend dinte ta përdorte alegorinë, duke krijuar asosacione dhe shoqërime idesh, sa mirë e njihte Hyseni formën e të menduarit të popullit, gjuhën e pasur me të cilën shprehej, etikën dhe estetikën popullore, frazeologjinë popullore.

"Sa mirë e njihte Hyseni kulturën popullore, doket dhe zakonet, kanunin, filozofinë popullore, sa mirë dhe me vend dinte ta përdorte alegorinë, duke krijuar asosacione dhe shoqërime idesh, sa mirë e njihte Hyseni formën e të menduarit të popullit, gjuhën e pasur me të cilën shprehej, etikën dhe estetikën popullore, frazeologjinë popullore..."

"Unë rrallë kam njohur njerëz që të jenë kaq shumë të ditur, kaq shumë të informuar dhe, mbi të gjitha kaq shumë në gjendje për t'i paraqitur mendimet me një gjuhë të pasur, me një frazeologji të zgjedhur, plot figura dhe paralelizma, plot shoqërime idesh dhe mekanizma të tjera artistikë që e bëjnë të folurin e këndshëm..."

Pastaj biseda mund të kapërcente papritur dhe të zhvillohej për një president apo mbret të x apo y shteti, për historinë kombëtare apo botërore, për personalitete dhe gjeni të fushave të ndryshme, për shkencëtarë, filozofë, artistë, mendimtarë, shkolla filozofike duke filluar nga lashtësia e duke ardhur deri në ditët tona. Unë rrallë kam njohur njerëz që të jenë kaq shumë të ditur, kaq shumë të informuar dhe, mbi të gjitha kaq shumë në gjendje për t'i paraqitur mendimet me një gjuhë të pasur, me një frazeologji të zgjedhur, plot figura dhe paralelizma, plot shoqërime idesh dhe mekanizma të tjera artistikë që e bëjnë të folurin e këndshëm.

Hyseni ishte edhe një dëgjues i mirë. Ai kishte kulturën e të dëgjuarit që rrallë njerëz e kanë. Të shikonte ndër sy dhe të krijonte atë ndjenjë të këndshme sikur t'i nxjerr mrekulli nga goja. Këtë mënyrë sjelljeje, këtë qëndrim ndaj bashkëbiseduesit, këtë nderim dhe respekt nuk ta sjell kushdo në tryezën e bisedës, veç një njeri i ditur i kalibrit dhe i formatit të Hysenit. Hyseni nuk ishte vetëm gjeneral Brigade, por edhe gjeneral i bisedës, i mendjes, i sjelljes aristokratike në kuptimin e plotë të kësaj fjale; ishte një nga përfaqësuesit më të mirë të elitës mendore të kombit. Hyseni ishte edhe një baba dhe familjar i shkëlqyer. Një ditë ndërsa bisedonim të tre, e mori në telefon vajza dhe i tha: "Baba sot drekën e duam prej teje". "Do ta bëj", - tha. Atë ditë shkoi më herët se zakonisht tek shtëpia. Ishte njeri pa paragjykime, me koncepte dhe qëndrime bashkëkohore. Fudullëku i Çidhnës tek ai ishin tretur. Kishte mbetur ai dinjiteti pa të cilin njeriu nuk jeton dot, sidomos një njeri si Hyseni. Kishte fëmijë të mbarë, të edukuar dhe të talentuar. Vajza e madhe, Albana, është mjeke në Kanada, vajza tjetër, Artemisa, e cila jeton në Itali, është një emër i njohur në skenat operistike europiane dhe botërore, ndërsa vajza e vogël, Eleni, ka mbaruar studimet në Universitetin Europian të Tiranës për drejtësi, ndërsa Alketi ka mbaruar mbaruar studimet në Shqipëri për shkenca inxhinierike.

Por kishte dy - tri të shtuna që nuk po na vinte. U bëmë disi merak, por mendja nuk na shkonte kurrë tek e keqja. Merre një herë në telefon, i thashë Bujarit. Ai i dërgoi SMS

(Vijon në faqen 23)

Në vitet e krizës humanitare në Kosovë, 1998-2001, ka luajtur një rol kyç si pjesëmarrës në stafin logjistik të UNHCR. Me përvojën e fituar në këto vite, hartoi disertacionin "Për përballimin e emergjencave civile", me të cilën mori titullin Doktor Shkencash.



"Njerëzit zakonisht në raste të tilla thonë për atë që ndrron jetë: "Qoftë i parajsës!" Kjo ka domethanien që ai që shkoi me u gjinde në nji vend ma të mirë se vendi ku u lind e jetoi... Sido me qenë në atë botë, mik i nderuem, nuk ka si me qenë ma keq se në nji vend ku Gjeneralet shtërngohen me u ba mekanikë, ndërsa mekanikët bahen ministra..."

– I. SECI



Gjenerali

Nga **ILIR SECI**

Dje ndjeva lajmin se kish ndrrue jetë Hysen Repa, gjenerali nga Dibra. Zotni Hysen Repën e kam njoftë në Shkodër nëpërmjet Halil Hajdarit që e kishte mik për krye.

Gjenerali ishte mishënimi i urtisë proverbiale dibrane, burrë i matun, fjalëpakë, shumë i ditun, që e ndigjonte me durim gjithkand e nuk ia ndërpriste kujt fjalën asnjiherë, çkado që ti diftonin. Nuk ua ndërpriste fjalën as në rastet kur njerëz krejt të paditun i flitshin për gjana që ai i dinte fort mirë.

Gjenerali ishte njiherit ushtarak dhe inxhinier mekanik, shumë i zoti në të dyja. Ishte shume i lexuem dhe njeri i kulturuem. Qysh në vitet '70-të kishte mësue në mënyrë autodidakte tre gjuhë të hueja: rusisht, anglisht, italisht. Gjithnjë kërkues me aq sa ishin mundësitë e asaj kohe, lexonte materiale në ato gjuhë për me i vu në dobi të ushtrisë shqiptare. Me mundin e vet si inxhinier pat ba mikrobusin e parë ushtarak sallë operacioni, 100 % funksionale, që mund të lëvizte në udhë të ngushta e rrugë të vështira nëpër prapavija në rast lufte. Ashtu, kërkues dhe gjurmues gjanash të reja, e kujtojnë tanë ata që e njoftën. Ushtrinë e donte si shqiptar, jo si partiak, ishte atdhetar dhe mbi vendin e vet nuk vente asgja.

Mbas ndryshimeve të viteve '90-të, u gradua gjeneral në ushtrinë shqiptare që asokohe kishte ministër Safet Zhulalin. Gjeneral Repa iu fut me zell punës për modernizimin e ushtrisë shqiptare, me e shndërrue atë ushtri nga mjet sundimi të PPSH-se në Ushtri në shërbim të kombit, siç e kishin tanë vendet demokratike.

Vizitoi sa herë Pentagonin dhe selinë e NATO-s në Bruksel, ku u prit me respekt, respekt që e fitoi kur e njohën dhe vlerësuen aftësitë e tij. Përkundër tanë kësaj rezumeje të pasun, në vitin 1998 e shkarkuan dhe e nxorën në pension të parakohshëm. E shkarkoi me firmën e tij presidenti i asokohe Rexhep Meidani.

Shkarkuen nji gjeneral të zotin, të përkushtuem, të ndershëm dhe patriot. E shkarkuan sepse përkundër tanë cilësive që banin model si njeri, pati nji të metë të madhe: ishte i aftë. E shkarkuen dhe Gjenerali u shtërngue me qitë jetesën si mekanik.

-"Falemnderes Zotit që kisha atë zanat" - u thoshte miqve...

Gjenerali me tanë ato kualifikime, me ato gjuhe të hueja dhe me dijet e thella u shtërngue me punue mekanik, ndërsa mekanikët u banë deputete dhe ministra...

Pushofsh në paqe Gjeneral Hysen Repa!

Njerëzit zakonisht në raste të tilla thonë për atë që ndrron jetë: "Qoftë i parajsës!" Kjo ka domethanien që ai që shkoi me u gjinde në nji vend ma të mirë se vendi ku u lind e jetoi... Sido me qenë në atë botë, mik i nderuem, nuk ka si me qenë ma keq se në nji vend ku Gjeneralet shtërngohen me u ba mekanikë, nësa mekanikët bahen ministra...

KUSH ISHTE HYSEN REPA?

Hysen Jonus Repa u lind në Fushë Alie më 26 janar 1948. Shkollën 7-vjeçare e përfundoi në fshat në vitin 1962. Në vitin 1966 mbaroi shkollën e mesme "Skënderbej" në Tiranë. Në vitin 1971 mbaroi Akademinë Ushtarake, ndërsa një vit më vonë u diplomua për Inxhinieri Mekanike në Universitetin e Tiranës. Në vitin 1978 përfundoi edhe studimet për Ekonomi në Shkodër.

Ka kryer një sërë kualifikimesh brenda dhe jashtë vendit si në SHBA, Turqi, Gjermani, Bruksel, kryesisht në mbështetjen logjistike dhe planifikimin e mbrojtjes.

Karrierën profesionale e nisi si pedagog në shkollën teknike "Skënderbej" në Tiranë në vitet 1972-1975. Më pas shef ofiçine në Divizionin e Shkodrës deri në vitin 1980. Nga viti 1981-1992 ka qenë shef teknike dhe Zv. Komandant Divizioni po në Shkodër.

Në vitin 1992, për dy vite rresht ka qenë drejtor transporti në Ministrinë e Mbrojtjes, dhe më pas zv.drejtor dhe drejtor i logjistikës pranë kësaj ministrie deri në vitin 1996.

Në vitin 1996 ka qenë anëtar i Komitetit Ushtarak të Standardeve (MASS), në NATO, Bruksel dhe në vitin 1997 ka qenë Komandat Divizioni në Shkodër.

Gjatë vitit 1997 ka qenë bashkëkomandant me forcat paqeruajtëse Spanjolle në Lezhë e Shkodër, ku mori vlerësime maksimale nga koleget e NATO-s. Në vitin 1997 mori edhe gradën Gjenerel Brigade.

Në vitet e krizës humanitare në Kosovë, 1998-2001, ka luajtur një rol kyç si pjesëmarrës në stafin logjistik të UNHCR. Me përvojën e fituar në këto vite, hartoi disertacionin "Për përballimin e emergjencave civile", me të cilën mori titullin Doktor Shkencash.

Më pas, nga viti 2002 deri në vitin 2012, kreu me dinjitet disa detyra civile si pjesë e stafit mbështetës me medikamente mjekësore në Kryqin e Kuq Gjerman, drejtor i Shërbimit Diplomatik në Ministrinë e Punëve të Jashtme, specialist në drejtorinë e përgjithshme të doganave, derisa doli në pension.

Krahas punës, u mor edhe me kërkime e studime në fushën ushtarake, ekonomike, historike. Ka hartuar dhe botuar një sërë materialesh si: "Projektimi dhe prodhimi i karroofiçinës për mbështetjen me riparim të njësive ushtarake", "Përgatitja e hartave profesionale të burimeve ekonomike, natyrore dhe rrugë-kalimet në Shqipëri", referate në simpoziume shkencore për organizimin ushtarak dhe popullor të krahinës së Dibrës në vitet 1912-1921, "Historia e revolucioneve, grushte shteti dhe rebelime në Shqipëri, pasojat (1912-1997)", si dhe mjaft artikuj dhe konsiderata për Luftën Nacionalçlirimtare, Masakrën e Fushë Alies në 1944 dhe historinë e lavdishme të krahinës së Çidhnës në shekuj.

Pas lirimit nga ushtria ka qenë i angazhuar politikisht dhe ka luajtur një rol kyç në fushatat elektorale për kandidatët Sali Shehu (Dibër, 2002), Besnik Mustafaj (Tiranë 2002,2005) si dhe Spartak Ngjelës (2003).

Ai komunikonte në tri gjuhë: anglisht, rusisht dhe italisht.

Ishte i martuar me Nahile Haqif Repa (Marku) dhe ka katër fëmijë: Albanën, Artemisën, Alketin dhe Elenin.

LAMTUMIRË, GJENERAL!

(Vijon nga faqja 22)

për të cilën Hyseni e as pjesëtarët e tij të familjes nuk patën mundësi të përgjigjeshin. Hyseni ishte përballur prej ditësh me vdekjen dhe ne nuk dinim gjë. Dhe ja ku vjen lajmi i kobshëm... Atë ditë në studion M&B nuk u puna për tjetër gjë, veçse si të nderonim Hysen Repën. Ishte angazhuar Shoqata "Çidhna dhe Kastriotit", një nga themeluesit e saj ishte edhe Hysen Repa. U njoftuan anëtarët e Shoqatës për vdekjen e tij, u përgatit fjala që do të mbahej në varrim në emër të Shoqatës, përgatitej kurora me lule dhe bëheshin shumë punë të vogla, por me rëndësi që kishin vendin e vet në përgatitjen e përgjithshme për t'i dhënë lamtumirën gjeneralit tonë të dashur. Prandaj ishin në lëvizje Bujari, Tafë Tola, Hajredin Toca, Xhevdet Kacani e ndonjë tjetër. Përgatitjet e mëdha i kishte, natyrisht, familja, por edhe Ministria e Mbrojtjes me punën e palodhur të Dilaver Laçit. Trupit të pajetë të Hysen Repës iu bënë nderimet si gjeneral i Forcave tona të Armatosura. Homazhet për të u bënë në mjediset e hapura dhe shumë të përshtatshme të Ministrisë së Mbrojtjes. Të bënte përshtypje rregulli, ecuria e punëve sipas ritmit që kërkohej, prania e gardës për këto raste dhe e shumë ushtarakëve të tjerë. Bëri homazhe dhe përshëndeti edhe zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koçi. Unë, mbasi i vura dorën në ballë për herë të fundit gjeneral Hysenit, siç bënë të gjithë, shikova edhe anë të tjera të homazheve. Kishin ardhur plot nëna dhe gra të veshura me të zeza nga vendlindja. Ato ishin ulur në një anë të sallës së madhe dhe rrinin plot dinjitet me brengën që u kishte shkaktuar vdekja e gjeneral Repës. Të tjerë, burra nga fshatrat e zonës, kishin bërë gjithë atë rrugë dhe ishin të gjithë aty.

Tek varri gjithashtu pati një "bukuri të veçantë", nëse mund të shprehesh kështu për një varrim. Trupi i pajetë i gjeneral Hysen Repës ishte mbuluar me flamurin kombëtar. Para tij u lexua edhe fjala e lamtumirës e Shoqatës "Çidhna dhe Kastriotët", gjenerali në pension Gjergj Vladi lexoi telegramin e ngrohtë të ministrit të Mbrojtjes, znj. Olta Xhaçka, që i dërgonte familjes ngushëllimet për vdekjen e gjeneral Hysen Repës, duke bërë vlerësim të mirë punës së tij. Në ballë si gjenerali për gjeneralin rrinte Dilaver Laçi që, si të thuash, kishte regjinë e gjithë procesit të varrimit. Rigonte një vesë shiu, por sapo filloi ceremonia e faljes nga Ali Hoxha, shiu pushoi dhe u duk dielli. Ai sikur i mënjanoi retë me dorë për të përshëndetur për pak çaste arkmortin me trupin e pajetë të gjeneral Hysen Repës.

Më në fund breshëria e të shtënave dhe trupi i Hysen Repës zbriti në tokën që do të na tresë të gjithëve.

Lamtumirë Gjeneral! U prehsh i qetë në tokën amtar!



www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ëebsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Ne nuk jemi gazetë e pavarur,
ne jemi gazetë e lirë
dhe pavarësia dhe liria jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

Bëj pajtimin tënd!

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: **600 lekë.** Në Europë: **10 Euro.**
Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me **1000** lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

BOTIMET M&B

Librat më të shitur gjatë vitit 2018. Të gjitha botimet tona mund ti gjeni pranë rrjetit të librarive "ADRION", librari "Art's" të Stacioni i Trenit në Tiranë, FletaXXI në Peshkopi ose mund ti porosisni përmes agjencive të shpërndarjes së librit.



cyan magenta yelloë black